<p>Në zbatim të VKM nr.129 datë 13.3.2019 "Per procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge" si dhe në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit "Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge", vazhdon të zbatohet Plani lokal të veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit.</p> <p>Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qëndrave komunitare, përfaqësues të Policisë të cilët kanë qënë dhe janë prezent në territor sipas një kalendarit të paracaktuar.</p> <p>Gjatë punës në terren janë identifikuar rreth 35 fëmijë në situatë rruge, të cilët i përkasin kryesisht komunitetit rom dhe egjiptian.</p> <p>Janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët dhe familjet në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe integrimin e tyre.</p> <p>Për secilen familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes.</p> <p>Në zbatim të ligjit 18/2017 " Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Bashkia Shkodër koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet e fëmijëve në situatë rruge dhe në disa raste janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët dhe janë ndjekur procedurat ligjore për kallzimin në prokurori të prindërve dhe individëve që shfrytëzojnë ekonomikisht fëmijët.</p> <p>Gjatë këtij viti janë zhvilluar aktivitetet e parashikuara me datë 8 dhe 12 prill në kuadër Ditës ndërkombëtare të Romëve, ku janë promovuar të drejtat e komunitetit rom dhe si dhe ndergjegjësimi kundër fenomenit të shfrytëzimit të fëmijëve.</p> <p>Gjithashtu janë bërë aktivitete sensibilizuese në qytet dhe pikat kufitare ku janë shpërndarë flete palosje, janë sensibilizuar qytetarët për të mos dhuruar para. Për këto aktivitete kemi pasur bashkëpunimin edhe të organizatave dhe mendojmë se kanë ndikuar në zvoglimin e këtij fenomeni.</p> <p>Gjatë vitit në vazhdim përveç aktiviteteve në ditë të veçanta gjithë muajin qershor do të fushatë sensibilizimi me grupin e terrenit dhe vullnetarë si dhe prononcim në mediat lokale me spot sensibilizues për mos shfrytëzimin e fëmijëve për lypje</p> <p>Fëmijët dhe familjet kanë marrë shërbimet e nevojshme në Qendrën Komunitare Multifunkionale "Për familjen". Ka vazhduar procesi i ndihmës direkte të familjeve me pako ushqimore dhe higjienë sanitare. Në fillim të vitit shkollor janë lehtësuar procedurat e regjistrimit në shkollë dhe pajisja me cantë dhe mjete shkollore. Fëmijëve u ofrohet transporti për në shkollë, vakt ushqimor si dhe klasa passhkollore.</p> <p>Me synim përmirësimin e gjendjes së këtyre fëmijëve, është e rëndësishme të vazhdojë puna për ndjekjen e detyrave, përgjegjësi dhe procedurat standarte për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse si dhe organizatat publike apo jo publike të cilat punojnë me fëmijët në rrezik, për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve në qytetin e Shkodrës.</p> <p>Në vijim të punës me fëmijët në situatë rruge dhe shfrytëzimit të tyre sidomos gjatë stinës së verës, Bashkia Shkodër synon gjithëpërfshirjen e fëmijëve të komunitetit rom e egjiptian në të gjithë aktivitetet që organizohen.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë uljen e numrit të fëmijëve në situatë rruge në Bashkinë e Shkodrës.</li> <li>• Synojmë ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë rruge.</li> <li>• Synojmë përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe familjeve në vështirësi të theksuar social-ekonomike në Bashkinë e Shkodrës.</li> <li>• Synojmë rritjen e aksesit të fëmijëve dhe familjeve për të përfituar shërbime të përkujdesit, shërbim në arsim, shëndetësi dhe punësim.</li> <li>• Synojmë parandalimin e fenomenit "Fëmijë në Situatë Rruge" në qendër të qytetit dhe në zonat ku është konstatuar numër i madh i fëmijëve në rrugë.</li> <li>• Synojmë parandalimin e fenomenit "Fëmijë në Situatë Rruge" gjatë sezonit të verës në zonat ku janë të identifikuar fëmijë në situatë rruge: në zonën e plazhit të Velipojës dhe në pikën kufitare të Muriqanit.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit.</li> <li>• Bashkëpunim I ngushtë me institucionet / strukturatpërgjegjëse.</li> <li>• Përditësimidhe zbatimi I kalendaritpërgrupet e terrenit, sipasnjësive administrative tëbashkisëShkodër.</li> <li>• Puna e grupevetëterrenitnëqendërtëqytetitdheintesifikimigjatësezonit tëverës.</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i rasteve emergjentetë fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, organizatat partnere etj.</li> <li>• Organizim i punës drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjen duke përfshirë këshillim dhe mbështetje.</li> <li>• Koordinim dhe lehtësimi i GTN përtë diskutuar për çdo fëmijë të konsideruar në rrezik.</li> <li>• Zhvillim dhe shqyrtimi i planeve individuale të mbrojtjes dhe përkujdesjes.</li> <li>• Identifikim dhe regjistrimin e fëmijëve të moshës së detritimit shkollor</li> <li>• Hartimi i raporteve dhe të dhënave sipas Udhëzuesit të Procedurave për Identifikimin, Ndihmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situata të Rruge, mbi situatën e fëmijëve në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit.</li> <li>• Organizim i aktiviteteve ndërgjegjësuese në ditën ndërkombëtare kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve dhe ditën ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge (8 Prill dhe 12 Prilli), në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat.</li> <li>• Vendosje baneri në ambient publik</li> <li>• Transmetimi në mediat lokale të spotëve sensibilizues/ndërgjegjësues</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Numri i fëmijëve në situatë rruge i zvogëluar.</li> <li>○ Shërbime mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë rruge të ngritura dhe funksionale.</li> <li>○ Fëmijë në situatë rruge të përfshirë në sistemin e mbrojtjes sociale.</li> <li>○ Kushtet e familjeve të fëmijëve në situatë rruge të përmirësuara.</li> <li>○ Rritje e numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin arsimor.</li> <li>○ Shërbime parandaluese mbi fenomenin “Fëmijë në Situata të Rruge”.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Fëmijët në situatë rruge Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatrat			Bashkia Skuadrat e terrenit Organizatrat Institucionet publike Komuniteti Studentët e Universitetit të Departamentit Punë Sociale dhe Psikologji			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale Promocionale	100			100	
A.2	Transmetim televiziv spot ndërgjegjësues	50			50	
	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale Promocionale	100			100	
A.2	Transmetim televiziv spot ndërgjegjësues	50			50	
	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale Promocionale	100			100	
A.2	Transmetim televiziv spot ndërgjegjësues	50			50	
	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Shkodër Administratorët Shoqërorë Kryetarët e Njësive Administrative Stafi i qendrave komunitare			
			<b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër			

<b>Nr. 07</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A4.</b> Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve)	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” . Në bashkinë Shkodër është e ngritur dhe funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.</p> <p>Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.</p> <p>Gjatë vitit janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje por nuk janë marra masa emergjente/dhe mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative.</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 59 pika 4 punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënie e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi.Me qëllim marrjen e vendimit të gjykatës për caktimin e kujdestarisë ligjore të të miturit në nevojë për mbrojtje, kërkohet mendimi i një eksperti psikolog i paanshëm sipas listës të vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës që të realizojë vlerësimin lidhur me kujdestarinë ligjore të të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Caktimi i shpenzimeve për ekspertët në gjykatë bazohet në Udhëzim nr 4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfirmimi i masave të mbrojtjes me qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e të miturve në Gjykatë.</li> <li>• Mbështetje direkte për fëmijët që rrezikojnë të humbin kujdesin prindëror.</li> <li>• Fuqizim ekonomik dhe shoqëror të familjeve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit, trafikimit, dhunës ndaj fëmijëve.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i mbledhjeve të grupeve teknike ndërsektoriale për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Hartimi i planeve individuale të mbrojtjes për fëmijët në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Përcaktimi i masës së mbrojtjes për të mitur në nevojë për mbrojtje;</li> <li>• Realizimi i kërkesës për konfirmim të masës emergjente/ të mbrojtjes në Gjykatë.</li> <li>• Sigurimi i shpenzimeve për ekspert psikolog që thirren nga Gjykata gjatë gjykimin.</li> <li>• Menaxhim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendorë dhe kombëtarë duke ruajtur të dhënat e fëmijës.</li> <li>• Monitorimi i zbatimit të planit individual të mbrojtjes për fuqizimin e familjes dhe fëmijës në nevojë për mbrojtje.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Garantimi mirëqënies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet dhe organizatat partnere si dhe komunitetin.</li> <li>• Ndikim në parandalimin e fenomeneve sociale (dhuna, shfrytëzimi, trafikimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve)</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuniteti</li> <li>• Institucionet publike</li> <li>• OJF-të</li> <li>• Bizneset private</li> <li>• ASHMDF</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve</li> <li>• Institucionet publike dhe private</li> <li>• OJF-të</li> <li>• ASHMDF</li> <li>• Bizneset private</li> </ul>	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime gjyqësore/Ekspert i pavaruar i përcaktuar nga Gjykata, psikolog(për 5 fëmijë)	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime gjyqësore/Ekspert i pavaruar i përcaktuar nga Gjykata, psikolog(për 5 fëmijë)	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime gjyqësore/Ekspert i pavaruar i përcaktuar nga Gjykata, psikolog(për 5 fëmijë)	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar-Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Shkodër <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 08</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A5.</b> Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e Bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Për pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk shfaqin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie.</p> <p>Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura "Për Familjen", duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen është realizuar një javë me aktivitete nën moton "Me Familjen, Për Familjen". Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Aktivitetet tjera të zhvilluara gjatë vitit janë planifikuar dhe organizuar për të gjitha moshat; për fëmijët, të rinjtë, gratë e burrat dhe moshën e tretë. Këto aktivitete kanë patur impakt shumë pozitiv në komunitet dhe për këtë synojmë që në vitet në vazhdim të shtrijmë aktivitetet ndërgjegjësuese, mbi rëndësinë e familjes dhe ndikimit të saj në zhvillimin e individit për një komunitet të shëndetshëm.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësimi dhe informimi i komunitetit nëpërmjet takimeve sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen, në njësitë administrative të Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Informimi i komunitetit për shërbimet që ofrohen në Qendrat Komunitare "Për Familjen", në çdo lagje të qytetit të Shkodrës.</li> <li>• Shtrirja e shërbimeve ndërgjegjësuese në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Planifikimi i kalendarit të aktiviteteve në bashkëpunim me partnerët publikë dhe privatë.</li> <li>▪ Organizimi, koordinimi dhe zhvillimi i aktiviteteve sipas kalendarit të përcaktuar.</li> <li>▪ Organizimi i takimeve me pjesëmarrje aktive të komunitetit.</li> <li>▪ Përgatitje e materialeve promociionale e ndërgjegjësuese mbi shërbimet për familjen.</li> <li>▪ Pjesëmarrje në median vizive dhe sociale.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Informimi i komunitetit.</li> <li>○ Ndërgjegjësimi i komunitetit.</li> <li>○ Rritje e numrit të përfituesve.</li> <li>○ Përmirësimi i cilësisë së jetës për familjet në vështirësi social –ekonomike.</li> <li>○ Familje të informuara dhe mbështetura e të integruara në jetën sociale.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim aktiviteti	200			200	
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim aktiviteti	200			200	
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali</b>	Nga kjo:			

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim aktiviteti	200			200		
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit publik. Organizatat partnere <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<p><b>P.AG141.Q2.O1.A6.</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.</p>		<p><b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b></p>				
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b></p>						
<p><b>i. Situata</b></p> <p>20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” duhet të jetë një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.  Kjo ditë synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve.  Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me organizatat partnere dhe institucionet arsimore organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbi mundësitë dhe shërbimet që ofrohen në territor.  Këto aktivitete ndërgjegjësuese do të vazhdojnë të organizohen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve.  Aktivitetet sensibilizuese përfshijnë fëmijë të gjithë komunitetit dhe punohet që nëpërmjet zërit të tyre vetë fëmijët të llobojnë për të drejtat e tyre.</p>						
<p><b>ii. Synimi i projektit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Synojmë organizimin e aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese, orientuese për komunitetin dhe rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë me synim zbatimin e të drejtave të fëmijëve.</li> <li>Synojmë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e komunitetit mbi të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre.</li> <li>Synojmë parandalimin e fenomeneve negative sociale ndaj fëmijëve (dhuna në familje, shfrytëzimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve)</li> </ul>						
<p><b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Planifikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me partnerët publikë dhe privatë.</li> <li>Organizimi i aktivitetit sensibilizues</li> <li>Bashkëpunim me institucionet publike, OJF-të, bizneset private dhe komunitetin</li> <li>Realizimi i një refreshment për pjesëmarrësit.</li> </ul>						
<p><b>b) Rezultatet që prisni</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese;</li> <li>Bashkëpunim i ngushtë me institucionet dhe organizatat dhe komunitetin.</li> <li>Ndikim në parandalimin e fenomeneve negative sociale (dhuna në familje, shfrytëzimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve)</li> </ul>						
<p><b>c) Aktorët e mundshëm</b></p> <p>Komuniteti  Institucionet publike  OJF-të  Bizneset private  ASHMDF</p>			<p><b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b></p> <p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve  Institucionet publike  OJF-të  ASHMDF  Bizneset private</p>			
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura</b></p>						
<p><b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b></p>		<p><b>Totali (mijë lekë)</b></p>	<p>Nga kjo:</p>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillim i aktivitetit për 20 Nëntorin	50			50	
	<b>Shuma</b>	<b>50</b>			<b>50</b>	
<p><b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b></p>		<p><b>Totali (mijë lekë)</b></p>	<p>Nga kjo:</p>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillim i aktivitetit për 20 Nëntorin	50			50	
	<b>Shuma</b>	<b>50</b>			<b>50</b>	
<p><b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b></p>		<p><b>Totali (mijëlekë)</b></p>	<p>Nga kjo:</p>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime

A.1	Zhvillim i aktivitetit për 20 Nëntorin	50			50		
	<b>Shuma</b>	<b>50</b>			<b>50</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Tetor - Nëntor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				



<b>Nr. 10</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A7.</b> Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori"	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Në këtë ditë dhe jo vetëm fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre</p> <p>Kjo ditë përveç se është një ditë festive, duhet të jetë një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.</p> <p>Ky aktivitet realizohet për të gjithë fëmijët e qytetit të Shkodrës, protagonist ne programin artistik që zhvillohet janë fëmijët që frekuentojnë Qendrat Komunitare "Për familjen" dhe fëmijët e Qendrës Kulturore të Fëmijëve si dhe fëmijët që marrin shërbime në qendrat e Përkujdesit rezidencial. Fëmijët pjesëmarrës kanë realizuar performacat e tyre, me anë të të cilave kanë përcjellur mesazhe sensibilizuese për të drejtat e tyre. Loja si e drejtë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës është motoja e aktivitetit. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ka si qëllim të rrisë vëmendjen në drejtim të mirëqenies së fëmijëve. Për të realizuar një aktivitet sa më masiv dhe gjithpërfshirës dhe argëtimi i fëmijëve të jetë maksimal është e nevojshme që lojrat e përzgjedhura për këtë aktivitet të jenë të aksesueshme dhe të përshtatshme për ambiente të brendshme dhe të jashtme.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit për njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.</li> <li>• Organizimin dhe zhvillimin e aktivitete sensibilizuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> <li>• Nxitjen e pjesëmarrjes dhe gjithpërfshirjes së fëmijëve në aktivitete sensibilizuese dhe argëtuese.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave.</li> <li>▪ Organizim i aktiviteteve social- kulturore dhe promovuese për të drejtat e fëmijëve në ditën ndërkombëtare të fëmijëve</li> <li>▪ Propozimi i mënyrave për përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje.</li> <li>▪ Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe sensibilizues me fëmijët dhe prindër në qendrat komunitare "Për Familjen", takimeve.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Aktivitet social- kulturor i realizuar në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat partnere.</li> <li>○ Sensibilizim i komunitetit dhe institucioneve për respektimin e të drejtave të fëmijëve.</li> <li>○ Njohje dhe respektim të të drejtave të fëmijëve nga komuniteti dhe institucionet publike e private.</li> <li>○ Përmirësim i kushteve të jetës për fëmijët dhe familjet e tyre.</li> <li>○ Aftësim i fëmijëve për të lobuar për të drejtat e tyre</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Fëmijët Komuniteti Institucionet publike OJF-të				Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim Aktiviteti	200			200	
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim Aktiviteti	200			200	
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali(mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim Aktiviteti	200			200	
	<b>Shuma</b>	<b>200</b>			<b>200</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		
Maj – Qershor 2025, 2026, 2027				Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale <b>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</b>		

<b>Nr. 11</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A8.</b> Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Në universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në degët e psikologjisë dhe punës sociale çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e "Praktikumit". Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimim e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit.</p> <p>Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. Gjatë vitit 2023, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik kanë zhvilluar praktikën studentë të punës sociale dhe psikologjisë. 27 studentë; 19 të nivelit bachelor dhe 8 të nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare "Për Familjen". 1 studentë ka zhvilluar praktikën profesionale në kuadër të një programi të DAP. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Këto studentë janë njohur me punën dhe shërbimet që ofrohen në qendrat komunitare dhe gradualisht janë bërë pjesë aktive duke dhënë kontributin vullnetar pranë këtyre qendrave. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit tyre.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në partneritet me departamentin e psikologji-punës sociale synojmë të bashkërendojmë punën për mbulimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale ndaj familjeve në nevojë.</li> <li>• Synojmë informimin për shërbimet në territor dhe përmirësimin e kushteve sociale të familjeve në nevojë, duke ofruar shërbimin në komunitet, në bashkëpunim me studentët.</li> <li>• Synohet kryerja e detyrimeve të praktikës mësimore të studentëve në mënyrë më efektive.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrja për studentët.</li> <li>▪ Pranimi i kërkesave nga studentët dhe universiteti.</li> <li>▪ Përzgjedhja e studentëve.</li> <li>▪ Përgatitje dhe trajnim i studentëve për punën që do zhvillojnë.</li> <li>▪ Supervizim i studentëve në komunitet.</li> <li>▪ Ndihmë për familjet në vështirësi social-ekonomike.</li> <li>▪ Krijimi i aftësive praktike të studentëve si profesionistë të ardhshëm.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bashkëpunim i afërt Bashki – Universitet – student.</li> <li>○ Ofrim i shërbimeve në territor.</li> <li>○ Informim, orientim, këshillim për individët dhe familjet në vështirësi social-ekonomike.</li> <li>○ Përmirësim i kushteve social-ekonomike të familjeve në nevojë.</li> <li>○ Zhvillim i aftësive praktike të studentëve të universitetit të Shkodrës.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Studentët Universiteti i Shkodrës Komuniteti Bashkia				Bashkia Universiteti i Shkodrës Studentët		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
<b>Shuma</b>						

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							
	<b>Shuma</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Departamenti i Psikologji – Punë sociale <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër					

<b>Nr. 12</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A9.</b> Tryeza konsultative me organizatat që vepronë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>					
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile të tilla si: Shpresë për Botën, Madoninna del Grappa, Projekti Shpresa, The Door Albania, Kongresi Rinor Kombëtar, Caritas Dioqezan Shkodër-Pult, Fondacioni Fëmijët Shqiptarë, Nisma/ Arsis, Plan&amp;Go, World Vision, Të ndryshëm, të barabartë, Terre Des Hommes, Observatori, Maltesser Albania, Save the Children, Gruaja tek Gruaja, Hapat e lehtë, Kryqi i kuq, Papa Xhovani XXIII, SOS Fshatrat e fëmijëve etj.,. Gjatë këtij viti janë realizuar takime konsultative të drejtpërdrejta dhe online me organizatat partnere. Tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit, 15 majit, 1 qershorit, 16 ditëve të aktivizimit dhe në zbatim të projekteve të reja që do zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime. Në shenjë falenderimi dhe mirënjohje për kontributin dhe punën gjatë të gjithë vitit planifikojmë organizimin e një takimi përmbyllës në fundvit me të gjithë aktorët aktivë në territorin e Bashkisë Shkodër.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë konsolidimin e tryezave konsultative me pjesëmarrjen e shoqërisë civile.</li> <li>• Synojmë të integrojmë dhe koordinojmë shërbimet që ofrohen në territor.</li> <li>• Synojmë të përmirësojmë situatën e familjeve në vështirësi social -ekonomike të qytetit të Shkodrës nëpërmjet bashkëpunimit institucion – organizatë – biznes privat - komunitet.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve për zhvillimin e tryezave konsultative.</li> <li>▪ Zhvillimi i tryezave konsultative.</li> <li>▪ Zbatimi dhe koordinimi i punës, sipas tematikave dhe nevojave, produkte të takimeve konsultative</li> <li>▪ Propozime të reja për ofrimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të territorit.</li> <li>▪ Takim final përmbyllës për punën e realizuar gjatë vitit.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bashkëpunim i afërt dhe partneritet Bashki – OJF – Institucione publike – Biznes privat – Komunitet.</li> <li>○ Shpërndarje më e mirë e shërbimeve në territor.</li> <li>○ Informacion mbi projektet dhe shërbimet që zbatohen në qytet.</li> <li>○ Përmirësim i situatës së familjeve në nevojë në qytetin e Shkodrës.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Komuniteti Institucionet publike Organizatrat			Bashkia Organizatrat Institucionet publike Komuniteti				
<b>e) Shpenzimet ellogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operati ve</b>	<b>Transferi me</b>	<b>Kapit ale</b>
A.1	Shërbim Katering	80			80		
<b>Shuma</b>		<b>80</b>			<b>80</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Siguri me</b>	<b>Operati ve</b>	<b>Transferi me</b>	<b>Kapit ale</b>
A.1	Shërbim Katering	80			80		
<b>Shuma</b>		<b>80</b>			<b>80</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Siguri me</b>	<b>Operati ve</b>	<b>Transferi me</b>	<b>Kapit ale</b>

A.1	Shërbim Katering	80			80		
	<b>Shuma</b>	80			80		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Organizatrat partnere <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 13</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A10</b> Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Romët dhe egjiptianët që jetojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës, si pasojë e ndikimit të faktorëve social, kulturorë dhe ekonomikë shfaqin problematika që lidhen me zhvillimin, regjistrimin dhe aksesin në të drejta të këtij komuniteti. Në Bashkinë Shkodër, komuniteti rom dhe egjiptian zë 0.014% të popullsisë totale të regjistruar, brenda njësisë administrative Qendër, ku janë të vendosur shumica e tyre. Të dyja komunitetet janë të përqëndruara në këtë njësi administrative ndërkohë që në të gjitha njësitë e tjera administrative nuk raportohet të ketë asnjë banor/familje (të paktën formalisht të regjistruar) që i takon këtyre komuniteteve. Në total popullsia rome llogaritet të jetë rreth 423 banorë (81 familje) dhe popullsia egjiptiane llogaritet të jetë 1189 banorë (269 familje) kundrejt totalit të banorëve. Si pasojë e lëvizjeve migratore të shpeshta brenda dhe jashtë vendit, një sërë faktorësh si: gjendja e vështirë ekonomike, kushtet e papërshtatshme të banesave, kequshqyerja, burime të paqëndrueshme të të ardhurave dhe niveli i ulët arsimor e aksesit i ulët shëndetësor ndikojnë drejtëpërsëdrejti në mirëqenien e ulët të këtyre komuniteteve, duke rritur kështu akoma më shumë hendekun e integritit socio-ekonomik me popullsinë shumicë.</p> <p>Duke qënë një komunitet me kaq shumë problematika, Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, në bashkëpunim me organizatat partnere ka ndërmarrë një sërë nismash për ofrimin e shërbimeve të nevojshme ndaj tyre. Janë vlerësuar nevojat dhe situata e këtij komuniteti dhe janë programuar, planifikuar dhe projektuar ndërhyrjet e nevojshme për përmirësimin e tyre. Një nga nismat e rëndësishme, ka qënë hartimi i Planit të Veprimit, një instrument orientues dhe rregullator për koordinimin e ndërhyrjeve nga institucionet dhe organizatat me synim përmirësimin e kushteve të jetesës për këtë komunitet. Ky dokument është miratuar me VKB nr. 80, datë 21.12.2017 dhe ka patur një shtrirje kohore 2017-2020.</p> <p>Ndërkohë, në kuadër të projektit ESSERE, zbatuar nga UNDP, është mundësuar realizimi i Raportit të Parë Monitorues të zbatimit të këtij plani. Raporti ka ofruar një analizë të evidencave ekzistuese në lidhje me ndryshimet në jetët e anëtarëve të dy komuniteteve, rom dhe egjiptianë, sipas gjashtë fushave prioritare të planit të veprimit, përkatësisht: regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; arsimit dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; punësimi dhe arsimit dhe formimi profesional; kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimin urban; si dhe mbrojtja sociale. Duke marrë në konsideratë që monitorimi ndihmon aktorët vendor për të bërë ndryshimet e nevojshme në PZHK, ai ndër të tjera synon të ofrojë edhe rekomandimet e nevojshme për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuara.</p> <p>Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa direkte dhe indirekte në qasjen në shërbimet sociale, shëndetësore publike, etj. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë të këtij komuniteti është dy herë më i lartë sa shumica e popullsisë së vetë komunitetit. Frekuentimi i ulët i shkollës dhe braktisjes shumë herët, pa përfunduar arsimin e detyruar, janë rezultat i nivelit të ulët arsimor dhe më konkretisht analfabetizimit dhe për pasojë edhe nivelit të ulët ekonomik të këtij komuniteti. Me qëllim përfshirjen e këtij komuniteti dhe lehtësimin e problematikave të tyre në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet, si dhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian.</p> <p>Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian.</p> <p>Gjatë këtij viti ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse për komunitetin rom dhe egjiptian ku përmendim: punësimin, identifikimin dhe regjistrimin në sistemin arsimor parashkollor dhe shkollor të të gjithë fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, vizitat mjekësore dhe trajtimin mjekësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna, regjistrimin e vendbanimit në gjendjen civile të Bashkisë së Shkodrës për familjet rome të interesuara dhe është ofruar mbështetje për çdo procedurë administrative të nevojshme për këtë proces.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë të promovojmë fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian nëpërmjet standartizimit të një qasje të re inovative, të integruar në nivel politik dhe programimi dhe të ofrojë modele të integruara të përfshirjes sociale në nivel vendor.</li> <li>• Synojmë të përmirësojmë aksesin në shërbime dhe respektimin e të drejtave njerëzore për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>• Synojmë të kontribuojmë në fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>• Synojmë konsolidimin e shërbimeve pranë qendrës komunitare multifunkionale me synim fuqizimin, integrimin dhe edukimin e fëmijëve dhe familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>• Synojmë konsolidimin e ofrimit të shërbimeve të qendrës së re multifunkionale duke krijuar ambiente për kopësht, cerdhe, qendër shëndetësore, zyra administrative, etj.</li> <li>• Bashkëpunim me ngushtë me organizata të shoqërisë civile dhe mbështetje për zhvillimin e aktiviteteve sportive për vajza dhe djem të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Krijimi i modeleve të reja dhe iniciativave për rritjen e mundësive për punësim të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>▪ Krijimi i lehtësirave për bashkëpunim (horizontal, vertikal) ndërmjet institucioneve publike, organizatave, etj.</li> <li>▪ Fuqizim/ngritje të kapaciteteve.</li> <li>▪ Fuqizimi dhe vazhdimësinë e funksionimit të Qendrës Komunitare Multifunkionale "Për Familjen".</li> <li>▪ Krijimin e mekanizmave mbështetëse për personat që jetojnë në kushte ekstreme varfërie.</li> <li>▪ Bashkëpunimi i ngushtë me organizatat partnere që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>▪ Informim dhe ndërgjegjësim i prindërve &amp; komuniteteve dhe egjiptiane përrëndësinë e arsimit.</li> <li>▪ Ndjekja e procesit të frekuentimit të fëmijëve rom në shkollë.</li> <li>▪ Zhvillimi i klasave passhkollore për fëmijët rom dhe zhvillimi i klasave të analfabetizimit për të rriturit.</li> <li>▪ Zhvillimi i aktiviteteve edukuese, sensibilizuese, promovuese për fuqizim, integrim dhe edukim.</li> <li>▪ Mbështetje dhe lehtësim në procedurat administrative.</li> <li>▪ Ndërgjegjësimi i komunitetit R/E për rëndësinë e kujdesit shëndetësor.</li> <li>▪ Organizimi dhe zhvillimi i kampeve verore për fëmijët R/E.</li> <li>▪ Koordinimi i ndërhyrjeve të integruara në mes të gjithë aktorëve përgjegjës.</li> <li>▪ Organizimi i aktivitetit ndërgjegjësues në ditën ndërkombëtare të romëve (8 Prill).</li> </ul>																														
<b>b) Rezultatet që prisni</b>																														
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Fuqizimi socio-ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Krijimi i aksesit në shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Përmirësimi i cilësisë së jetës për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Rritja e punësimit dhe zhvillimi i aftësive e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat e komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Qendër komunitare funksionale në komunitet në shërbim të këtij komuniteti.</li> <li>○ Qendër multifunkionale në shërbim të komunitetit.</li> <li>○ Mbështetje për zhvillimin e aktiviteteve sportive për vajza dhe djem të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>○ Përmirësim i cilësisë së jetesës dhe shërbimeve për komunitetin rom dhe egjiptian në Bashkinë e Shkodrës.</li> </ul>																														
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>																													
Komuniteti rom dhe egjiptian Komuniteti Bashkia Institucionet Publike Organizatrat	Bashkia Komuniteti																													
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>																														
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</th> <th rowspan="2">Totali (mijë lekë)</th> <th colspan="5">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Paga</th> <th>Sigurime</th> <th>Operative</th> <th>Transferime</th> <th>Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>Shuma</b></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100				<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																								
		Paga	Sigurime	Operative		Transferime	Kapitale																							
A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100																									
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</th> <th rowspan="2">Totali (mijë lekë)</th> <th colspan="5">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Paga</th> <th>Sigurime</th> <th>Operative</th> <th>Transferime</th> <th>Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>Shuma</b></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100				<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																								
		Paga	Sigurime	Operative		Transferime	Kapitale																							
A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100																									
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</th> <th rowspan="2">Totali (mijë lekë)</th> <th colspan="5">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Paga</th> <th>Sigurime</th> <th>Operative</th> <th>Transferime</th> <th>Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">100</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>Shuma</b></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>100</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100				<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																								
		Paga	Sigurime	Operative		Transferime	Kapitale																							
A.1	Materiale didaktike për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100																									
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>																									
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër																													

<b>Nr. 14</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A11</b> Kampi Veror	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Kampi veror është një ndër aktivitetet e mirepritura nga fëmijët në periudhën e verës.</p> <p>Në zbatim të ligjit 18/2017 " Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Bashkia Shkodër me politikat mbështetëse dhe integruese për të gjithë fëmijët, veçanarisht për fëmijët që kanë më shumë nevojë organizon kampin verorë.</p> <p>Te gjithëfëmijët që marrin shërbime pranë QKPF si dhe fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian përfshihen në kampin verorë. Kampi zhvillohet 2 (dy) javë në muajin qeshor dhe në këtë kamp janë pjesëmarrës 150 fëmijë.</p> <p>Kampi veror është i krijuar për të nxitur zhvillimin mendor, fizik, emocional, psikologjik dhe social për fëmijët e komunitetit dhe duke inkurajuar përfshirjen sociale te tyre. Pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete socializuese, riintegruese dhe sportive, aktivitete të cilat promovojnë socializimin dhe ndërtimin e marrdhënieve te shëndetëshme, sportin dhe të jetuarin në mënyrë aktive, si një mjet për riintegrimin e plotë të tyre në familjet, shkollat dhe komunitetet ku fëmijët jetojnë.</p> <p>Ne zhvillimin e ketij aktiviteti gjithpërfshirës , bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbarevajtjen e kampit verore duke siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe argetimin e tyre. Gjithashtu NJMF koordinon punën ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe organizatave partnereve, brenda territorit të qytetit.</p> <p>Gjatë gjithë periudhës së kampit verore për femijet pjesëmarrës ka trajtimin me vakt ushqimorë, lojra dhe shëtitje, si dhe plan të përcaktuar që këto ditë të shërbejnë edhe për marrje informacioni për tema sociale, shkëmbim dhe argëtim per fëmijët .</p> <p>Ne organizimin e kampit verore përfshihen të gjithë punonjësit e shërbimit social, ku secili ka rol të caktuar në ecurinë e aktiviteteve të përcaktuara. Për funksionimin e mirë të kampit veror sigurohet një bazë materiale e domosdoshme si ne uniforma, lojra didaktike, lojra sportive, ushqim të shëndetshëm dhe logjistikë ndihmëse si transport etj</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë gjithpërfshirjen e femijeve ne kampin verorepërmirësimin e situatës së fëmijëve dhe familjeve në vështirësi të theksuar social-ekonomike në Bashkinë e Shkodrës</li> <li>• Synojmë uljen e numrit të fëmijëve në situatë rruge në Bashkinë e Shkodrës.</li> <li>• Synojmë ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në veshtiresi dhe jo vetem.</li> <li>• Synojme rritjen e aksesit të fëmijëve dhe familjeve për të përfituar shërbime të përkujdesit, shërbime mbrojtëse dhe integruese</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimngushtë me institucionet / strukturatpërgjegjëse.</li> <li>• Organizimipunështëdrejtpërdrejtë me fëmijëtdhefamiljen duke përfshirëkëshillimdhembështetje.</li> <li>• Identifikimindhepërfshirja e fëmijëvetëmoshës6-14 vjec ne kampinveror</li> <li>• Hartimi I planitdheprogramittëpërcaktuarpërcdoditë</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Numri i fëmijëve në situatë rruge i zvogëluar.</li> <li>○ Shërbime mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë të vështira.</li> <li>○ Fëmijë nga familje në vështirësi e te integruar dhe të gjithëpërfshirë.</li> <li>○ Kushtet e familjeve të fëmijëve në situatë rruge të përmirësuara..</li> <li>○ Shërbime parandaluese mbi fenomenin "Fëmijë në Situatë Rruge".</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Fëmijët në situatë rruge Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatrat				Bashkia Skuadrat e terrenit Organizatrat Institucionet publike Komuniteti Studentët e Universitetit të Dëpartmentit Punë Sociale dhe Psikologji		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Blerje materiale didaktike dhe lojra për kampin veror për fëmijë	200			200	
A.2	Shërbim Katering për kampin veror	300			300	



	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje materiale didaktike dhe lojra për kampin veror për fëmijë	200			200		
A.2	Shërbim Katering për kampin veror	300			300		
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje materiale didaktike dhe lojra për kampin veror për fëmijë	200			200		
A.2	Shërbim Katering për kampin veror	300			300		
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Shkodër Stafi i qendrave komunitare <b>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</b>				

<b>Nr. 15</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A12.</b> Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror- Burimet e veta	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës, ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët jetim biologjik dhe social 3 institucione të ndarë përkatësisht sipas grupmoshave 0 – 5 vjeç, 6 – 15 vjeç dhe 16 – 18 vjeç. Ne besojmë se institucionalizimi nuk është zgjidhja më e mirë për fëmijët pa përkujdes prindëror, pasi nuk përbush kërkesat themelore për rritje, edukim dhe zhvillim të shëndetshëm. Gjithashtu fëmijët dhe të rinjtë të cilët pasi kanë mbushur moshën, kanë dalë nga strukturat rezidenciale, kanë shumë vështirësi në integrimin e tyre në jetën socio ekonomike; kanë braktisur shkollën, nuk kanë marrëdhënie të qëndrueshme në punë e për pasojë janë në situatë të vështirë socio-ekonomike dhe vulnerabël ndaj fenomeneve sociale si trafikimi, abuzimi, varësia nga substancat narkotike, etj.</p> <p>Me synim ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, Bashkia e Shkodrës po zbaton shërbime alternative të kujdestarisë për fëmijët pa përkujdes prindëror; shërbimin e kujdestarisë familjare me lidhje gjaku, shërbimin e kujdestarisë familjare pa lidhje gjaku dhe ofrimin e shërbimit Qendra Alternativa e Kujdesit, pranë shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç.</p> <p>Ndërsa me synim parandalimin e institucionalizimit, po koordinohen shërbimet në territor për fuqizimin e familjeve në vështirësi socio-ekonomike, me krijimin e qendra komunitare "Për Familjen". Përveç kësaj, për të rinjtë të cilët tashmë kanë dalë nga strukturat rezidenciale janë planifikuar shërbime për mbështetjen e fuqizimin e tyre përmes përfshirjes në kurse profesionale me synim arritjen e autonomisë për kujdesin personal social, ekonomik, etj.</p> <p>Në zbatim politika vendore dhe të Planit Social Vendor 2018-2021, fishë projektit nr 11 "Shërbime alternative për fëmijët pa kujdes prindëror" kemi zbatuar projektin për ngritjen e një shërbimi të ri alternativ në spektrin e shërbimeve të përkujdesjes sociale për të mitur, në modelin e "Shtëpi familje" në kuadër të projektit "<i>Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës</i>"(numri i projektit: AID 10950), zbatuar nga Shoqata IPSIA, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, CODE PARTNERS, SHIS, Universitetin e Bolonjës, Universitetin e Shkodrës dhe Kooperativën Lybra, financuar nga fondet e agjencisë publike <i>Agenzia Italiana per la Cooperazione e lo Sviluppo</i>, e cila synon të ofrojë shërbime rezidenciale për të mitur pa kujdes prindëror (Shërbimi në Strehëza), sipas pikës 11/c të VKM nr. 518 datë 04.09.2018, si model i parë në vendin tonë i ndërtimit të shtëpive familje për fëmijët pa kujdes prindëror në qeverisjen vendore.</p> <p>Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ synojmë të ofrojmë një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar duke synuar të përfshihet brenda procesit të deinstitutionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri dhe kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institutionalizimit 2020-2022 të miratuar me VKM nr.706, datë 09.09.2020 "Për miratimin e Planit kombëtar të deinstitutionalizimit të fëmijëve 2020-2022 dhe të Planit të veprimit në zbatim të tij.</p> <p>Gjithashtu struktura përbush standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM nr.659 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale".</p> <p>Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror është një strukturë e vogël që ka si qëllim përfshirjen sociale deri tetë të miturve, të cilëve u ofrohet një mbështetje emocionale e orientuar për të garantuar mbrojtje dhe mbështetje në funksionet evolutive që janë çënuar prej dinamikave familjare. Shërbimi ka si objekt kryesor që të kontribuojë nëpërmjet rekuperimit emotiv dhe marrëdhënien edukative për t'i ndihmuar të miturit që të arrijnë shkallën më të lartë të autonomisë. Njëkohësisht punohet për fuqizimin social ekonomik të familjeve apo përkujdesjes alternative me qëllim deinstitutionalizimin sa më të shpejtë të fëmijëve.</p> <p>Deri në dt 30.05.2022 financimi dhe vënia në funksion e Strehëzës është siguruar nga projekti "<i>Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës</i>".</p> <p><i>Gjatë vitit 2021, me 10.12.2021, Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Fondin Social të vitit 2022, i cili siguron vazhdimësinë e financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror nga dt. 01.06.2022.</i></p> <p>MSHMS në kuadër të aplikimit në Fondin Social të vitit 2022, ka përzgjedhur Bashkinë Shkodër fituese, sipas shkresës së dërguar me nr. 7247 datë 06.05.2022, ku bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese e projekt – propozimit "Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror" në kuadër të fondit social 2022. Shkresës së dërguar nga MSHMS me nr. 2084 Prot. Datë 11.05.2022, "Transferim fondesh për financimin e ofrimin të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022" në vlerën 7,841,995 dhe shkresës nr. 69/43 prot. datë 16.05.2022 "Akordim i fondeve për financimin e ofrimin të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022.</p> <p>Aktualisht pranë kësaj strukture janë sistemuar 8 fëmijë, me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Bashkisë të datës 30.03.2022. Shërbimi ofrohet nga 7 (shtatë punonjës) i përbërë nga 3 specialistë, 2 ndihmës specialist, 1 kuzhinier/sanitar dhe 1 përgjegjës i Strehëzës, personel në strukturën e Bashkisë Shkodër. Shpenzimet për administrimin shërbimin dhe menaxhimin e strehëzes mbulohe nga fondi i transferuar nga MSHMS dhe Bashkia Shkodër si bashkëfinancuese, në kuadër të projektit fitues të aplikuar nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Nga buxheti i shtetit transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është bërë në tre këste: Viti i parë është financuar në vlerën 90% nga muaji qershor 2022 deri në fund të vitit. Viti i dytë i zbatimit të projektit është financuar në</p>		

masën 60% të vlerës së projektit dhe në masën 30% në vitet në vijim, referuar VKM nr. 150, datë 20.03.2019 pika 29 dhe udhëzuesit të Fondit Social për vitin 2022.

**Paga dhe shtesat mbipaga.**

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", i ndryshuar.

**Kontributi për sigurime shoqërore dheshëndetësore.**

Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor" dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore"

**Kompensimpër kryefamiljarëtmengarkesëmëmëshumësetrepersonanëngarkim në familje**

Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar , VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërbllim sipas rastit.

**ii. Synimi i projektit**

- Përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve pa përkujdes prindëror, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve alternative.
- Ofrimi i shërbimeve integruese dhe fuqizuese për jetimët biologjike dhe social në territorin e Bashkisë.
- Krijimi i modelit alternativ Strehëz përkundër institucioneve të mëdha rezidenciale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Bashkëpunim dhe koordinimi i punës me ministrinë e linjës dhe donatorë e organizata jo fitimprurës për sigurimin e financimit të nevojshëm për vënien në funksion të institucionit.
- Vënia në funksion dhe konsolidimi e Strehëzës për fëmijët pa përkujdes prindëror të bashkisë së Shkodrës
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe mbështetja gjatë punës e personelit të strehëzës.
- Edukimi dhe mbështetja psikologjike e sociale e fëmijëve pa përkujdes prindëror.
- Strehëza është bërë pjesë e rrjetit të qendrave komunitare "Për Familjen" me qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve biologjike për mirë rritjen e fëmijëve pranë familjeve të tyre.
- Koordinimi i shërbimeve të ngjashme që ofrohen në territor me synim shmangien e mbivendosjes së shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve sa më afër nevojave të target grupit jetimë.

**b) Rezultatet që prisni**

- Strehëz e gatshme për fëmijët pa përkujdes prindëror, si një shërbim alternativ në kuadër të deinstitutionalizimit të fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe parandalimit të institutionalizimit për fëmijët e familjeve në vështirësi socio-ekonomike.
- Personeli i strehëzës i trajnuar dhe me formimin e duhur për të rritur fëmijët në këtë institucion
- Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetesës për fëmijët e bashkisë së Shkodrës që jetojnë në institucione rezidenciale dhe pa përkujdes prindëror.
- Të rinj jetimë, pa përkujdes prindëror e familjar, të fuqizuar dhe autonom.
- Ofrimi i shërbimeve sa më cilësorë për fëmijet jetim biologjikë dhe sociale pranë Shtëpi Familje ose Strehëz.
- Model i vlefshëm për institucionet publike përgjegjëse, për tu replikuar edhe në bashkitë e tjera të vendit.

**c) Aktorët e mundshëm**

Komuniteti  
Bashkia  
Organizatrat  
Institucionet rezidenciale

**d) Kontributet e mundshme në projekt**

Bashkia Shkodër  
Ministria e Shëndetësisë dhe Përfshirjes Sociale  
Organizatrat Partnere  
Institucionet rezidenciale  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

**e) Shpenzimet e llogaritura**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (me burimet e veta)	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	4,912	4,250	662			
A.2 Mjete Kancelarike	100			100		
A.3 Materiale higjeno sanitare	200			200		
A.4 Dezinfektim	80			80		
A.5 Ilaçe, materiale dhe shërbime mjekësore	70			70		
A.6 Karburant dhe vaj	360			360		

A.7	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	96			96		
A.8	Shpenzime të siguracionit/kolaudimit të mjetit të transportit	60			60		
	<b>Shuma</b>	<b>5,878</b>	<b>4,250</b>	<b>662</b>	<b>966</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b> (me burimet e veta)		<b>Totali</b> (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>	<b>Kapitale</b>
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	4,912	4,250	662			
A.2	Mjete Kancelarike	100			100		
A.3	Materiale higjeno sanitare	200			200		
A.4	Dezinfektim	80			80		
A.5	Ilaçe, materiale dhe shërbime mjekësore	70			70		
A.6	Karburant dhe vaj	360			360		
A.7	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	96			96		
A.8	Shpenzime të siguracionit/kolaudimit të mjetit të transportit	60			60		
	<b>Shuma</b>	<b>5,878</b>	<b>4,250</b>	<b>662</b>	<b>966</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b> (me burimet e veta)		<b>Totali</b> (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>	<b>Kapitale</b>
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	4,912	4,250	662			
A.2	Mjete Kancelarike	100			100		
A.3	Materiale higjeno sanitare	200			200		
A.4	Dezinfektim	80			80		
A.5	Ilaçe, materiale dhe shërbime mjekësore	70			70		
A.6	Karburant dhe vaj	360			360		
A.7	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	96			96		
A.8	Shpenzime të siguracionit/kolaudimit të mjetit të transportit	60			60		
	<b>Shuma</b>	<b>5,878</b>	<b>4,250</b>	<b>662</b>	<b>966</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b> (me transfertë të kushtëzuar, në kuadër të aplikimit në Fondin Social të vitit 2022, ka përzgjedhur Bashkinë Shkodër fituese, sipas shkresës së dërguar me nr. 7247 datë 06.05.2022, ku bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese e projekt – propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror” në kuadër të fondit social 2022)		<b>Totali</b> (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>	<b>Kapitale</b>
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime për 2 punonjës	2,077				2,077	
A.2	Furnizime me ushqime	1,728				1,728	
A.3	Shpenzime për honorare, Bonus mujor për fëmijët sipas udhëzimit	114				114	
A.4	Veshje dhe rroba fëmijësh	240				240	
	<b>Shuma</b>	<b>4,159</b>				<b>4,159</b>	



Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 (me transfertë të kushtëzuar, në kuadër të aplikimit në Fondin Social të vitit 2022, ka përzgjedhur Bashkinë Shkodër fituese, sipas shkresës së dërguar me nr. 7247 datë 06.05.2022, ku bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese e projekt – propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror” në kuadër të fondit social 2022)		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime për 2 punonjës	2,077				2,077	
A.2	Furnizime me ushqime	1,728				1,728	
A.3	Shpenzime per honorare, Bonus mujor për fëmijët sipas udhëzimit	114				114	
A.4	Veshje dhe rroba fëmijësh	240				240	
	<b>Shuma</b>	<b>4,159</b>				<b>4,159</b>	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 (me transfertë të kushtëzuar, në kuadër të aplikimit në Fondin Social të vitit 2022, ka përzgjedhur Bashkinë Shkodër fituese, sipas shkresës së dërguar me nr. 7247 datë 06.05.2022, ku bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese e projekt – propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror” në kuadër të fondit social 2022)		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime për 2 punonjës	2,077				2,077	
A.2	Furnizime me ushqime	1,728				1,728	
A.3	Shpenzime per honorare, Bonus mujor për fëmijët sipas udhëzimit	114				114	
A.4	Veshje dhe rroba fëmijësh	240				240	
	<b>Shuma</b>	<b>4,159</b>				<b>4,159</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar - Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Strehëza për fëmijët pa kujdes prindëror Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër					

<b>Nr. 16</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A13.</b> Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në kuadër të punës për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në institucionet rezidenciale që administrohen nga Bashkia Shkodër kemi bashkëpunuar me organizatën "Shpresë për Botën", që mbështet këto institucione ndër vite. Shtëpia e fëmijës 0-5 vjec ofron shërbim rezidencial përfoshnjat dhe fëmijët e braktisur, jetimë biologjik ose social. Gjithashtu ofron shërbim ditor për foshnjat e fëmijët në nevojë. Shërbimet e ofruara janë nga më të ndryshmet duke filluar nga trajtimi mjekësor, psikosocial për foshnjat, përkujdesje, mirërritje dhe këshillim për nënat, etj. Kapaciteti i këtij institucioni është 35 fëmijë rezidencial dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 24.</p> <p>Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç ofron shërbim rezidencial për kategoritë e fëmijëve që janë kryesisht fëmijë të braktisur, fëmijë që vijnë nga familje në vështirësi dhe pamundësi ekonomike për tu përkujdesur dhe jetimë biologjik. Fëmijët marrin shërbime të tilla siç janë: mirërritja dhe edukimi, shërbimi psikosocial, mjekësor, integrimi në komunitet, rikthim pranë familjeve biologjike, ndjekje të rasteve pas daljes nga insitucioni, veprimtari te tjera edukuese dhe argëtuese. Kapaciteti i shtëpisë së fëmijës është 70 dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 29.</p> <p>Qendra e Zhvillimit është një institucion i përkujdesit shoqëror, qëllimi i të cilit është përkujdesi dhe riaftësimi fizik dhe mendor i personave me aftësi të kufizuara. Institucioni ofron kushte optimale për të gjithë personat e sistemuar në të si dhe kushtet ambjentale, pajisje me mjete të përshtatshme për realizimin e rehabilitimit, trajtimit dhe integritit të personave me aftësi ndryshe që marrin shërbim në qendër.</p> <p>Gjatë vitit organizata "Shpresë për Botën" ka vazhduar aktivitetin për mbështetjen dhe përmirësimin e shërbimeve në institucionet rezidenciale në varësi të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Për përmirësimin e shërbimeve ndaj fëmijëve dhe personave me aftësi ndryshe për krijimin e një atmosfere sa më të këndshme dhe sa më të përshtatshme për çdo grup-moshë që jeton në secilin institucion të përkujdesit rezidencial, me mbështetjen e fondacionit "Shpresë për botën", organizohen festimet e festave zyrtare, festimet e ditëlindjeve të secilit fëmijë dhe gjithashtu t'i plotësohen nevojat specifike të fëmijëve.</p> <p>Fondacionit "Shpresë për botën", mbështet edhe fëmijët që marrin shërbim rezidencial tek Strehëza për fëmijët pa kujdes prindëror, kjo mbështetje konsiston në festimin e ditëlindjeve të fëmijëve .</p> <p>Gjate gjithë vitit fondacionit "Shpresë për botën", ka mbështetur te gjitha familjet që janë referuar nga QKPF si familje në vështirësi, duke ndikuar në lehtësimin e situatës së tyre.</p> <p>Fondacionit "Shpresë për botën", mbështet edhe fëmijët që marrin shërbim në QK Multifunkionale ku siguron transportin e fëmijëve, ushqim, klasat pashkollore, fuqizim ekonomik të familjeve rome, aktivitete argëtuese dhe integruese të fëmijëve përfitues shërbimesh në këtë qendër.</p> <p>Gjatë vitit 2025 dhe në vijim do të vazhdojë bashkëpunimi me organizatën Shpresë për Botën për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për fëmijët në institucionet rezidenciale dhe përfituesit në qendrën e zhvillimit me qëllim integrimin social të fëmijëve dhe të rinjve.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë vazhdimësinë e bashkëpunimit midis Bashkisë së Shkodrës dhe fondacionit "Shpresë për Botën".</li> <li>• Synojmë përmirësimin e kushteve për foshnjat, fëmijët dhe PAK që janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit rezidencial.</li> <li>• Përmirësimin i shërbimit të përkujdesjes në institucionet rezidenciale në varësi të Bashkisë Shkodër.</li> <li>• Fuqizimin e familjeve në vështirësi social-ekonomike</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizime për kremtimin e festave ndërvjetore në Shtëpitë e fëmijëve.</li> <li>▪ Mbështetje me transport për realizimin e takimeve të fëmijëve me familjet biologjike me qëllim përmirësimin dhe forcimin e marrëdhënies prind-fëmijë.</li> <li>▪ Furnizim me veshmbathje sipas nevojave të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkollore/ furnizim me pampers sipas nevojave që ka Shtëpia e Foshnjës, në mënyrë që të ndihmohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për mirërritjen e fëmijëve të këtyre institucioneve.</li> <li>▪ Organizimi i festave të ditëlindjeve të fëmijëve në të gjithë institucionet rezidenciale dhe blerja e dhuratave të ndryshme për ta.</li> <li>▪ Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fëmijët e Institucioneve.</li> <li>▪ Ndërhyrje rikostruktuese pranë ambjentëve të Shtëpisë së Foshnjës/ Shtëpisë së fëmijës Shkollore, etj.</li> <li>▪ Mbështetje për nevoja emergjente për Shtëpinë e fëmijës.</li> <li>▪ Hartimi dhe realizimi i projekteve të veçanta që mund të paraqiten nga Shtëpia e Fëmijës ose projekte që mund të paraqiten nga vetë fondacioni për Shtëpinë e fëmijës.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Përmirësimi i shërbimit të përkujdesjes, mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjes dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shkodër.</li> <li>○ Integrimi sociali fëmijëve duke synuar përfshirjen e tyre në aktivitete social kulturore.</li> <li>○ Lehtësimin e kontakteve me familjet biologjike me qëllim krijimin e kushteve për kthim sa më të shpejtë të fëmijëve dhe PAN në familje.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Institucioni Shtëpia e Foshnjes Institucioni Shtëpia e Fëmijës Shkollor Qendra e Zhvillimit, Shkodër Bashkia Shkodër Fëmijët dhe personat me aftësi ndryshe të sistemuar në institucionet e përkujdesit Familjet e fëmijëve të sistemuar në institucione				Fondacioni "Shpresë për botën" Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							
	<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							
	<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							
	<b>Shuma</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b>				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027				Drejtoria e Shërbimit Social, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Fondacionit Shpresë për Botën <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër			

<b>Nr. 17</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A14</b> Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>						
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>								
<b>i. Situata</b>								
<p>Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër është e ngritur dhe funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë prandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.</p> <p>Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.</p> <p>Gjatë vitit janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe janë marrë masa emergjente për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative apo shërbime të tjera alternative..</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 46 pika gj bashkitë janë përgjegjëse për financimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Planit për Aftësim Prindëror.</p> <p>Në këtë kuadër për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia e Shkodër ka planifikuar të financojë shërbimet sociale mbështetëse, si pako ushqimore dhe higjieno sanitare dhe veshmbathje për fëmijët me masë mbrojtëse dhe familjen me qëllim fuqizimin social ekonomik të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.</p>								
<b>ii. Synimi i projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje direkte për fëmijët që rrezikojnë të humbin kujdesin prindëror.</li> <li>• Fuqizim ekonomik dhe shoqëror të familjeve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Përmirësim i ofrimit të shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje</li> <li>• Shtrirjen e shërbimeve për rastet e fëmijët në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit, trafikimit, dhunës ndaj fëmijëve.</li> </ul>								
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizimi i mbledhjeve të grupeve teknike ndërsektoriale për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>▪ Hartimi i planeve individuale të mbrojtjes për fëmijët në nevojë për mbrojtje.</li> <li>▪ Menaxhim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>▪ Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendorë dhe kombëtarë duke rujtur të dhënat e fëmijës.</li> <li>▪ Monitorimi i zbatimit të planit individual të mbrojtjes për fuqizimin e familjes dhe fëmijës në nevojë për mbrojtje.</li> <li>▪ Hartimi i raporteve statistikore tremujore dhe vjetore për agjencisë shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë shkodër si dhe të njësive administrative</li> </ul>								
<b>b) Rezultatet që prisni</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtjen e fëmijës me anë fuqizimit social ekonomik të familjes.</li> <li>• Garantim mirëqënies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</li> <li>• Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet dhe organizatat partnere si dhe komunitetin.</li> <li>• Ndikim në parandalimin e fenomeneve sociale (dhuna, shfrytëzimi, trafikimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve)</li> </ul>								
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Komuniteti Institucionet publike OJF-të Bizneset private ASHMDF				Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Institucionet publike dhe private OJF-të ASHMDF Bizneset private				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>								
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>			<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Veshmbathje (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50			
A.2	Pako ushqimore dhe higjieno sanitare (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50			



<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Veshmbathje (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50		
A.2	Pako ushqimore dhe higjensanitare (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50		
<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Veshmbathje (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50		
A.2	Pako ushqimore dhe higjensanitare (për 5 fëmijë)	<b>50</b>			50		
<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar-Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 18</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A15.</b> Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Mbështetja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim; si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambient familjar, qoftë kjo familja biologjike apo familje alternative është një nga prioritetet që Bashkia Shkodër ka ndërmarrë duke bashkëpunuar edhe me organizata joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.</p> <p>Në zbatim të VKM nr 149, datë 13.3.2018 'Për Kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdesatë për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familjen kujdestare", në Bashkinë Shkodër është i ngritur dhe funksionon komisioni multidisiplinar i kujdestarisë, i cili shqyrton kërkesat e familjeve kujdestare dhe vendos caktimin e fëmijës pa kujdes prindëror në familje kujdestare. Qëllimi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative në strukturat rezidenciale për fëmijët drejt deinsitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Sistemimi i fëmijëve në familjen kujdestare organizohet dhe mbikqyret nga Bashkia nëpërmjet komisionit multidisiplinar të kujdestarisë.</p> <p>Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjithashtu dhe numri në rritje i fëmijëve që punojnë ose lypin, i fëmijëve që janë braktisur ose janë lënë përkohësisht nën kujdesin e të afërmeve, nevojitet të trajtohet me prioritet nga Bashkia ashtu dhe shoqëria civile.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me organizatat partnere janë identifikuar fëmijë nga familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për mbështetjen e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinsitucionalizimin e tyre.</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit mbi shërbimet alternative që ofrohen për fëmijët në rrezik institucionalizimi është në fokus të punës së bashkisë dhe çdo vit organizohen fushata ndërgjegjësimi në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi i shërbimeve parandaluese në mbështetje të familjeve në vështirësi.</li> <li>• Deinsitucionalizimi nëpërmjet fuqizimit të familjes që kanë fëmijët në institucionet e përkujdesit rezidencial.</li> <li>• Synojmë krijimin e mundësive dhe zbatimin e të drejtës themelore të fëmijëve për të jetuar e rritur në një ambient të përshtatshëm familjar, qoftë kjo familja biologjike apo familja kujdestare.</li> <li>• Parandalimi i institucionalizimit të fëmijëve.</li> <li>• Promovimi i kujdestarisë familjare si një alternative në rastet e fëmijëve dhe familjeve në vështirësi.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fuqizimin e strukturave të shërbimeve sociale në menaxhimin e gjithë procesit të kujdestarisë që nga identifikimi, selektimi, trajnimi i familjeve kujdestare, ndjekja e vendosjes së fëmijës në kujdestari dhe përshtatja me familjen kujdestare.</li> <li>▪ Krijimin e një grupi ekspertesh që do trajnojnë në vijim gjithë punonjësit socialë të përfshirë në këtë iniciativë</li> <li>▪ Ndërhyrje në fuqizimin e familjeve me qëllim parandalimin apo re-integrimin e fëmijëve nga kujdesi rezidencial.</li> <li>▪ Monitorimi i rasteve të fëmijëve pa kujdes prindëror të vendosur në familje kujdestare.</li> <li>▪ Advokim për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurial për shërbimin e kujdestarisë</li> <li>▪ Fushata sensibilizimi</li> <li>▪ Përgatitje të fletëpalosjeve për ndërgjegjësim dhe informim të komunitetit</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ngritje e kapaciteteve në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, parandalimit dhe integritit.</li> <li>○ Rritje e numrit të familjeve të mundshme kujdestare, të informuara dhe të trajnuara.</li> <li>○ Parandalimi i rasteve të institucionalizimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;</li> <li>○ Përmirësimi i situatës ekonomike e sociale për familjet dhe fëmijët në rrezik</li> <li>○ Fuqizim i familjeve biologjike të fëmijëve të institucionalizuar.</li> <li>○ Rritje e ndërgjegjësimit në lidhje me shërbimet alternative për fëmijët.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Fëmijët pa kujdes prindëror Familjet kujdestare Familjet në vështirësi social-ekonomike	Bashkia Organizatata Institucionet publike	



Institucionet publike Organizatat Familjet dhe fëmijët në situatë rruge		Komuniteti				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali(mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	<b>Shuma</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër			

<b>Nr. 19</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A16</b> Realizimi i Aktiviteteve për Rininë	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Bashkia Shkodër, përmes Sektorit të Rinisë, ka si prioritet krijimin e një ambienti mbështetës dhe ofrimin e mundësive për të rinjtë që të zhvillohen në fusha të ndryshme të jetës sociale, kulturore dhe profesionale. Rinia ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme për të zhvilluar aftësitë e tyre jetësore dhe profesionale. Ata kërkojnë trajnimet që ndihmojnë në forcimin e aftësive të komunikimit, lidhshimit dhe menaxhimit të stresit, të cilat janë të domosdoshme për të përballuar sfidat e jetës dhe për të u integruar me sukses në tregun e punës.</p> <p>Dita Kombëtare e Rinisë është një ngjarje e rëndësishme për shoqërinë, pasi i jep mundësinë rinisë të reflektojë mbi rolin dhe kontributin e saj në zhvillimin e shoqërisë dhe kombit. Ky ditë ka një domethënie të madhe në kontekstin e ngritjes së vetëdijes për nevojat dhe të drejtat e të rinjve, si dhe për mundësitë që ata kanë për të kontribuar në forma të ndryshme.</p> <p>Në këtë ditë, mund të organizohet një program që përfshin aktivitete kulturore dhe sociale, duke inkurajuar pjesëmarrësit të angazhohen dhe të festojnë në një mënyrë kreative. Aktivitetet mund të përfshijnë performanca muzikore, ku rinia mund të këndojë, të luajë në grupe muzikore ose të performojë në mënyra të tjera. Gjithashtu, mund të zhvillohen punëtori për krijimin e artit, si ekspozita pikturë, grafikë, fotografi ose krijimi i objekteve artizanale, që do të ndihmojnë në shprehjen kreative dhe zhvillimin e aftësive të reja.</p> <p>Një tjetër nevojë e rëndësishme është orientimi në karrierë, për të cilin rinia ka nevojë për informacione dhe mbështetje për të bërë zgjedhje të informuara. Pjesëmarrja në sesione orientimi dhe këshillimi profesional ndihmon të rinjtë të eksplorojnë mundësitë e karrierës që i përshtaten interesave dhe aftësive të tyre. Rinia është gjithashtu e interesuar për sipërmarrje, ndaj Sektori i Rinisë duhet të ofrojë mbështetje dhe lehtësi për ata që duan të ndërmarrin iniciativa dhe projekte, duke inkurajuar inovacionin dhe krijimtarinë.</p> <p>Aktivitetet sportive dhe kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e rinisë, duke ofruar mundësi për të shfaqur talentet e tyre dhe për të ndërtuar lidhje të reja. Këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e ndjenjës së përkatësisë dhe krijojnë një mjedis pozitiv për zhvillimin personal.</p> <p>Përveç aktiviteteve edukative dhe kulturore, rinia ka nevojë për aktivitete argëtuese që promovojnë relaksim dhe krijimin e lidhjeve sociale. Këto aktivitete, si festivalet muzikore, konkurset e talenteve, eventet sportive dhe shfaqjet artistike, ofrojnë mundësi për të rinjtë të argëtohen dhe të shijojnë momentet e bashkëpunimit dhe miqësisë. Aktivitetet argëtuese ndihmojnë në ndërtimin e një ambienti të shëndetshëm dhe pozitiv, ku rinia mund të shprehë veten, të zbulojë pasionet dhe të krijojë kujtime të çmuara.</p> <p>Rinia ka nevojë për mundësi që të angazhohet në aktivitete që promovojnë përfshirjen sociale, shëndetin dhe angazhimin në çështje të tjera të rëndësishme për komunitetin, siç janë fushatat ndërgjegjësuese dhe aktivitete që përfshijnë vullnetarizmin. Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi mundësitë që ofrohen në fusha të ndryshme, si edukimi për shëndetin mendor, janë gjithashtu të rëndësishme për rininë. Rrjetet sociale dhe fushatat informuese mund të shërbejnë si mjete efikase për të arritur tek ata. Me rritjen e sfidave emocionale dhe stresit, është e rëndësishme që të rinjtë të kenë akses në shërbime për shëndetin mendor dhe mbështetje psikologjike.</p> <p>Vullnetarizmi është një tjetër prioritet për Bashkinë Shkodër, pasi ofron mundësi për të rinjtë të angazhohen në aktivitete me vlerë për komunitetin dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe profesionale. Pjesëmarrja në fushata ndërgjegjësuese dhe aktivitete që promovojnë përfshirjen sociale dhe angazhimin në çështje të rëndësishme për komunitetin, si dhe projektet e vullnetarizmit, ndihmojnë të rinjtë të fitojnë përvoja të vlefshme dhe të ndërtojnë lidhje të reja sociale. Këto aktivitete inkurajojnë rininë të kontribuojnë në zgjidhjen e sfidave komunitare dhe të zhvillojnë një ndjenjë të fortë përgjegjësie dhe përkatësie.</p> <p>Përmes aktiviteteve dhe programeve të tij, Sektori i Rinisë synon të përmbushë këto nevoja dhe të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës. Kjo përfshin zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, organizimin e ngjarjeve kulturore dhe sportive, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe mentorimit për të rinjtë. Çdo vit organizohen ngjarje të mëdha për të festuar dhe përfshirë rininë, si koncerte dhe festivale kulturore, duke ndihmuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për ta dhe për komunitetin.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë krijimin e një ambienti mbështetës.</li> <li>• Synojmë të nxisim zhvillimin e aftësive jetësore.</li> <li>• Synojmë orientimin e të rinjve në karrierë.</li> <li>• Synojmë të japim mbështetje për sipërmarrje.</li> <li>• Synojmë promovimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore.</li> </ul>		

- Synojmë organizimin e aktiviteteve argëtuese.
- Synojmë të nxisim angazhimin në çështje sociale.
- Synojmë të informojmë dhe të ndërgjegjësojmë.
- Synojmë të japim mbështetje për shëndetin mendor.
- Synojmë të krijojmë një rrjetzim për mbështetjen e të rinjve.

### iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- **Trajnime:** Organizimi i sesioneve të trajnimeve për komunikim, menaxhimin e stresit, dhe aftësitë e lidërshiptit.
- **Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë:** Ofrimi i sesioneve për këshillim dhe orientim në fushat profesionale për të rinjtë.
- **Mbështetje në Sipërmarrje:** Mbështetje për iniciativa rinore dhe organizim konkurses për projekte sipërmarrëse.
- **Aktivite Sportive:** Organizimi i garave dhe lojërave sportive për të promovuar aktivitetin fizik dhe bashkëpunimin.
- **Evente Kulturore:** Organizimi i festivaleve, koncerteve dhe ekspozitave për të shfaqur talentet e rinisë.
- **Aktivite Argëtuese:** Planifikimi i ngjarjeve argëtuese, si konkurset e talenteve dhe aktivitete jashtëshkollore.
- **Aktivite për Ndërgjegjësim Social:** Organizimi i aktiviteteve mbi çështje sociale që ndihmojnë komunitetin dhe promovimi i barazisë gjinore.
- **Fushata Informuese:** Realizimi i fushatave për informimin e rinisë mbi mundësitë për edukim, punësim dhe shërbime sociale.
- **Shërbime për Shëndetin Mendor:** Ofrimi i sesioneve mbështetëse për shëndetin mendor, përfshirë aktivitete relaksuese dhe terapi me psikologë.
- **Krijimi i Rrjeteve Sociale:** Nxitja e lidhjeve ndërmjet të rinjve për të ndihmuar në krijimin e një komuniteti mbështetës dhe bashkëpunues.

### b) Rezultatet që prisni

- Zhvillimi i aftësive: Të rinjtë do të zhvillojnë aftësi të rëndësishme jetësore, duke përmirësuar komunikimin, lidërshiptin dhe punën në grup.
- Pjesëmarrje aktive: Rritja e nivelit të angazhimit të rinisë në aktivitete komunitare dhe në proceset vendimmarrëse.
- Fuqizimi i sipërmarrjes: Të rinjtë do të jenë më të njohur me mundësitë e sipërmarrjes dhe do të kenë ide të qarta për nisma të reja.
- Promovimi i shëndetit mendor: Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e shëndetit mendor dhe ofrimi i mbështetjes për ata që kanë nevojë.
- Rritja e aktivitetit sportiv: Ngritja e numrit të pjesëmarrësve në aktivitete sportive, duke kontribuar në shëndetin fizik dhe mirëqenien.
- Shfaqja e talenteve: Të rinjtë do të kenë mundësi të shfaqin talentet e tyre përmes eventeve kulturore dhe artistike.
- Ndërgjegjësimi për Çështje Sociale: Rritja e njohurive dhe angazhimit të rinisë për çështje sociale dhe mbështetje për komunitetin.
- Krijimi i rrjeteve mbështetëse: Formimi i lidhjeve ndërmjet të rinjve dhe organizatave, duke krijuar një rrjet mbështetëse.
- Qasje më të mirë në shërbime: Të rinjtë do të kenë më shumë qasje në shërbime dhe burime që ndihmojnë në zhvillimin e tyre.
- Inovacion dhe krijimtari: Nxitja e mendimit inovativ dhe krijues në mesin e të rinjve, duke i inkurajuar ata të zhvillojnë projekte dhe nisma të reja.

### c) Aktorët e mundshëm

Të rinjtë e Bashkisë Shkodër  
Komuniteti  
OJF  
Biznese të reja

### d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër  
Donatorë të mundshëm  
OJF

### e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	80			80		
A.2	Materiale didaktike	70			70		
A.3	Skenë, foni, audio	150			150		
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	80			80		
A.2	Materiale didaktike	70			70		
A.3	Skenë, foni, audio	150			150		
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	80			80		
A.2	Materiale didaktike	70			70		
A.3	Skenë, foni, audio	150			150		
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Sektori i Rinisë Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 20</b>	<b>P.AG141.Q2.O1.A17</b> Koncerti "Youth Wave"	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>												
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>														
<b>i. Situata</b>														
<p>Koncerti "Youth Wave" organizohet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, duke vënë në qendër të vëmendjes të rinjtë si një forcë aktive në zhvillimin e komunitetit. Ky aktivitet është pjesë e një angazhimi të Bashkisë Shkodër për të mbështetur dhe promovuar talentet e reja, sipërmarrësit e rinj dhe shërbimet që u ofrohen të rinjve, në një mjedis ku rinia nxit inovacion dhe ndryshim.</p> <p>Qëllimi i këtij eventi është të krijojë një hapësirë ku të rinjtë e talentuar nga Shkodra të kenë mundësinë të tregojnë aftësitë e tyre artistike dhe profesionale. Koncerti përfshin një kombinim të performancave artistike nga të rinjtë, si dhe performanca nga artistë të mirënjohur që frymëzojnë brezat e rinj. Ky aktivitet jo vetëm që ofron argëtim dhe kulturë, por gjithashtu shërben si një mundësi për të rinjtë që të angazhohen me publikun dhe të ndajnë talentet e tyre në një platformë të madhe.</p> <p>Përveç promovimit të artistëve të rinj, "Youth Wave" përqendrohet edhe në nxitjen e sipërmarrjeve të reja, duke ofruar një mundësi për bizneset që drejtohen nga të rinjtë ose që ofrojnë shërbime për të rinjtë që të prezantojnë produktet dhe idetë e tyre. Ky aspekt i eventit synon të ndërtojë një lidhje më të fortë midis rinisë dhe zhvillimit ekonomik lokal. Një pjesë tjetër e rëndësishme e "Youth Wave" është promovimi i organizatave të shoqërisë civile që kanë në fokus përmirësimin e kushteve të jetës për të rinjtë, mbështetjen e projekteve rinore dhe angazhimin në nisma që synojnë përfshirjen sociale dhe rritjen e mundësive për të rinjtë. Ky koncert ofron një hapësirë për këto organizata që të ndajnë iniciativat e tyre me një publik më të gjerë dhe të inspirojnë më shumë të rinj që të angazhohen aktivisht në komunitet. Në përfundim, "Youth Wave" është një event që jo vetëm argëton, por edhe fuqizon rininë, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në zhvillimin kulturor dhe social të qytetit.</p> <p style="text-align: center;"><b>LISTA E HONORAREVE:</b></p> <table border="0" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>HonorarepërKëngëtar I</td> <td style="text-align: right;">10,000</td> </tr> <tr> <td>HonorarepërKëngëtar II</td> <td style="text-align: right;">20,000</td> </tr> <tr> <td>HonorarepërKëngëtar III</td> <td style="text-align: right;">50,000</td> </tr> <tr> <td>Honorar, Artist i/e ftuar</td> <td style="text-align: right;">300,000</td> </tr> <tr> <td>HonorarepërInstrumentist</td> <td style="text-align: right;">30,000</td> </tr> <tr> <td>Honorarepër Moderator</td> <td style="text-align: right;">30,000</td> </tr> </table>			HonorarepërKëngëtar I	10,000	HonorarepërKëngëtar II	20,000	HonorarepërKëngëtar III	50,000	Honorar, Artist i/e ftuar	300,000	HonorarepërInstrumentist	30,000	Honorarepër Moderator	30,000
HonorarepërKëngëtar I	10,000													
HonorarepërKëngëtar II	20,000													
HonorarepërKëngëtar III	50,000													
Honorar, Artist i/e ftuar	300,000													
HonorarepërInstrumentist	30,000													
Honorarepër Moderator	30,000													
<b>ii. Synimi i projektit</b>														
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë krijimin e një hapësirë frymëzuese dhe mbështetëse.</li> <li>• Synojmë promovimin dhe vlerësimin e aftësive të reja artistike dhe profesionale.</li> <li>• Synojmë nxitjen e bashkëpunimit dhe kreativitetit.</li> <li>• Synojmë ofrimin e mundësive për zhvillimi personal dhe profesional.</li> <li>• Synojmë rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për rolin dhe përgjegjësinë e tyre.</li> <li>• Synojmë kultivimin e frymës së bashkëpunimit dhe përfshirjes sociale.</li> <li>• Synojmë rritjen e vetëdijësimit për rëndësinë e aktivizmit rinor.</li> <li>• Synojmë krijimin e lidhjeve midis të rinjve dhe organizatave të ndryshme.</li> <li>• Synojmë nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave.</li> </ul>														
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>														
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirë për Organizatave Joqeveritare (OJF): Promovimi i OJF-ve që të prezantojnë projektet e tyre dhe të angazhohen me të rinjtë, duke ofruar mundësi bashkëpunimi dhe mbështetje për iniciativat rinore.</li> <li>• Hapësirë për Bizneset e Reja: Dedikuar promovimit të bizneseve të reja, kjo hapësirë do t'i mundësojë sipërmarrësve të rinj të ekspozojnë produktet dhe shërbimet e tyre, duke rritur ndërlidhjen me të rinjtë dhe komunitetin.</li> <li>• Promovimi i Talenteve të Reja: Organizimi i aktiviteteve dhe performancave për të shfaqur talentet e rinj në muzikë duke i ofruar atyre mundësinë për të shkëlqyer dhe për t'u njohur nga publiku.</li> <li>• Artistë të Njohur: Angazhimi i artistëve të njohur për të ofruar performanca emocionuese, duke i dhënë publikut një natë të paharrueshme, ndërkohë që ata gjithashtu forcojnë aftësitë e tyre artistike dhe thellojnë lidhjet me publikun.</li> <li>• Vullnetarizëm: Inkurajimi i të rinjve për t'u angazhuar si vullnetarë në organizimin dhe mbarvajtjen e aktivitetit, për të zhvilluar aftësi të menaxhimit dhe bashkëpunimit, si dhe për të kontribuar në përmirësimin e komunitetit.</li> </ul>														
<b>b) Rezultatet që prisni</b>														
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Rritja e Angazhimit të Të Rinjve: Rritje e numrit të të rinjve që angazhohen në aktivitete kulturore dhe shoqërore.</li> <li>○ Promovimi i Talenteve: Shfaqje e talentëve të rinj dhe rritja e njohjes së tyre në komunitet dhe përtej tij.</li> <li>○ Fuqizimi i Biznesve të Reja: Rritja e ndërlidhjes mes sipërmarrësve të rinj dhe komunitetit, duke u ofruar atyre mundësi për promovim dhe zhvillim.</li> </ul>														

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Mbeshtetje për OJF-të: Mundësi për OJF-të që të prezantojnë projektet e tyre dhe të rrisin ndikimin në shoqëri.</li> <li>○ Zhvillimi i Aftësive: Rritja e aftësive artistike dhe profesionale të të rinjve.</li> <li>○ Vullnetarizëm: Inkurajimi i një kulture vullnetarizmi dhe angazhimi në përmirësimin e komunitetit.</li> <li>○ Ndërveprimi mes Brezave: Krijimi i mundësive për ndërveprimin midis të rinjve dhe artistëve, si dhe profesionistëve të fushave të ndryshme.</li> <li>○ Ngritja e Ndërgjegjësimit: Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e artit dhe kulturës në jetën e rinisë dhe komunitetit.</li> <li>○ Sukses në Organizimin e Aktiviteteve: Zhvillimi i një modeli të suksesshëm për organizimin e aktiviteteve kulturore që mund të përsëriten në të ardhmen.</li> <li>○ Krijimi i Një Atmosfere Pozitive: Formimi i një mjedisi të mbështetjes dhe frymëzimit, ku të rinjtë ndihen të inkurajuar dhe të motivuar për të shprehur veten.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Të rinjtë e Bashkisë Shkodër Komuniteti OJF Biznese të reja Talentet e reja Artistë të njohur			Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm OJF			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Shërbim për skenë, ndriçim, foni, audio.	300			300	
A.2	Honorare	440			440	
A.3	Materiale promovionale	50			50	
A.4	Trajtim ushqimor për të ftuar	20			20	
A.5	Akomodim në hotel për të ftuar	20			20	
<b>Shuma</b>		<b>830</b>			<b>830</b>	
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Shërbim për skenë, ndriçim, foni, audio.	300			300	
A.2	Honorare	440			440	
A.3	Materiale promovionale	50			50	
A.4	Trajtim ushqimor për të ftuar	20			20	
A.5	Akomodim në hotel për të ftuar	20			20	
<b>Shuma</b>		<b>830</b>			<b>830</b>	
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Shërbim për skenë, ndriçim, foni, audio.	300			300	
A.2	Honorare	440			440	





A.3	Materiale promocionale	50			50		
A.4	Trajtim ushqimor për të ftuar	20			20		
A.5	Akomodim në hotel për të ftuar	20			20		
	<b>Shuma</b>	<b>830</b>			<b>830</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Sektori i Rinisë Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe e Rinisë <b>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</b>				

Nr. 21	P.AG141.Q2.O1.A18 Panairi për të rinjtë	Programi AG141: Përkujdesi Social
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Panairi për të rinjtë është një nismë rinore e fokusuar në krijimin e mundësive konkrete për punësim, orientim karriere dhe zhvillim profesional për të rinjtë. Ky projekt ka si synim të mbledhë në një vend të përbashkët të rinj në kërkim të mundësive të reja dhe përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të punësimit, përfshirë kompani private, institucione publike, organizata joqeveritare dhe ofrues të programeve trajnuese. Eventu është projektuar për të inkurajuar të rinjtë të eksplorojnë fusha të reja dhe të identifikojnë mundësi të përshtatshme për zhvillimin e tyre profesional në një treg pune gjithnjë e më dinamik.</p> <p>Një fokus tjetër i panairit është promovimi i artit, kreativitetit dhe talenteve në fusha të ndryshme artistike. Ky lloj panairi mund të përfshijë ekspozita të pikturave, skulpturave, punimeve artizanale, si dhe performanca muzikore dhe teatrale. Gjatë Panairit, të rinjtë do të kenë mundësinë të ndjekin prezantime nga përfaqësues të ndryshëm të industrisë, të cilët do të ndajnë informacion mbi kërkesat e tregut, aftësitë e nevojshme dhe tendencat aktuale të punësimit. Këto prezantime ofrojnë një perspektivë të vlefshme mbi zhvillimet dhe mundësitë e reja që mund të ndikojnë në vendimet e tyre për karrierën. Përveç kësaj, të rinjtë do të kenë akses në stenda të ndryshme, ku mund të ndërveprojnë personalisht me përfaqësues të bizneseve dhe organizatave, duke shtruar pyetje dhe duke marrë informacion të drejtpërdrejtë mbi pozitat e hapura dhe mundësitë e praktikës.</p> <p>Panairi gjithashtu synon të jetë një burim i pasur edukativ, duke përfshirë seanca mini-trajnime dhe diskutime të drejtuara nga ekspertë të sektorëve të ndryshëm. Në këto aktivitete, të rinjtë do të kenë mundësinë të zhvillojnë aftësi të dobishme, të marrin këshilla për përgatitjen e një CV-je efektive, mënyrën më të mirë për të dalë në pah gjatë intervistave dhe për të ndërtuar një prezencë profesionale. Kjo qasje praktike ndihmon të rinjtë të përgatiten më mirë për sfidat e tregut të punës dhe u ofron atyre mjetet e nevojshme për të patur sukses në një konkurrencë të lartë.</p> <p>Ky panair është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal. Ai synon të inkurajojë ndërveprimin profesional, të forcojë lidhjet mes të rinjve dhe sektorit të biznesit dhe të promovojë angazhimin e komunitetit në mbështetje të zhvillimit të rinisë. Duke krijuar këtë hapësirë ku të rinjtë mund të shprehin interesat dhe synimet e tyre për karrierën, ky panair përfaqëson një kontribut të vlefshëm për fuqizimin e tyre dhe për përmirësimin e perspektivave të punësimit në komunitet.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë krijimin e një platformë për punësimin e të rinjve;</li> <li>• Synojmë të ndihmojmë të rinjtë për orientim në karrierën e tyre;</li> <li>• Synojmë përgatitjen e të rinjve për kërkesat e tregut të punës;</li> <li>• Synojmë të promovojmë rrjetëzimin dhe ndërtimin e lidhjeve profesionale;</li> <li>• Synojmë të inkurajojmë zhvillimin personal të të rinjve;</li> <li>• Synojmë rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm;</li> <li>• Synojmë të kontribuojmë në zhvillimin ekonomik të komunitetit përmes fuqizimit të rinisë;</li> <li>• Synojmë të promovojmë një kulturë të angazhimit profesional;</li> <li>• Synojmë të nxjerrim në pah rolin e të rinjve në shoqëri dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen aktive;</li> <li>• Synojmë të lehtësojmë tranzicionin e të rinjve nga arsimi në punësim.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i stendave të kompanive dhe institucioneve pjesëmarrëse: Në panair do të vendosen stenda për kompani, organizata, dhe institucione të ndryshme, ku përfaqësuesit do të prezantojnë mundësitë e punës dhe praktikës që ofrojnë. Të rinjtë do të mund të ndërveprojnë direkt me përfaqësuesit, të bëjnë pyetje dhe të marrin informacion të detajuar për mundësitë e punësimit.</li> <li>• Seanca prezantuese nga profesionistë dhe ekspertë të tregut: Do të ketë prezantime nga drejtues të industrive të ndryshme, të cilët do të ndajnë informacionet aktuale të punësimit dhe kërkesat e tregut të punës. Këto seanca do të jenë të dobishme për të rinjtë që dëshirojnë të kuptojnë më mirë çfarë kërkohet në tregun e punës.</li> <li>• Trajnime praktike dhe seanca këshillimi: Të rinjtë do të kenë mundësinë të marrin pjesë në mini-trajnime për përgatitjen e CV-së, zhvillimin e aftësive për intervistat e punës, dhe krijimin e një profili profesional. Këto trajnime do të mbahen nga specialistë të burimeve njerëzore dhe ekspertë të fushave përkatëse.</li> <li>• Sesionet pyetje-përgjigje dhe rrjetëzim me përfaqësuesit e sektorëve: Pas prezantimeve, të rinjtë do të kenë mundësinë të bëjnë pyetje dhe të ndërveprojnë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e sektorëve, duke krijuar mundësi për rrjetëzim dhe lidhje profesionale që mund t'u ndihmojnë në rrugën e tyre të karrierës.</li> <li>• Promovimi i mundësive të praktikës profesionale dhe internship-eve: Kompanitë dhe organizatat pjesëmarrëse do të promovojnë pozitat e praktikës dhe internship-eve për të rinjtë, duke u ofruar atyre mundësinë të fitojnë përvojë të vlefshme profesionale në sektorin që i intereson.</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>Promovimi i sipërmarrësve të rinj: ku mund të ketë një stendë të dedikuar dhe të ekspozojnë produktet ose shërbimet e tij.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e mundësive të punësimit dhe praktikës për të rinjtë: Presim që shumë të rinj të krijojnë lidhje direkte me përfaqësues të kompanive dhe organizatave, duke rezultuar në punësime ose në vendosjen e praktikave profesionale.</li> <li>Përmirësimi i aftësive për kërkimin dhe aplikimin për punë: Pas pjesëmarrjes në trajnime dhe këshillime, të rinjtë do të kenë më shumë aftësi për të përgatitur një CV profesionale, për të dalë më të sigurt në intervista dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit dhe rrjetëzimit.</li> <li>Ndërtimi i një rrjeti profesional për të rinjtë: Të rinjtë do të kenë mundësinë të krijojnë kontakte me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, duke zhvilluar rrjete që mund t'i ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të karrierës.</li> <li>Rritja e vetëbesimit dhe motivimit të të rinjve për zhvillim profesional: Panairi pritet të frymëzojë të rinjtë që të angazhohen më shumë për të ndjekur qëllimet e tyre dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</li> <li>Krijimi i një kulture të re për zhvillimin profesional të vazhdueshëm: Duke i nxitur të rinjtë të investojnë në arsim dhe trajnime të vazhdueshme, panairi do të kontribuojë në krijimin e një kulture ku të mësuarit është një proces i vazhdueshëm dhe i domosdoshëm për suksesin në karrierë.</li> <li>Ndërgjegjësimi mbi tendencat dhe sfidat e tregut të punës: Pjesëmarrësit do të kenë një kuptim më të mirë të ndryshimeve dhe sfidave që përballen sektorë të ndryshëm, duke u bërë më të përgatitur për kërkesat aktuale të punës.</li> <li>Angazhimi i komunitetit lokal për mbështetjen e punësimit të të rinjve: Panairi pritet të promovojë bashkëpunimin midis bizneseve lokale dhe të rinjve, duke krijuar mundësi për angazhime të reja dhe investime në fuqinë punëtore të re.</li> <li>Ngritja e imazhit të komunitetit si një vend që mbështet rininë dhe zhvillimin profesional: Ky projekt synon të vendosë komunitetin si një qendër mbështetëse për të rinjtë që kërkojnë të avancojnë në karrierë dhe për të tërhequr më shumë të rinj të motivuar për të kontribuar në zhvillimin lokal.</li> <li>Inkurajimi i të rinjve në bashkëpunimin me sipërmarrës të rinj dhe bizneseve të mëdha për të ofruar mundësi të reja për zhvillim dhe rrjetëzim.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Përfaqësues të Bashkisë Shkodër Komuniteti OJF Të rinjtë dhe studentët Kompanitë dhe bizneset lokale Zyra e Punës Formimi Profesional Ekspertët dhe profesionistët			Bashkia Shkodër OJF Donatorë			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Zhvillim Aktiviteti					
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Zhvillim Aktiviteti					
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për aktivitetin 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>			
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>
A.1	Zhvillim Aktiviteti					
	<b>Shuma</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Sektori i Rinisë			

Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër
----------------------------------	--

Nr. 22	P.AG141.Q2.O1.A19 Personazhe në fokus	Programi AG141: Përkujdesi Social
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Projekti "Personazhe në Fokus" është një nismë e përmuajshme dedikuar të rinjve dhe ka si synim krijimin e një platforme të qëndrueshme për dialog, inspirim dhe shkëmbim përvojash me personalitete të njohura. Çdo muaj, figura publike nga fusha të ndryshme – si arti, kultura, biznesi, politika, sporti etj – do të ftohen për të ndarë rrugëtimin dhe sfidat e tyre përmes një diskutimi të hapur përpara të rinjve. Ky projekt vjen si përgjigje ndaj nevojës për modele të reja, reale dhe të prekshme, të cilat do të mund t'i japin një perspektivë të re dhe të ndihmojnë brezin e ri për t'u rritur dhe për të gjetur një rrugë të tyre drejt suksesit dhe përmbushjes personale.</p> <p>Në çdo takim, të ftuarit ndajnë jo vetëm arritjet dhe sukseset e tyre, por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë hasur gjatë rrugëtimin të tyre. Ky format i veçantë synon të frymëzojë të rinjtë të ndjekin pasionet e tyre dhe të punojnë për objektivat e tyre pavarësisht pengesave. Duke u përqendruar në histori të vërteta dhe të sinqerta, "Personazhe në Fokus" synon të krijojë një hapësirë ku të rinjtë mund të mësojnë nga përvojat e të ftuarve dhe të kuptojnë se sukseset nuk janë të thjeshta apo të lehta, por kërkojnë vendosmëri, punë të palodhur dhe këmbëngulje. Ky është një mësim i rëndësishëm që u jep të rinjve forcën për të qëndruar të motivuar dhe për të ecur përpara drejt qëllimeve të tyre.</p> <p>Përtej bisedave inspiruese, "Personazhe në Fokus" krijon një ambient ku të rinjtë kanë mundësinë të ndërveprojnë drejtpërdrejt me figurat publike, duke bërë pyetje, duke ndarë mendime dhe duke kërkuar këshilla specifike. Ky bashkëveprim i drejtpërdrejtë jo vetëm që ndihmon të rinjtë të thellojnë njohuritë e tyre mbi tema që i preokupojnë, por edhe i inkurajon ata të zhvillojnë një ndjeshmëri dhe një lidhje më të thellë me komunitetin dhe vlerat e tij. Të ftuarit do përzgjidhen nga fusha të ndryshme për të siguruar një diversitet perspektivash dhe për të përmbushur nevojat dhe interesat e larmishme të të rinjve. Nga këngëtarë, artistë dhe shkrimtarë, deri te profesionistët e biznesit dhe aktivistët socialë, projekti synon të ofrojë modele të ndryshme që të rinjtë mund t'i marrin si frymëzim për të ndjekur rrugën e tyre unike.</p> <p>Ndikimi i "Personazhe në Fokus" është afatgjatë dhe shkon përtej takimeve mujore. Ai ndihmon në lidhjen mes të rinjve, ku ata ndihen të përfshirë dhe të mbështetur në përpjekjet e tyre për rritje personale dhe profesionale. Duke ndihmuar të rinjtë të lidhen me vlerat e përgjegjësive, angazhimit qytetar dhe përpjekjeve për ndryshim, ky projekt është një hap drejt ndërtimit të një brezi të ri të vetëdijshëm, të përkushtuar dhe të gatshëm për të përballuar sfidat që shtrihen e ardhmja. Ai përfaqëson një urë të rëndësishme mes brezave, ku të rinjtë kanë mundësinë të mësojnë nga ata që kanë kaluar përvoja të ndryshme dhe të kuptojnë se përkushtimi dhe vendosmëria janë çelësi i suksesit në çdo fushë të jetës. Kështu, "Personazhe në Fokus" shndërrohet në një traditë frymëzuese dhe edukative që kontribuon në zhvillimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme dhe të fuqishme. Ky projekt planifikohet të zgjasë 9 muaj gjatë vitit, ku çdo muaj do të ftohet një personazh për të diskutuar mbi temat kryesore që prekin rininë.</p> <p style="text-align: center;"><b>LISTA E HONORAREVE:</b> Honorar, I/E ftuar 30,000</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë krijimin e një platforme dialogu dhe inspirimi për të rinjtë shqiptarë përmes takimeve me figura të njohura publike.</li> <li>• Synojmë promovimin e modeleve pozitive dhe të prekshme nga fusha të ndryshme të jetës për t'i inkurajuar të rinjtë drejt zhvillimit personal dhe profesional.</li> <li>• Synojmë të frymëzojmë të rinjtë për të ndjekur pasionet dhe objektivat e tyre, duke mësuar nga përvojat e të tjerëve.</li> <li>• Synojmë të nxisim zhvillimin personal dhe profesional të të rinjve.</li> <li>• Synojmë të nxisim angazhimin qytetar dhe përgjegjësinë sociale përmes diskutimeve mbi vlerat dhe kontributin e të ftuarve.</li> <li>• Synojmë krijimin e një ndjenjë komuniteti dhe solidariteti mes të rinjve, duke i mbështetur në rrugën drejt rritjes dhe zhvillimit.</li> <li>• Synojmë të kontribuojmë në zhvillimin e shoqërisë dhe kulturës.</li> <li>• Synojmë të inkurajojmë të rinjtë për të kërkuar njohuri dhe përvoja të reja.</li> <li>• Synojmë të ndihmojmë të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e përballimit të sfidave dhe të dështimeve si pjesë e rrugës drejt suksesit.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizimi i takimeve mujore me personalitete të njohura: Çdo muaj, një personalitet nga fusha të ndryshme do të ftohet për të ndarë përvojat dhe historitë e tij përballë të rinjve.</li> <li>▪ Diskutime interaktive dhe sesione pyetje-përgjigje: Pas prezantimit të çdo të ftuari, të rinjtë do të kenë mundësinë të bëjnë pyetje, duke zhvilluar një dialog të hapur dhe ndërveprues me personazhin në fokus.</li> <li>▪ Ndarja e mësimave dhe këshillave praktike për të rinjtë: Të ftuarit do të ndajnë këshilla praktike dhe të dobishme për zhvillimin personal dhe profesional, duke nxitur të rinjtë drejt një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme.</li> </ul>		

- Aktivitete për zhvillimin e aftësive dhe krijimin e ideve: Gjatë takimeve, mund të zhvillohen aktivitete specifike për të forcuar aftësitë e të rinjve si: trajnimet e shkurtra, ushtrimet praktike ose sesione të fokusuar në tema të caktuara.
- Fuqizimi i rrjetëzimit mes të rinjve dhe personaliteteve publike: Për të ndihmuar në ndërtimin e lidhjeve më të forta, do të ketë momente rrjetëzimi ku të rinjtë dhe të ftuarit mund të ndërveprojnë lirshëm.
- Dokumentimi dhe promovimi i çdo takimi: Çdo aktivitet do të dokumentohet dhe promovohet përmes platformave online dhe mediatike për të arritur një publik më të gjerë dhe për të frymëzuar edhe të rinjtë që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht.
- Krijimi i një platforme online për shpërndarjen e përmbajtjes: Takimet dhe përmbajtjet më të rëndësishme të ndara nga të ftuarit do të publikohen online, për të mbajtur të informuar edhe të rinjtë që ndjekin projektin në distancë.
- Evaluimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i projektit: Çdo takim do të shoqërohet nga një evaluim për të mbledhur mendimet e pjesëmarrësve dhe për të përmirësuar aktivitetet e ardhshme, duke siguruar që projekti të jetë gjithnjë i përshtatur për nevojat e të rinjve.

#### b) Rezultatet që prisni

- Rritja e inspirimit dhe motivimit të të rinjve: Duke dëgjuar historitë e suksesit dhe sfidave nga figura publike të njohura, të rinjtë do të ndihen më të frymëzuar për të ndjekur pasionet dhe qëllimet e tyre.
- Zhvillimi i aftësive personale dhe profesionale: Përmes këshillave praktike dhe aktiviteteve, të rinjtë do të përfitojnë njohuri dhe aftësi që do t'i ndihmojnë në karrierën dhe jetën e tyre personale.
- Forcimi i angazhimit qytetar dhe social të të rinjve: Diskutimet mbi përgjegjësinë dhe angazhimin do të nxisin të rinjtë të përfshihen më shumë në çështje që prekin komunitetin dhe shoqërinë e tyre.
- Krijimi i lidhjeve të forta dhe rrjetëzimi: Duke ndërvepruar me personalitete të suksesshme dhe mes njëri-tjetrit, të rinjtë do të zhvillojnë lidhje të vlefshme që mund të jenë të dobishme për rrugën e tyre profesionale dhe personale.
- Rritja e vetëdijes dhe përkushtimit ndaj zhvillimit të vazhdueshëm: Projekti synon që të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e përmirësimit të vazhdueshëm dhe të shohin çdo sfidë si një mundësi për rritje.
- Ndërtimi i një platforme të qëndrueshme dhe të njohur për frymëzimin e të rinjve: Me kalimin e kohës, projekti synon të bëhet një burim i njohur dhe i respektuar për motivimin dhe edukimin e brezit të ri, duke tërhequr më shumë të rinj dhe figura të njohura shqiptare.
- Krijimi i një kulture pozitive dhe mbështetëse për të rinjtë në komunitet: Rezultati afatgjatë është një shoqëri ku të rinjtë ndihen të mbështetur dhe të inkurajuar për të arritur potencialin e tyre të plotë, duke promovuar vlera të larta.

#### c) Aktorët e mundshëm

Përfaqësues të Bashkisë Shkodër  
Komuniteti  
OJF  
Ekspertë të Edukimit  
Ekspertë të Punësimit dhe Sipërmarrjeve Rinore  
Ekspertë nga Politika  
Ekspertë nga Kultura dhe Sporti  
Ekspertë nga Çështjet Sociale dhe Shëndetësore  
Ekspertë nga Puna Rinore dhe Vullnetarizmi

#### d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër  
OJF  
Donatorë

#### e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për aktivitetin 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare	270			270		
	<b>Shuma</b>	<b>270</b>			<b>270</b>		
Shpenzimet për aktivitetin 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare	270			270		
	<b>Shuma</b>	<b>270</b>			<b>270</b>		
Shpenzimet për aktivitetin 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare	270			270		
	<b>Shuma</b>	<b>270</b>			<b>270</b>		



<p><b>f) Periudha e zbatimit</b></p> <p>Janar – Dhjetor 2025, 2026, 202</p>	<p><b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Sektori i Rinisë  Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik  <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër</p>
---	--

Nr. 23	P.AG141.Q2.O1.A20 Zhvillimi i konkurseve për rininë	Programi AG141:Përkujdesi Social						
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>								
<b>i. Situata</b>								
<p>Zhvillimi i konkurseve ka si qëllim të krijojë një ambient stimulues dhe mbështetës për të rinjtë e komunitetit, duke promovuar dhe shfaqur talentet e tyre në fusha të ndryshme artistike dhe kulturore. Ky konkurs do të përfshijë muzikë, pikturë, debat, kërcim, fotografi dhe poezi, duke ofruar të rinjve mundësinë të shprehin kreativitetin e tyre në mënyra të ndryshme dhe të angazhohen në aktivitete që i frymëzojnë. Aktivitetet do të jenë të hapura për të rinjtë e të gjitha moshave dhe pritet të ketë një gamë të gjerë pjesëmarrësish.</p> <p>Në kuadër të këtij projekti, do të angazhohen mentorë dhe profesionistë të njohur në fushat përkatëse, të cilët do të ofrojnë mbështetje dhe këshilla të vlefshme për pjesëmarrësit. Këta ekspertë do të ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre, të përmirësojnë performancat dhe të përgatiten sa më mirë për konkurrimet.</p> <p>Eventi do të përfshijë një sistem vlerësimi të drejtë dhe transparent, me një juri përbërë nga profesionistë dhe ekspertë të fushave përkatëse, të cilët do të vlerësojnë performancat dhe do të shpallin fituesit në secilën kategori. Ky konkurs do të ofrojë gjithashtu çmime për secilën nga gjashtë kategoritë (muzikë, pikturë, debat, kërcim, fotografi dhe poezi). Çmimi i parë do të fitojë 15 mijë lekë, çmimi i dytë 10 mijë lekë, dhe çmimi i tretë 5 mijë lekë. Kjo do t'u japë mundësinë të rinjve të fitojnë njohuri për talentet e tyre dhe të angazhohen me profesionistët e fushës, duke krijuar lidhje që mund të jenë të vlefshme për karrierat e tyre të ardhshme.</p> <p>Përveç shpalljes së fituesve dhe ndarjes së çmimeve, ky konkurs do të krijojë një platformë për ndarjen e përvojave dhe frymëzimin e të rinjve të tjerë për të ndjekur pasionet e tyre. Ky event pritet të nxisë një kulturë të re të angazhimit rinor në aktivitetet artistike dhe kulturore, duke forcuar identitetin e komunitetit dhe duke promovuar artin si një mjet të rëndësishëm për shprehjen e vetes dhe zhvillimin personal. Në përfundim, ky konkurs do të kontribuojë në ndërtimin e një identiteti të fortë kulturor për të rinjtë dhe do të ofrojë mundësi për rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm në fushën artistike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Listapërçmimet e fituesve:</b></p> <table border="0" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="padding-right: 20px;">Çmimi I</td> <td>15,000</td> </tr> <tr> <td>Çmimi II</td> <td>10,000</td> </tr> <tr> <td>Çmimi III</td> <td>5,000</td> </tr> </table>			Çmimi I	15,000	Çmimi II	10,000	Çmimi III	5,000
Çmimi I	15,000							
Çmimi II	10,000							
Çmimi III	5,000							
<b>ii. Synimi i projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë të promovojmë talentet rinore.</li> <li>• Synojmë nxitjen e kreativitetit dhe inkurajimin e të rinjve për të eksploruar.</li> <li>• Synojmë të ofrojmë mbështetje.</li> <li>• Synojmë të zhvillojmë aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit.</li> <li>• Synojmë fuqizimin e identitetit kulturor.</li> <li>• Synojmë krijimin e mundësive për rritje dhe zhvillim.</li> <li>• Synojmë nxitjen e angazhimit aktiv në komunitet.</li> <li>• Synojmë të promovojmë tolerancën dhe diversitetin.</li> </ul>								
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Organizimi i konkurseve artistike:</b> Këto konkurse do të përfshijnë kategori të ndryshme si art pamor, muzikë, kërcim, poezi, fotografi dhe debat, duke ofruar mundësi për të rinjtë të shfaqin talentet e tyre.</li> <li>• <b>Sessioje këshillimi:</b> Këto sesione do të ofrojnë mbështetje dhe këshilla për të rinjtë lidhur me zhvillimin e karrierës së tyre artistike dhe mundësitë e punësimit.</li> <li>• <b>Ekspozitat e punimeve:</b> Pas konkurseve, do të organizohen ekspozita për të shfaqur punimet e pjesëmarrësve, duke ofruar një platformë për njohjen dhe promovimin e talentit.</li> <li>• <b>Performancat artistike:</b> Aktivitetet do të përfshijnë performancat të drejtpërdrejta të muzikës dhe kërcimit, duke ofruar mundësi për të rinjtë të tregojnë aftësitë e tyre para një audience.</li> <li>• <b>Debate dhe diskutime:</b> Do të organizohen sesione debate dhe diskutimesh rreth temave të ndryshme kulturore dhe shoqërore, duke inkurajuar të rinjtë të shprehin mendimet e tyre dhe të angazhohen në dialog.</li> <li>• <b>Ndarja e çmimeve:</b> Pas përfundimit të konkurseve, do të organizohet një ceremoni ndarje çmimesh për fituesit, duke i njohur ata për arritjet e tyre dhe duke i motivuar të vazhdojnë të ndjekin pasionet e tyre.</li> </ul>								
<b>b) Rezultatet që prisni</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zhvillimi i aftësive artistike: Të rinjtë do të përmirësojnë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme artistike, duke rritur kështu nivelin e tyre të përgatitjes.</li> <li>○ Rritja e vetëbesimit: Pjesëmarrësit do të fitojnë besim në aftësitë e tyre përmes performancave dhe konkurseve, duke i inkurajuar ata të ndjekin pasionet e tyre dhe të angazhohen më shumë në aktivitete artistike.</li> <li>○ Promovimi i talenteve: Pjesëmarrësit e talentuar do të kenë mundësinë të njihen nga profesionistë dhe të krijojnë lidhje që mund të çojnë në mundësi të reja për karrierë në art dhe kulturë.</li> <li>○ Forcimi i komunitetit kulturor: Aktivitetet do të kontribuojnë në ndërtimin e një identiteti kulturor të fortë për komunitetin, duke nxitur pjesëmarrjen e rinisë në aktivitete artistike dhe kulturore.</li> </ul>								



<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Krijimi i një rrjeti mbështetës: Të rinjtë do të krijojnë lidhje me individë të tjerë me interesa të ngjashme, profesionistë dhe mentorë, duke ndihmuar në zhvillimin e një rrjeti mbështetës për karrierat e tyre të ardhshme.</li> <li>○ Inkurajimi i angazhimit rinor: Pjesëmarrësit do të angazhohen më shumë në aktivitete kulturore dhe artistike, duke ndihmuar në krijimin e një kulture të re të angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në komunitet.</li> <li>○ Rritja e ndërgjegjësimit për artin dhe kulturën: Projekti do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e artit dhe kulturës për zhvillimin personal dhe social të të rinjve.</li> <li>○ Vlerësimi i performancave artistike: Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të marrin vlerësime për punën e tyre dhe të identifikojnë fushat në të cilat mund të përmirësohen, duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të tyre.</li> <li>○ Ndarja e njohjeve dhe çmimeve: Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të njohë arritjet e pjesëmarrësve, duke i motivuar ata të vazhdojnë të punojnë në zhvillimin e talentit të tyre.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Përfaqësues të Bashkisë Shkodër Komuniteti OJF Të rinjtë dhe studentët Ekspertët dhe profesionistët				Bashkia Shkodër OJF Donatorë		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promocionale	60			60	
A.2	Çmime për fitues I 6x15 mijë lekë	90			90	
A.3	Çmime për fitues II 6x10 mijë lekë	60			60	
A.4	Çmime për fitues III 6x5 mijë lekë	30			30	
A.5	Materiale didaktike	30			30	
A.6	Foni, audio.	30			30	
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promocionale	60			60	
A.2	Çmime për fitues I 6x15 mijë lekë	90			90	
A.3	Çmime për fitues II 6x10 mijë lekë	60			60	
A.4	Çmime për fitues III 6x5 mijë lekë	30			30	
A.5	Materiale didaktike	30			30	
A.6	Foni, audio.	30			30	
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>	
Shpenzimet për çdoaktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promocionale	60			60	
A.2	Çmime për fitues I 6x15 mijë lekë	90			90	
A.3	Çmime për fitues II 6x10 mijë lekë	60			60	
A.4	Çmime për fitues III 6x5 mijë lekë	30			30	
A.5	Materiale didaktike	30			30	
A.6	Foni, audio.	30			30	
	<b>Shuma</b>	<b>300</b>			<b>300</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		



Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027	Sektori i Rinisë Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër
----------------------------------	--

Nr. 24	P.AG141.Q2.O1.A21 Karta e studentit	Programi AG141:Përkujdesi Social
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Karta e Studentit është një projekt ambicioz i cili ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e jetës së studentëve, duke krijuar mundësi për të përfituar lehtësi dhe zbritje në një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh.</p> <p>Përmes Kartës së Studentit, studentët do të kenë akses të zgjeruar në shërbime publike dhe private me kostot të reduktuara, duke përfshirë transportin publik, libraritë, shërbimet shëndetësore dhe ato të mirëqenies, aktivitetet kulturore dhe artistike, si dhe shumë fushat të tjera që ndikojnë në përditshmërinë e tyre.</p> <p>Projekti i Kartës së Studentit përfshin bashkëpunime strategjike me institucione lokale, organizata dhe biznese, me synimin për të krijuar një rrjet përfitimesh që janë të aksesueshme për çdo student. Duke u ofruar zbritje për bileta për teatër, muze dhe aktivitete sportive, si dhe për libra dhe pajisje të tjera akademike, Karta e Studentit synon të ndihmojë studentët të zhvillohen në mënyrë të plotë profesionalisht ashtu edhe personalisht.</p> <p>Për më tepër, karta do të lehtësojë aksesin në qendra shëndetësore, klinika dhe shërbime të kujdesit mendor, duke krijuar një ndihmë të veçantë për ata që kanë nevojë për mbështetje në këto aspekte të rëndësishme.</p> <p>Një aspekt kyç i projektit është fuqizimi i komunitetit të studentëve dhe krijimi i një përvoje të integruar të jetës studentore, ku rinjtë jo vetëm që përfitojnë nga lehtësitë financiare, por gjithashtu inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvillimit personal dhe profesional. Kjo kartë, përveç përfitimeve ekonomike, nxit studentët të marrin pjesë në jetën kulturore dhe sociale të qytetit të tyre, duke u krijuar atyre mundësinë për të zhvilluar njohuri të reja, për të krijuar lidhje sociale dhe për të ndërtuar një perspektivë më të gjerë për të ardhmen.</p> <p>Në tërësi, Karta e Studentit synon të jetë një mjet gjithëpërfshirës, që jo vetëm ndihmon studentët financiarisht, por gjithashtu mbështet ata për të përballuar me sfidat e përditshme dhe për të bërë vitet e tyre të studimit më të pasura e të plotësuar. Ky projekt është një hap i rëndësishëm për të ndërtuar një komunitet të qëndrueshëm dhe të ndërgjegjshëm studentor, ku çdo individ ndjen mbështetje dhe mundësi për të përmbushur potencialin e tij.</p> <p>Ky projekt mbështetet në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe në ndryshimet e vendimit nr. 226, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmimet e reduktuara përmes përdorimit të Kartës së Studentit".</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë të reduktojmë shpenzimet ditore për studentët.</li> <li>• Synojmë të nxisim pjesëmarrjen në aktivitete kulturore dhe artistike.</li> <li>• Synojmë të lehtësojmë aksesin në literaturë dhe burime akademike.</li> <li>• Synojmë mbështetjen e studentëve.</li> <li>• Synojmë të përfshijmë studentët në aktivitetet e komunitetit lokal.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e Kartave të Studentëve: Aktiviteti fillestar i projektit do të përfshijë shpërndarjen e kartave për studentët në të gjitha universitetet dhe institucionet arsimore, si dhe regjistrimin e studentëve për të përfituar nga shërbimet dhe përfitimet e ofruara.</li> <li>• Krijimi i Partneriteteve dhe Marrëveshjeve me Biznese: Aktivitet që përfshin negociata dhe krijimin e marrëveshjeve me biznese dhe shërbime lokale (dyqane, kafene, palestra, banka, dyqane optike, etj.) për të ofruar zbritje dhe përfitime të tjera për studentët.</li> <li>• Organizimi i Fushatave Informuese: Aktivitet për promovimin e Kartës së Studentit përmes fushatave informuese në universitete dhe institucione arsimore, për të siguruar që studentët janë të informuar për mundësitë dhe përfitimet që ofron karta.</li> <li>• Organizimi i Eventeve dhe Panairove: Aktivitet për organizimin e panairove të punës, aktiviteteve kulturore, trajnimeve dhe workshop-eve që synojnë zhvillimin profesional dhe personal të studentëve. Këto mund të përfshijnë trajnimet në aftësi të ndryshme, mundësi punësimi dhe mundësi për praktika.</li> <li>• Sigurimi i Zbritjeve për Shërbime Shëndetësore dhe Dentare: Aktivitet që mundëson krijimin e marrëveshjeve me klinika dhe spitale për të ofruar shërbime shëndetësore dhe dentare me zbritje për studentët që përdorin kartën.</li> </ul>		

- Pjesëmarrja në Kurse dhe Trajtime Profesionale: Aktivitet që mundëson studentëve të marrin pjesë në kurse dhe trajtime profesionale për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe për t'u përgatitur për tregun e punës, duke u mundësuar atyre zhvillim profesional.
- Organizimi i Ekskursioneve dhe Udhëtimeve: Aktivitet që ofron mundësi për studentët për të udhëtuar brenda dhe jashtë vendit me çmime të ulëta, si udhëtime edukative, gjithashtu për turizëm dhe ekskursione.
- Përmirësimi i Shërbimeve të Akomodimit: Aktivitet që mundëson marrjen e mundësive për akomodim me çmime të ulëta për studentët, përmes marrëveshjeve me agjenci mobiliare dhe dhoma për studentë.
- Mbështetje për Mundësi Punësimi dhe Praktikash: Aktivitet që përfshin krijimin e mundësive për studentët për të gjetur mundësi punësimi dhe praktikash profesionale, duke bashkëpunuar me agjenci punësimi dhe kompani që ofrojnë mundësi të tilla.
- Organizimi i Aktiviteteteve Kulturore dhe Sociale: Aktivitet që inkurajon studentët të marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe sociale, si koncerte, ekspozita, teatro dhe aktivitete artistike, për të rritur përfshirjen e tyre në jetën kulturore dhe shoqërore të komunitetit.
- Përkrahje për Projekte dhe Iniciativa Studentore: Aktivitet për ofrimin e mundësive për studentët që të zhvillojnë projekte dhe iniciativa të ndryshme, si konkurrenca për mundësi financimi dhe mbështetje për ide inovative.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit: Aktivitet për vlerësimin e ndikimit të projektit, duke mbledhur feedback nga studentët dhe partnerët e përfshirë, për të bërë përmirësime dhe rregullime në aktivitetet dhe përfitimet e mundshme.
- Promovimi i Shërbimeve Edukative dhe Teknologjike: Aktivitet për mbështetje në fushën edukative dhe teknologjike, si përfitime për libra, software dhe pajisje të tjera që mund të përdoren nga studentët për studimet dhe zhvillimin e tyre profesional.

#### b) Rezultatet që prisni

- Përmirësimi i Qasjes në Shërbime dhe Produkte: Studentët do të kenë mundësi të përfitojnë nga zbritje dhe oferta speciale për shërbime dhe produkte të ndryshme, si transporti, shëndetësia, arsimit dhe aktivitetet kulturore.
- Përmirësimi i Shëndetit dhe Mirëqenies Studentore: Studentët do të kenë akses më të lehtë dhe të përballueshëm në shërbime mjekësore, dentare dhe psikologjike, duke ndihmuar në ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së tyre.
- Krijimi i Mundësive për shërbime publike dhe private: Do të krijohen mundësi për studentët të marrin shërbime nga bizneset private dhe institucionet publike për lehtësimin e studentëve.
- Rritja e Pjesëmarrjes në Aktivitetet Kulturore dhe Sociale: Aktivitetet kulturore dhe sociale do të rrisin përfshirjen e studentëve në jetën shoqërore, duke ndihmuar në zhvillimin e identitetit dhe aftësive të tyre sociale.
- Rritja e Mundësive të Udhëtimit: Studentët do të kenë mundësi të udhëtojnë me çmime të ulëta, duke pasur mundësinë të shijojnë përvoja edukative dhe kulturore që do t'i ndihmojnë në zhvillimin e tyre.
- Përmirësimi i Akomodimit për Studentët: Do të sigurohen mundësi akomodimi me çmime të ulëta për studentët, duke ndihmuar ata të gjejnë mundësi të përshtatshme dhe të përballueshme për të jetuar gjatë periudhës së studimeve.
- Përmirësimi i Shërbimeve Edukative dhe Teknologjike: Do të ofrohen mundësi për studentët të kenë akses në shërbime edukative dhe teknologjike, duke përfshirë libra, software dhe pajisje të tjera që mbështesin mësimin dhe kërkimin shkencor.
- Përmirësimi i Marrëdhënieve me Bizneset dhe Komunitetin: Krijimi i partneriteteve me biznese dhe shërbime të ndryshme do të rrisë bashkëpunimin mes studentëve dhe sektorëve të tjerë të shoqërisë, duke ofruar mundësi për zhvillimin e një rrjeti mbështetës dhe mundësish.

#### c) Aktorët e mundshëm

Bashkia Shkodër  
Universiteti  
Studentët  
Komuniteti  
Biznese  
Institucione Publike

#### d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër  
Ministria e Arsimit dhe Sportit  
Donatorë të mundshëm  
OJF

#### e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për aktivitetin 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Realizim projekti						
	<b>Shuma</b>						
Shpenzimet për aktivitetin 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Realizim projekti						
	<b>Shuma</b>						
Shpenzimet për aktivitetin 2027		Totali	Nga kjo:				



		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Realizim projekti						
	<b>Shuma</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Sektori i Rinisë Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

Nr.25	<b>P.AG141.Q3.O1.A1</b> Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të shërbimit për administrimin e drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i.Situata</b>						
<p><b>Paga dhe shtesat mbipaga.</b>          Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", i ndryshuar.</p> <p><b>Kontributi për sigurime shoqërore dëshëndetësore.</b>          Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor" dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore"</p> <p><b>Kompensim për kryefamiljarët me garkesë me emësimet e personave në garkim në familje</b>          Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit.</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe bazon punën e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Identifikimin dhe informimin e individëve dhe familjeve në nevojë për të drejtën e përfitimit të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe programeve të tjera të mbrojtjes sociale.</li> <li>➤ Programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar</li> </ul>						
<b>ii.Synimii projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore:</li> <li>• Shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve të administratës vendore.</li> <li>• Analizë e punës për secilin sektor me qëllim specifik i ndihmës ekonomike të të ngarkesës dhe punës për secilin sektor, normimine punës dhe detajimin specifik të procedurave administrative.</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve për individë/ familjeve në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar.</li> </ul>						
<b>iii.Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar.						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore në mbështetje të përbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe</li> <li>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.</li> <li>• Drejtoria e Financës.</li> <li>• Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër.</li> </ul>				Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e logaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e
A.1	Pagadhesigurime për punonjësit	<b>22,907</b>	19,764	3,143		
<b>Shuma</b>		<b>22,907</b>	19,764	3,143		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e

A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>22,907</b>	19,764	3,143			
	<b>Shuma</b>	<b>22,907</b>	19,764	3,143			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijëlek ë)</b>	Ngakjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>22,907</b>	19,764	3,143			
	<b>Shuma</b>	<b>22,907</b>	19,764	3,143			
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatitja dhe realizimi i projektit:</b> Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore <b>Institucion i kësaj lloji:</b> Bashkia e Shkodër					

<b>Nr. 26</b>	<b>P.AG141.Q3.O1.A2</b> Ndihma ekonomike me transfertë të kushtëzuar	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKB nr. 1 dt. 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike", <b>gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2024</b> në Bashkinë Shkodër janë trajtuar mendihmë ekonomike nga skema Kombëtare mesatarisht <b>1608</b> familje (në muaj) me një fond total prej <b>119 410 034</b> lekë, e ndarë kjo sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Familjet në nevojë: mesatarisht <b>1537</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>112 846 134</b> lekë.</li> <li>• Jetimët, të cilët nuk janë në institucione: mesatarisht <b>9</b> persona (në muaj) me një fond total prej <b>846 900</b> lekë.</li> <li>• Viktimat e trafikimit: mesatarisht <b>1</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>89 100</b> lekë.</li> <li>• Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh: mesatarisht <b>2</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>163 800</b> lekë.</li> <li>• Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare: mesatarisht <b>40</b> familje (në muaj) me një fond total prej <b>3 554 100</b> lekë.</li> <li>• Fëmijë në kujdestari të njëfamilje kujdestare: mesatarisht <b>19</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>1 910 000</b> lekë.</li> <li>• Fëmijë me aftësi të kufizuar në kujdestari: mesatarisht <b>0</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>0</b> lekë.</li> </ul> <p>Gjithashtu gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2024 Bashkia Shkodër ka trajtuar mesatarisht <b>199</b> familje (në muaj) nga fondi i kushtëzuar deri në 6%, të miratuar me VKB , me një fond total prej <b>7 930 023</b> lekë.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
Identifikimi i individëve dhe grupeve në nevojë të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, mbështetja me ndihmë ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar të këtyre familjeve duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e asistencës sociale (fondi sigurohet nga shteti).		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikimi i familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, për shërbime të përkujdesit shoqëror.</li> <li>▪ Përgatitja e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimi dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar.</li> <li>▪ Hedhja në regjistrin elektronik kombëtar i të dhënave të deklaruara nga aplikuesi për ndihmë ekonomike.</li> <li>▪ Verifikimi social ekonomike në familje për familjet përfituese, dhe përputhshmërinë me deklarinimin e bërë në momentin e aplikimit</li> <li>▪ Përzgjedhja e familjeve në nevojë për përfitim të ndihmës ekonomike me fonde deri në 6%</li> <li>▪ Shpallja dhe kryerja e pagesave për përfituesit e ndihmës ekonomike, çdo muaj.</li> <li>▪ Kërkesa për çeljen e fondeve të reja për Ndihmën Ekonomike.</li> <li>▪ Përgatitja e materialeve për Këshillin Bashkiak.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave dhe familjeve në vështirësi sociale dhe ekonomike.</li> <li>▪ Ndërgjegjësimi i familjeve për punësim dhe bashkëpunim me institucionin e zyrës rajonale të punësimi dhe qendrën e formimit profesional, si një mundësi më e mirë për përmirësimin e kushteve ekonomike të personave dhe familjeve.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<p>Familjet në nevojë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jetimët, të cilët nuk janë në institucione.</li> <li>- Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.</li> <li>- Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimi të tyre.</li> <li>- Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes</li> </ul>	<p>Bashkia Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Dr. Rajonale Shërbimit Social</p>	



ose të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. - Fëmijë të vendosur në familje kujdestare. - Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare.						
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ndihmë ekonomike	<b>185,000</b>				<b>185,000</b>
	<b>Shuma</b>	<b>185,000</b>				<b>185,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ndihmë ekonomike	<b>185,000</b>				<b>185,000</b>
	<b>Shuma</b>	<b>185,000</b>				<b>185,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ndihmë ekonomike	<b>190,000</b>				<b>190,000</b>
	<b>Shuma</b>	<b>190,000</b>				<b>190,000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar - Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së ndihmës ekonomike <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<p><b>Nr. 27</b></p>	<p><b>P.AG141.Q3.O1.A3</b> Pagesë PAK dhe Invaliditeti me transfertë të kushtëzuar</p>	<p><b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b></p>
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b></p>		
<p><b>i. Situata</b></p>		
<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit", Ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", Ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit", Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimine aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre", VKMnr. 182 date 26.02.2020 "Për përcaktimin e masës, tëkriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal", Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.31 datë 20.01.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar, Vendimit nr. 277 datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", VKM nr.869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar. Kategoritë e paaftësisë ndahen në tre nëngrupe kryesore si: paaftësi, verbëri dhe para/tetraplegjikë. Secila kategori në bazë të shkallës së rëndësë së sëmundjes përfiton kujdestari paaftësie. Sipas urdhërit nr. 310 dt. 25.09.2024 masa e përfitimit për shkak të aftësisë së kufizuar bëhet: Niveli I bëhet 8739 lekë nga 7729 lekë, Niveli II 11652 lekë nga 10 305 lekë, Niveli III bëhet 14565 lekë nga 12882 lekë, Niveli IV bëhet 17478 lekë nga 15458 lekë. Ndihmësi personal për shërbimet e herëpashershme bëhet 11652 lekë nga 10305 lekë. Ndihmësi personal për shërbimet gjithëpërfshirëse bëhet 17478 lekë nga 15458 lekë. Sipas urdhërit nr. 311 dt. 25.09.2024 masa e përfitimit për shkak të aftësisë së kufizuar bëhet 12676 lekë nga 12415 lekë. Të njëjten masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar. Sipas urdhërit nr. 313 dt. 25.09.2024 masa e përfitimit për shkak të verbërisë bëhet 14388 lekë nga 14092 lekë. Të njëjten masë pagesë përfiton edhe kujdestari i të verbërit. Sipas urdhërit 312 dt. 25.09.2024 masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë bëhet 12676 lekë nga 12415 lekë. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik bëhet 13315 lekë nga 13 041 lekë. Masa e shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, janë: a) 3300 (tremijë e treqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme; b) 2200 (dymijë e dyqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga sëmundje të përgjithshme; c) 4000 (katër mijë) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale; ç) 2700 (dymijë e shtatëqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.</p> <p>Kështu, <b>gjatë 9 muorit të parë për vitin 2024</b> Bashkia Shkodër ka trajtuar mesatarisht <b>6727</b> persona (në muaj) me pagesë paaftësie dhe shtesë kempit për invalidë pune, me një fond total prej <b>547,480,674</b> lekë, sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Persona me aftësi të kufizuar: mesatarisht <b>2314</b>(në muaj) me një fond total prej <b>234 351 893</b> lekë. Kujdestarë: mesatarisht <b>400</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>42 301 597</b> lekë</li> <li>• Persona të verbër: mesatarisht <b>431</b> (në muaj) me një fond total prej <b>65 642 553</b> lekë. Kujdestarë: mesatarisht <b>131</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>17 854 087</b> lekë</li> <li>• Paraplegjik/tetraplegjik : mesatarisht <b>249</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>70 415 506</b> lekë. Kujdestarë: mesatarisht <b>249</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>30 275 838</b> lekë</li> <li>• Invalidë pune: mesatarisht <b>2953</b> familje (në muaj)me një fond total prej <b>86,639,200</b> lekë</li> </ul>		
<p><b>ii. Synimi i projektit</b></p>		
<p>Identifikimi i individëve dhe grupeve në nevojë të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike, zhvillimin e aftësisë e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësisë dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, mbështetja me ndihmë ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar të këtyre familjeve duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e asistencës sociale (fondi sigurohet nga shteti).</p>		
<p><b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b></p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar.</li> <li>▪ Informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njësisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi.</li> <li>▪ Hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësim</li> <li>▪ Kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se një herë në tre muaj</li> <li>▪ Hartimi i kërkesës për fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e vetëqeverisjes vendore.</li> <li>▪ Ndjekja e afateve të mbarimit të raportave, plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e përcaktuar nga ligji për aftësinë e kufizuar dhe invalidët e punës që trajtohen me shtesë kempit.</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e listave të plota dhe masa e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar për ekzekutime të tyre.</li> <li>▪ Kryerja e pagesave për përfituesit e aftësisë së kufizuar, çdo muaj.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave dhe familjeve që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuar</li> <li>▪ Të sigurojmë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.</li> <li>▪ Të sigurojmë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
<p>- Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin.</p> <p>- Personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë.</p> <p>- Personat, para/ tetraplegjikë që vuajnë nga paraliza e dy anësive të poshtme,</p> <p>- Personat kujdestar të kategorive të ndryshme të paaftësisë.</p> <p>-Invalid pune.</p>			<p>Bashkia Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Dr. Rajonale Shërbimit Social</p>				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Pagesë P.A.K dhe Invaliditeti	810,000				810,000	
	<b>Shuma</b>	<b>810,000</b>				<b>810,000</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Pagesë P.A.K dhe Invaliditeti	810,000				810,000	
	<b>Shuma</b>	<b>810,000</b>				<b>810,000</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 (me transferte te kushtezuar)</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Pagesë P.A.K dhe Invaliditeti	810,000				810,000	
	<b>Shuma</b>	<b>810,000</b>				<b>810,000</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>				
Janar - Dhjetor 2025, 2026, 2027			<p>Stafi i drejtorisë së ndihmës ekonomike <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër</p>				

Nr. 28	<b>P.AG141.Q4.O1.A1.</b> Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare "Për Familjen"	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare "Për familjen", të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare.</p> <p>Në kuadër të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe gjithashtu në kuadër të nevojave të territorit, përveç qendrave komunitare, Bashkia e Shkodrës, është angazhuar edhe në ngritjen e qendrave multifunksionale të specializuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Qendra komunitare multifunksionale "Për Familjen"</b> – është një qendër e ndërtuar, në tetor 2018, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE "Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale" në bashkëpunim me UNDP, financuar nga BE, që ofron shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>• <b>Qendra "Harmonia" për ofrimin e shërbimit të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm-</b> e ngritur në vitin 2021, e cila ofron shërbime për fëmijët e diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.</li> <li>• Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, gjatë vitit 2021 ka vazhduar ndërhyrja në Qendrën Komunitare "Për Familjen" Nr.6, e cila ofron shërbime multifunksionale. Krahas shërbimit shëndetësor tashmë ekzistent që nga viti 2017 (qendra shëndetësore për lagjen Tom Kola dhe Perlat Rexhepi), janë vënë në funksion banesat sociale me qera. Njëkohësisht vazhdon funksionimin sipas të gjitha standardeve e kopshtit dhe çerdhja "Njomëzat", i cili ofron shërbim për familjet në lagjet nr. 5 dhe 3 të qytetit.</li> <li>• <b>Qendra Multifunksionale "Xixëllonjat"</b> është qendra më të re që i shtohet rrjetit të Qendrave Komunitare "Për Familjen" të shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Brenda ambjenteve të qendrës ka një qendër shëndetësore, qendër komunitare, çerdhe dhe kopsht, qendër të moshuarish, hapësire e re e sigurtë rinore.</li> <li>• <b>Qendra Rinore "Atelie"</b> – e cila i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj.</li> <li>• <b>Strehëz për fëmijet pa kujdes prindëror</b> - Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror është një strukturë e vogël që ka si qëllim përfshirjen sociale deri tetë të miturve, të cilëve u ofrohet një mbështetje emocionale e orientuar për të garantuar mbrojtje dhe mbështetjeje në funksionet evolutive që janë cënuar prej dinamikave familjare.</li> <li>• <b>Strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore.</b> Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore, në zbatim të ligjit nr.9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018. Gjatë vitit 2024 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatat partnere Gruaja tek gruaja dhe Nisma/ Arsis ka rritur kapacitetet e ofrimit të shërbimit të emergjencës, duke rritur numrin e shtretërve dhe numrin e ditëve të qëndrimit në strehëz. Po në këtë kuadër është trajnuar dhe punësuar një staf i posaçëm oncall për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve emergjente, i cili funksionon 24/24, 7 në 7.</li> </ul> <p>Çdo Qendër Komunitare "Për Familjen" (13 qendra) kanë në përbërje personel specialistësh të fushës sociale që shërbejnë, të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsolidimi i qendrave komunitare dhe qendrave multifunksionale që janë ndërtuar dhe janë në funksion në Bashkinë e Shkodrës në ofrimin e shërbimeve në komunitet.</li> <li>• Mbulimin me shërbime komunitare në një territor sa më të gjërë të Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Vlerësim të situatës sociale e ekonomike, statistika të sakta për nevojat dhe mbi përfituesit, si dhe planifikimin e aktiviteteve në përputhje me nevojat reale.</li> <li>• Synojmë fuqizimin e shërbimeve në qendra komunitare dhe ngritjen e funksionimit e qendrave të reja në njësitë administrative të pambuluara, duke ofruar edhe shërbim lëvizës në njësitë administrative Pult dhe Shosh.</li> <li>• Synojmë ofrimin e shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ofrimi i shërbimeve parashoqërore, që përfshijnë: (informim, këshillim, shërbime në familje, mbështetje psikologjike, psiko-sociale. Tj).</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shërbime Komunitare të plota dhe gjysmëditore, që përfshijnë: (shërbimet ndërmjetëse lidhur me punësimin, asistencë sociale dhe aspektet ligjore).</li> <li>▪ Shërbime të mirëmbajtjes dhe pajisjes së ambjenteve në të cilat do të krijohen dhe do të funksionojnë qendrat komunitare.</li> <li>▪ Shërbime multifunkionale të specializuara për kategoritë vulnerabël.</li> <li>▪ Takime informuese dhe promovuese për shëndetin, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, qendra shëndetësore dhe OJF aktive në territor.</li> <li>▪ Hedhja dhe raportimi i rasteve përfituese të shërbimeve në sistemin online dhe regjistrin elektronik të shërbimeve të kujdesit shoqëror.</li> <li>▪ Fuqizimi i shërbimit emergjent.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shërbime sociale komunitare “Për Familjen” në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>○ Qendrat komunitare “Për Familjen” dhe multifunkionale të konsoliduara që ofrojnë shërbime sociale.</li> <li>○ Qendrat komunitare të gatshme nga ana infrastrukturore dhe funksionale duke ofruar shërbime sociale.</li> <li>○ Fuqizimin e shërbimeve komunitare për lagjen 1 dhe 2 duket rritur e zhvilluar kapacitetet aktuale.</li> <li>○ Shërbimi lëvizës funksional dhe në mbulim të njësisve administrative malore.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Bashkia Shkodër			Bashkia Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Tot ali (mi jë lek ë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transfe rime
A.1	Energji elektrike	<b>2,004</b>			2,004	
A.2	Ujë	<b>500</b>			500	
A.3	Mirëmbajt je e zakonshme	<b>1000</b>			1000	
A.4	Blerje materiale elektrike,	<b>100</b>			100	
A.5	Blerje materiale hidraulike,	<b>60</b>			60	
A.6	Blerje materiale pastrimi	<b>350</b>			350	
A.7	Sigurimi i pronave	<b>465</b>			465	
A.8	Servis teknik ashensori	<b>200</b>			200	
	<b>Shuma</b>	<b>4,679</b>			<b>4,679</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Tot ali (mi jë lek ë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operati ve	Transfe rime
A.1	Energji elektrike	<b>2,004</b>			2,004	
A.2	Ujë	<b>500</b>			500	
A.3	Mirëmbajt je e zakonshme	<b>1000</b>			1000	

A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike,	60			60		
A.6	Blerje materiale pastrimi	350			350		
A.7	Sigurimi i pronave	465			465		
A.8	Servis teknik ashensori	200			200		
	<b>Shuma</b>	<b>4,679</b>			<b>4,679</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Tot ali (milijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Energji elektrike	2,004			2,004		
A.2	Ujë	500			500		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	1000			1000		
A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike,	60			60		
A.6	Blerje materiale pastrimi	350			350		
A.7	Sigurimi i pronave	465			465		
A.8	Servis teknik ashensori	200			200		
	<b>Shuma</b>	<b>4,679</b>			<b>4,679</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike <b>Institucioni likujdues:</b> Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

<b>Nr. 29</b>	<b>P.AG141.Q4.O1.A2.</b> Blerje Kancelari për Qendrat Komunitare “Për Familjen”	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>						
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>								
<b>i. Situata</b>								
<p>Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare.</p> <p>Në kuadër të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe gjithashtu në kuadër të nevojave të territorit, përveç qendrave komunitare, Bashkia e Shkodrës, është angazhuar edhe në ngritjen e qendrave multifunkionale të specializuara si më poshtë:</p>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Qendra komunitare multifunkionale “Për Familjen”</b> – është një qendër e ndërtuar, në tetor 2018, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” në bashkëpunim me UNDP, financuar nga BE, që ofron shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>• <b>Qendra “Harmonia” për ofrimin e shërbimit të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm-</b> e ngritur në vitin 2021, e cila ofron shërbime për fëmijët e diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.</li> <li>• Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, gjatë vitit 2021 ka vazhduar ndërhyrja në Qendrën Komunitare “Për Familjen” Nr.6, e cila ofron shërbime multifunkionale. Krahas shërbimit shëndetësor tashmë ekzistent që nga viti 2017 (qendra shëndetësore për lagjen Tom Kola dhe Perlat Rexhepi), janë vënë në funksion banesat sociale me qera. Njëkohësisht vazhdon funksionimin sipas të gjitha standardeve e kopshtit dhe çerdhja “Njomëzat”, i cili ofron shërbim për familjet në lagjet nr. 5 dhe 3 të qytetit.</li> <li>• <b>Qendra Multifunkionale “Xixëllonjat”</b> është qendra më të re që i shtohet rrjetit të Qendrave Komunitare “Për Familjen” të shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Brenda ambjenteve të qendrës ka një qendër shëndetësore, qendër komunitare, çerdhe dhe kopsht, qendër të moshuarish, hapësire e re e sigurtë rinore.</li> <li>• <b>Qendra Rinore Atelie</b> – e cila i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale, kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni.</li> </ul> <p>Çdo Qendër Komunitare “Për Familjen” (13 qendra) kanë në përbërje personel specialistësh të fushës sociale që shërbejnë, të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave.</p> <p>Për mbarëvajtjen e punës është e nevojshme blerja e kancelarive. Në funksion të informimit për shërbimet e ofruara nga qendr rinore atelie është e nevojshme sigurimi i hostit dhe domain për faqen <b>shkodrarinore.gov.al</b></p>								
<b>ii. Synimi i projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi me bazë materiale kancelarike të qendrave komunitare dhe qendrave multifunkionale që janë ndërtuar dhe janë në funksion në Bashkinë e Shkodrës në ofrimin e shërbimeve në komunitet.</li> </ul>								
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Evidentimi i nevojave për bazë materiale në secilën qendër.</li> <li>▪ Ndjekja e procedurës së prokurimit.</li> <li>▪ Marrja në dorëzim dhe shpërndarja e bazës materiale sipas nevojave.</li> </ul>								
<b>b) Rezultatet që prisni</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Qendrat komunitare “Për Familjen” dhe multifunkionale të pajisura me bazë materiale kancelarike.</li> </ul>								
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Bashkia Shkodër				Bashkia Shkodër				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>								
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>			<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapital e
A.1	Blerje kancelari	<b>300</b>			300			
A.2	Domain dhe host	<b>12</b>			12			

Shuma		312			312		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime	Kapital e
A.1	Blerje kancelari	<b>300</b>			300		
A.2	Domain dhe host	<b>12</b>			12		
<b>Shuma</b>		<b>312</b>			<b>312</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferime	Kapital e
A.1	Blerje kancelari	<b>300</b>			300		
A.2	Domain dhe host	<b>12</b>			12		
<b>Shuma</b>		<b>312</b>			<b>312</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Administrata e Bashkisë Shkodër Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				



<b>Nr. 30</b>	<b>P.AG141.Q4.O1.A3.</b> Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Multifunkionale	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</p> <p>Në kuadër të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe gjithashtu në kuadër të nevojave të territorit, përveç qendrave komunitare, Bashkia e Shkodrës, është angazhuar edhe në ngritjen e qendrave multifunkionale të specializuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Qendra komunitare multifunkionale “Për Familjen”</b> – është një qendër e është ndërtuar, në tetor 2018, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” në bashkëpunim me UNDP, financuar nga BE.</li> <li>• <b>Qendra “Harmonia” për ofrimin e shërbimit të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm-</b> e ngritur në vitin 2021, e cila ofron shërbime për fëmijët e diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.</li> <li>• <b>Qendra Multifunkionale “Xixëllonjat”</b> është qendra më të re që i shtohet rrjetit të Qendrave Komunitare “Për Familjen” të shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Brenda ambjenteve të qendrës ka një qendër shëndetësore, qendër komunitare, çerdhe dhe kopsht, qendër të moshuarish, hapësire e re e sigurtë rinore.</li> </ul> <p>Çdo Qendër Komunitare Multifunkionale ka në përbërje personel specialistësh të fushës sociale që shërbejnë, të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave.</p> <p><b>Paga dhe shtesat mbipaga.</b> Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar.</p> <p><b>Kontributi për sigurime shoqërore dheshëndetësore.</b> Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor” dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore”</p> <p><b>Kompensimpër kryefamiljarëtmengarkesëmëmëshumësetrepersonanëngarkim në familje</b> Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërbllim sipas rasti.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsolidimi i qendrave komunitare multifunkionale që janë ndërtuar dhe janë në funksion në Bashkinë e Shkodrës në ofrimin e shërbimeve në komunitet.</li> <li>• Mbulimin me shërbime komunitare në një territor sa më të gjërë të Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Vlerësim të situatës sociale e ekonomike, statistika të sakta për nevojat dhe mbi përfituesit, si dhe planifikimin e aktiviteteve në përputhje me nevojat reale.</li> <li>• Synojmë fuqizimin e shërbimeve në qendra komunitare multifunkionale.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ofrimi i shërbimeve parashoqërore, që përfshijnë: (informim, këshillim, shërbime në familje, mbështetje psikologjike, psiko-sociale. tj).</li> <li>▪ Shërbime komunitare të plota dhe gjysmëditore, që përfshijnë: (shërbimet ndërmjetëse lidhur me punësimin, asistencë sociale dhe aspektet ligjore).</li> <li>▪ Shërbime multifunkionale të specializuara për kategoritë vulnerabël.</li> <li>▪ Takime informuese dhe promovuese për shëndetin, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, qendra shëndetësore dhe OJF aktive në territor.</li> <li>▪ Hedhja dhe raportimi i rasteve përfituese të shërbimeve në sistemin online dhe regjistrin elektronik të shërbimeve të kujdesit shoqëror.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shërbime sociale komunitare multifunkionale “Për Familjen” në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</li> <li>○ Qendrat komunitare multifunkionale të konsoliduara që ofrojnë shërbime sociale.</li> <li>○ Qendrat komunitare të gatshme nga ana infrastrukturore dhe funksionale duke ofruar shërbime sociale.</li> <li>○ Fuqizimin e shërbimeve komunitare për lagjen 1 dhe 2 duket rritur e zhvilluar kapacitetet aktuale.</li> <li>○ Shërbimi lëvizës funksional dhe në mbulim të njësive administrative malore.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komunitetit, (OJF-organizatat jofitimprurëse), Institucionet rajonale të shërbimit social, shëndetesisë, arsimit, etj.				OJF, ZVA NJKSH SHSR DVP Biznes privat,			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>6,661</b>	5,747	914			
A.2	Materiale didaktike për fëmijë	<b>100</b>			100		
	<b>Shuma</b>	<b>6,761</b>	<b>5,747</b>	<b>914</b>	<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>6,661</b>	5,747	914			
A.2	Materiale didaktike për fëmijë	<b>100</b>			100		
	<b>Shuma</b>	<b>6,761</b>	<b>5,747</b>	<b>914</b>	<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>6,661</b>	5,747	914			
A.2	Materiale didaktike për fëmijë	<b>100</b>			100		
	<b>Shuma</b>	<b>6,761</b>	<b>5,747</b>	<b>914</b>	<b>100</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b>				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027				Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër			

<b>Nr. 31</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A1.</b> Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizatat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë. Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe "klima" humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet sociale më në rrezik.</p> <p>Në fillim të viteve 90 organizata të ndryshme filluan ngritjen e shërbimeve të para sociale për grupet me në vështirësi, si motrat e Nanë Terezës për personat me Aftësi të Kufizuar (AK), Red Barnet në mbështetje të familjeve, Opera Madonnina del Grappa në mbështetje të jetimeve dhe të personave me aftësi të kufizuar.</p> <p>Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e licënsuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj rristrukturimi i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjelle përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të krijimit të Shtëpisë Familje.</p> <p>Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 18 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integrues, duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e Linjës. "Opera Madonnina del Grappa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e shtëpive – familje të "Opera Madonnina del Grappa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.</p> <p>Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata "Opera Madonnina del Grappa", i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën për fonde për mbështetje të "Opera Madonnina del Grappa", për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës si: kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjës social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër do të mbështesë "Opera Madonnina del Grappa" duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë "Opera Madonnina del Grappa", si edhe shpenzime operative etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe "Opera Madonnina del Grappa".</p> <p>"Opera Madonnina del Grappa", dërgon kërkesën për të bërë shpërndarjen e fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i modelit Shtëpi Familje për personat me PAK, pa mbështetje familjare, në vendin tonë.</li> <li>• Ofrimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative për PAK, si deinstitutionalizimit dhe parandalimin e institutionalizimit për PAK në rrezik dhe rritjen e kapaciteteve të shërbimeve Ditore sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar.</li> <li>• Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë "Opera Madonnina del Grappa", për PAK e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kërkesa nga "Opera Madonnina del Grappa", për mbështetje me fond për vitin 2025.</li> <li>▪ Realizimi i fondit të parashikuar për "Opera Madonnina del Grappa", në buxhetin e shtetit për vitin 2025.</li> <li>▪ Nënshkrimi i marrëveshjes midis Bashkisë Shkodër dhe "Opera Madonnina del Grappa", për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij për vitin 2025.</li> <li>▪ Përgatitja e dokumentacionit nga "Opera Madonnina del Grappa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë Bashkisë Shkodër, çdo fillim muaji.</li> <li>▪ Kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të "Opera Madonnina del Grappa", është e llogaritur sipas Udhëzimit nr. 689 datë 02.10.2018 "Për nivelin e Kuotave të shpezymeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror".</li> <li>▪ Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës.</li> <li>▪ Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në "Opera Madonnina del Grappa".</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i shërbimit të ofruar për PAK që jetojnë në shtëpinë-familje të "Opera Madonnina del Grappa".</li> </ul>		



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parandalimi i institucionalizimit të personave me AK.</li> <li>• Mbështetje afatgjatë e sigurtë për përfituesit që jetojnë në shtëpi – familjet e “Opera Madonnina del Grappa”.</li> <li>• Përmirësim i situatës së PAK të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
PAK që jetojnë në shtëpi-familjet e “Opera Madonnina del Grappa”, Komuniteti Institucionet publike Organizatat			MSHMS Bashkia “Opera Madonnina del Grappa”,				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”,	<b>19,532</b>				19,532	
	<b>Shuma</b>	<b>19,532</b>				<b>19,532</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”,	<b>19,956</b>				19,956	
	<b>Shuma</b>	<b>19,956</b>				<b>19,956</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferime për projektin Opera Madonnina del Grappa”,	<b>20,388</b>				20,388	
	<b>Shuma</b>	<b>20,388</b>				<b>20,388</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>				
Janar– Dhjetor 2025, 2026, 2027			Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik “Opera Madonnina del Grappa” <b>Institucioni Likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 32</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A2.</b> Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuara.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Projekti Shpresa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 64 persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.</p> <p>Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër ka mbështetur Projektin "Shpresa me shpenzime operative sipas marrëveshjes së bashkëpunimit që lidhet mes Bashkisë Shkodër dhe Projektit Shpresa.</p> <p>Projekti Shpresa sjell kërkesën për shpërndarjen e fondeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Synojmë ofrimin e shërbimeve alternative për PAK, si shërbimin e deinstitutionalizimit dhe parandalimin e institutionalizimit për PAK në rrezik, në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa" sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara.</li> <li>Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë projektit "Shpresa" për PAK e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkesa nga projekti "Shpresa" për mbështetje me fond për vitin 2025.</li> <li>Realizimi i fondit të parashikuar për projektin "Shpresa", në buxhetin e shtetit për vitin.</li> <li>Nënshkrimi i marrëveshjes midis bashkisë Shkodër dhe projektit "Shpresa" për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij për vitin.</li> <li>Përgatitja e dokumentacionit nga projekti "Shpresa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë Bashkisë Shkodër, çdo fillim muaji.</li> <li>Paga për kujdestarët, për administratorin, psikologun klinik dhe infermierin.</li> <li>Shpenzimet operative të parashikuara për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të projektit "Shpresa.</li> <li>Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës.</li> <li>Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në projektin "Shpresa".</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësim i shërbimit të ofruar për PAK që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa".</li> <li>Parandalimi i institutionalizimit të personave me AK.</li> <li>Mbështetje afatgjatë e sigurtë për klientët që jetojnë në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa".</li> <li>Bashkëpunim i ngushtë me organizatën projekti "Shpresa".</li> <li>Përmirësim i situatës së PAK të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja, duke i sistemuar në projektin "Shpresa".</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa" Komuniteti Institucionet publike Organizatata				MSHMS Bashkia Projekti "Shpresa"		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
A.1	Transferim për projektin Shpresa	<b>24,971</b>	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	<b>Shuma</b>	<b>24,971</b>				<b>24,971</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
A.1	Transferim për projektin Shpresa	<b>24,971</b>	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	<b>Shuma</b>	<b>24,971</b>				<b>24,971</b>
		<b>Totali</b>	Nga kjo:			



Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferim për projektin Shpresa	<b>24,971</b>				24,971	
	<b>Shuma</b>	<b>24,971</b>				<b>24,971</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar– Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Projekti “Shpresa” <b>Institucioni Likujdues: Bashkia Shkodër</b>				

<b>Nr. 33</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A3.</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, më 3 Dhjetor.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Në kuadër të “3 Dhjetorit” ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike, organizatat, donatorët, si dhe nga vetë përfituesit, me qëllim integrimin e personave me AK në jetën sociale, ekonomike e kulturore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</p> <p>Bashkia Shkodër përveç ofrimit të shërbimeve komunitare, konsideron të rëndësishme krijimin e përshtatshmërisë dhe lehtësirave në komunikim, gjithëpërfshirjen dhe aksesin në shërbime për të gjithë personat me aftësi të kufizuara duke synuar shërbime dhe ambiente publike të mundshme për të gjithë.</p> <p>Me dëshirën për të rritur integrimin e PAK në jetën dhe aktivitetet publike, institucionet publike, shkollat, biblioteka, qendrat sociale, trotualet, etj. të gjitha projektet e reja infrastrukturore (qendra komunitare, qendra multifunkionale, etj.) dhe rikonstruktionet e godinave ekzistuese të Bashkisë së Shkodrës (biblioteka “Marin Barleti”, shkollat, etj) janë krijuar me përshtatshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Çdo ndërtim i ri dhe çdo rikonstrukcion infrastrukturor i realizuar nga Bashkia e Shkodrës ka përshtatshmërinë për akses për PAK ( rampa, ashensor, tualete, etj.). Qendra Rinore Atelie, Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen”, Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina dhe ambientet e shoqatës së Para&amp;Tetraplegjikëve kanë tualete për PAK. Janë realizuar një sërë ndërhyrjesh në trotualet e rrugëve të qytetit me qëllim krijimin e rampave dhe rritjen e aksesit të PAK. Çdo ndërhyrje është realizuar konform standarteve ligjore, përshtatshmërisë dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë.</p>		
<b>A.1 Aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të kufizuara, më 3 Dhjetor.</b>		
<p>Me rastin e ditës ndërkombëtare të aftësisë ndryshe “3 dhjetor”, Bashkia Shkodër, stafet që punojnë në qendrat komunitare do të organizojë aktivitetet ndërgjegjësuese, sensibilizuese për PAK-të, për t'i dhënë mundësinë këtij target grupi të shfaqin aftësitë dhe nevojat e tyre, në mënyrë që komuniteti t'i vlerësojë dhe t'i konsiderojë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë. Keto aktivitete do të organizohen në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke përfshirë edhe organizata e shoqërisë civile. Në fund të aktiviteteve do të ketë prirje catering për pjesëmarrësit, me qëllim krijimin e një hapësirë miqësore diskutimi, gjithëpërfshirje dhe socializimi ndërmjet tyre.</p>		
<b>A.2. Maratonë paraolimpike me rastin e “3 dhjetorit” Ditës Ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar.</b>		
<p>Ky aktivitet organizohet si një mundësi për aktivizimin, promovimin e të drejtave dhe gjithëpërfshirjes së të gjithë bashkëqytetarëve, fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Aktiviteti do të synohet të organizohet në stadium apo në hapësira të përshtatshme, duke angazhuar organizatat e personave me aftësi të kufizuara, shkollën “3 dhjetori” dhe Qendrën e zhvillimit në Shkodër, organizata të tjera të cilat punojnë në këtë fushë në Shkodër. Ky aktivitet do të organizohet nga Bashkia e Shkodrës. Punonjësit socialë dhe të tjerë të sektorit do të organizojnë eventin, duke siguruar gjithëpërfshirjen dhe angazhimin e të gjithë partnerëve të mundshëm, materialet promovionale dhe të tjera materiale të domosdoshme për organizimin e maratonës. Do</p>		
<p>Për pjesëmarrësit do të shpërndahen certifikata dhe çmime sipas kategorive, vendi i parë, i dytë, i tretë për katër kategori. Në fund të aktivitetit do të ketë prirje catering për pjesëmarrësit, me qëllim krijimin e një hapësirë miqësore diskutimi, gjithëpërfshirjeje dhe socializimi ndërmjet tyre.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale, ekonomike e kulturore.</li> <li>• Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aktivitete sensibilizuese.</li> <li>▪ Panair me punime nga vetë PAK.</li> <li>▪ Performacë e Bandës muzikore të PAK.</li> <li>▪ Organizim i aktivitetit social – kulturore nga fëmijët e qendrës kulturore/nxënësit e shkollave.</li> <li>▪ Hapje e Qendres së Zhvillimit dhe Shtëpi-Familje (Projekti Shpresa, Madonnina del Grappa) me aktiviteteve dhe pjesëmarrje të OJF-ve dhe komunitetit.</li> <li>▪ Maratonë paraolimpike.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve dhe organizatave.</li> <li>○ Zhvillimi i aktiviteteve sociale – kulturore me pjesëmarrjen e PAK dhe nxënësve të shkollave.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Personat me aftësi të kufizuara Komuniteti; Institucionet publike; OJF-të	Bashkia Institucionet publike; Shkolla “3 Dhjetori”, Qendra e Zhvillimit, Qendra Kulturore e Fëmijëve, OJF-të; Bizneset private; Komuniteti, Organizatat	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025	Totali	Nga kjo:

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktivite ndërgjegjesuese: Katering	150			150		
A.2.	Maratone me rastin e ditës ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar "3 Dhjetori"						
A.2.1	Materiale publicitare (banner, numra, flamuj, çertifikata, ejt)	50			50		
A.2.2	Çmim i parë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x20 mijë lekë	80			80		
A.2.3	Çmim i dytë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x15 mijë lekë	60			60		
A.2.4	Çmim i tretë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x10 mijë lekë	40			40		
A.2.5	Honorare për gjyqtarët	10			10		
	<b>Shuma</b>	<b>390</b>			<b>390</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktivite ndërgjegjesuese: Katering	150			150		
A.2.	Maratone me rastin e ditës ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar "3 Dhjetori"						
A.2.1	Materiale publicitare (banner, numra, flamuj, çertifikata, ejt)	50			50		
A.2.2	Çmim i parë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x20 mijë lekë	80			80		
A.2.3	Çmim i dytë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x15 mijë lekë	60			60		
A.2.4	Çmim i tretë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x10 mijë lekë	40			40		
A.2.5	Honorare për gjyqtarët	10			10		
	<b>Shuma</b>	<b>390</b>			<b>390</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktivite ndërgjegjesuese: Katering	150			150		
A.2.	Maratone me rastin e ditës ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar "3 Dhjetori"						
A.2.1	Materiale publicitare (banner, numra, flamuj, çertifikata, ejt)	50			50		



A.2.2	Çmim i parë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x20 mijë lekë	<b>80</b>			80		
A.2.3	Çmim i dytë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x15 mijë lekë	<b>60</b>			60		
A.2.4	Çmim i tretë për kategorinë djem, vajza, karrige me rrota, fëmijë 4x10 mijë lekë	<b>40</b>			40		
A.2.5	Honorare për gjyqtarët	<b>10</b>			10		
	<b>Shuma</b>	<b>390</b>			<b>390</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Qendrës së Zhvillimit; Organizatat; ZVA Shkodër. <b>Institucioni Likujdues:</b> Bashkia Shkodër			

<b>Nr. 34</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A4.</b> Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuara	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
<b>i. Situata</b>					
<p>Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit.</p> <p>“Trupa muzikore e PAK” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”.</p> <p>Për të institucionalizuar bashkëpunimin, Bashkia e Shkodrës dhe “The Door” synojnë arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me synim qëndrueshmërinë, vazhdimësinë, mbështetjen dhe nxitjen e aktivizimit të kësaj trupe si një model pozitiv i integritimit në jetën sociale dhe kulturore të fëmijëve me aftësi të kufizuara.</p> <p>Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë.</p> <p>Disa prej aktiviteteve të parashikuara për pjesëmarrje, por jo vetëm, gjatë vitit për Trupën muzikore PAK janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Festa e karnavaleve,</li> <li>• Festa e Lojra Popullore fest,</li> <li>• Dita ndërkombëtare e PAK, 3 Dhjetori,</li> <li>• Asnjë fëmijë jashtë dhe aktivitete të ndryshme që mund të bëhen gjatë vitit.</li> </ul>					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë promovimin dhe gjithpërfshirjen e PAK në aktivitete social-kulturore.</li> <li>• Synojmë sensibilizimin e familjeve të PAK-ve dhe komunitetit, për aftësitë e veçanta dhe mundësitë e kësaj kategorie.</li> <li>• Synojmë institucionalizimin e marrëveshjes për qëndrueshmërinë e aktiviteteve të kësaj bande.</li> </ul>					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e marrëveshjes me Organizatën The DOOR.</li> <li>▪ Miratimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit.</li> <li>▪ Zhvillimi i provave sipas një kalendari të paracaktuar gjatë gjithë vitit.</li> <li>▪ Angazhimi dhe përfshirja e vazhdueshme e trupës nga stafi drejtues.</li> <li>▪ Pjesëmarrja në aktivitetet e lartpërmendura dhe jo vetëm.</li> <li>▪ Transport për trupën muzikore.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Promovimi dhe gjithpërfshirja e PAK-ve në aktivitetet social – kulturore.</li> <li>○ Sensibilizimi i komunitetit dhe familjeve të PAK.</li> <li>○ Përmirësimi i cilësisë së jetës social-kulturore të PAK.</li> <li>○ Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Personat me aftësi të kufizuara Familjet e personave me aftësi të kufizuara Komuniteti Institucionet publike Organizatat			Bashkia Organizatat Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
A.1	Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12 muaj x12 mijë lekë)	144	Paga	Sigurime	Operative
A.2	Honorar për 2 instruktoret e muzikës (2 x12 muaj x 7.25mijë lekë)	174			174
A.3	Transport	51			51
<b>Shuma</b>		<b>369</b>			<b>369</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Nga kjo:</b>			

		Totali(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mije leke)	144			144		
A.2	Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25mije leke)	174			174		
A.3	Transport	51			51		
<b>Shuma</b>		<b>369</b>			<b>369</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali(mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Sigurime</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferime</b>	<b>Kapitale</b>
A.1	Honorarpër 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mijeleke)	144			144		
A.2	Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25mije leke)	174			174		
A.3	Transport	51			51		
<b>Shuma</b>		<b>369</b>			<b>369</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i organizatës "The Door" <b>Institucioni Likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 35</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A5.</b> Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmohave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshmedhe janë vënë në funksion 24 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese, çdo vit Bashkia e Shkodrës, në prag të festave të fundvitit, parashikon një ndihmë monetare, për jetimët në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.</p> <p>Statusi i jetimit jepet në zbatim të Ligjit Nr. 8153, dt. 31.10.1996 dhe e përfitojnë të gjithë personat me moshë nga 0-25 vjeç që kanë kaluar ose jo nëpër institucionet shtetërore apo private të përkujdesit shoqëror. Statusi i jetimit jepet nga SHSSH-ja nga një komision specialistësh në nivel drejtorie në përbërje të të cilit është dhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve të Shqipërisë. Kjo shoqatë është themeluar vitin 1991 dhe ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të jetimëve dhe integrimin e tyre në komunitet. Kryetar i këtij Komisioni është Drejtor i Përgjithshëm i SHSSH-së. Shoqata e jetimëve dega Shkodër në fundvit sjell pranë Bashkisë Shkodër listën emërore të jetimëve në kushte të vështira social – ekonomike, bashkangjitur medokumentacionin e mëposhtëm, të cilin e dorëzojnë pranë Bashkisë Shkodër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çertifikatën personale të personit.</li> <li>• Vertetim nga shoqata e jetimëve dega Shkodër, që ka pasur ose ka statusin e jetimit.</li> <li>• Fotokopje të ID.</li> <li>• IBAN të tre muajve të fundit.</li> </ul>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë të ndikojmë në përmirësimin e kushteve të jetesës për jetimët.</li> <li>• Synojmë të krijojmë një atmosferë më të mirë në ditë festive, por jo vetëm për këtë kategori.</li> <li>• Synojmë krijimin e mundësive për fuqizimin e jetimëve me qëllim arritjen e autonomisë për edukim, formim, punësim etj.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja dhe sjellja e listës së jetimëve në situatë të vështirë social – ekonomike nga shoqata e jetimëve, dega Shkodër.</li> <li>▪ Vlerësimi i situatës social – ekonomike për personat e përfshirë në listë, nga punonjësit e qendrave komunitare.</li> <li>▪ Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për lëvrimin e fondit të parashikuar.</li> <li>▪ Shpërndarja e fondit për secilin nga personat, në prag të festave të fundvitit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Përmirësimi i kushteve të jetesës për jetimët që jetojnë në konvikte ose të sapo dalë nga strukturat rezidenciale.</li> <li>○ Krijimi i mundësive të përshtatshme për fuqizimin social dhe ekonomik të kësaj kategorie.</li> <li>○ Krijimi i atmosferës më të mirë festive për jetimët.</li> <li>○ Paketa shërbimesh lehtësuese për përmirësimin e situatës së jetimëve në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshmenëprojekt</b>			
Jetimët Shoqata e jetimëve Bashkia e Shkodrës Institucionet publike Organizatrat			Bashkia e Shkodrës Shoqata e jetimëve Organizatrat partnere Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ndihmë me rastin e festave të fundvitit	400			400	
<b>Shuma</b>		<b>400</b>			<b>400</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ndihmë me rastin e festave të fundvitit	400			400	

	<b>Shuma</b>	<b>400</b>				<b>400</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ndihmë me rastin e festave të fundvitit	400				400	
	<b>Shuma</b>	<b>400</b>				<b>400</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Drejtoria e Financës <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

Nr. 36	<b>P.AG141.Q4.O2.A6.</b> Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkëndimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021. Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkëndimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në zbatim të kësaj marrëveshje, me qëllim funksionimin dhe konsolidimin e sistemit të referimit të rasteve për të mbijetuarat e dhunës në familje gjatë vitit, janë organizuar takime të ETN-së për trajtimin, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.</p> <p>Gjatë vitit 2023 janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në qendrat komunitare “Për Familjen”, kundër dhunës me bazë gjinore, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Gjatë aktiviteteve verore të organizuara me fëmijët në qendrat komunitare “Për Familjen” është folur për format e ndryshme të dhunës dhe mënyrat e raportimit të saj. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Gjithashtu, në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit janë planifikuar dhe organizuar një sërë aktiviteteve sensibilizuese mbi fenomenin e dhunës në familje, ku pjesëmarrësit janë njohur me çështjet kryesore mbi dhunën (shkaqet, format e shfaqjes, pasojat, etj) dhe gjithashtu janë informuar mbi shërbimet që ofrohen në territor.</p> <p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore. Gjatë vitit 2024 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatat partnere Gruaja tek gruaja tek Nisma/ Arsis ka rritur kapacitetet e ofrimit të shërbimit të emergjencës, duke rritur numrin e shtretërve dhe numrin e ditëve të qëndrimit në strehëz. Po në këtë kuadër është trajnuar dhe punësuar një staf i posacëm oncall për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve emergjente, i cili funksionon 24/24, 7 në 7. Bashkia Shkodër tashmë ka të ngritur dhe funksionale edhe dy qendra ditore që ofrojnë shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT apo VT. Aktualisht në këtë qendër marrim shërbim 17 fëmijë.</p> <p>Me qëllim fuqizimin socio-ekonomik dhe riintegrimin e tyre në shoqëri për kategoritë vulnerabël si grate viktimat të dhunës në familje janë parashikuar lehtësira në paketën fiskalë të Bashkisë Shkodër, duke i përfshirë nga pagesa e çerdheve dhe kopshteve. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme); shërbime komunitare (mbrojtja e fëmijëve, shërbime për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, shërbime arsimore, lëvizëse, shërbime për higjenën personale, kujdesin shëndetësor); shërbime të strehimit emergjent dhe të përkohshme (strehëz për situatë emergjente dhe banesa sociale). Në varësi të nevojave specifike të rastit, ofrohen edhe shërbimet specifike për të cilat individit ka nevojë. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër, duke asistuar që në momentin e nxjerrjes së UMM-së apo UM-së, marrjen pjesë në seancat gjyqësore, përgatitjen e raporteve për vlerësimin e gjendjes social-ekonomike dhe hartimin e dërgimin e raporteve përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër etj. Të gjithë rastet e dhunës në familje të pajisura me UM përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Specialistët pranë qendrave komunitare “Për Familjen” informojnë çdo rast të pajisur me UM për pagesën që me ligj ju takon dhe orientojnë/ asistojnë për procedurën përkatëse që duhet të ndjekin për ta përfutur atë.</p> <p>Në kuadër të funksionimit të sistemit të referimit, Bashkia e Shkodrës do të koordinojë të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që ofrohen nga institucionet dhe organizatat që veprojnë me rastet e dhunës në familje në territorin e Bashkisë së Shkodrës me synim shtrirjen e shërbimeve në territor dhe parandalimin e këtij fenomeni.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë institucionalizimin e bashkëpunimit ndër-institucional në referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.</li> <li>• Synojmë fuqizimin e partneritetit në drejtim të luftës kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.</li> <li>• Synojmë përmirësimin e ndërhyrjes në mënyrë të koordinuar me ekipe ndër-disiplinare, për një trajtim sa më efektiv të rasteve të dhunës në familje.</li> <li>• Synojmë të përmirësojmë ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat ndaj dhunës në familje.</li> </ul>		

- Synojmë shtrirjen e shërbimeve për rastet e dhunës në familje në njësitë administrative të bashkisë së Shkodrës.
- Synojmë zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Synojmë ofrimin e shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Synojmë parandalimin e fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Synojmë denoncimin e dhunës nga viktimat që në herët e para që ajo mund të ndodhë, jo kur ajo bëhet sistematike.
- Synojmë ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës për përmirësimin e situatës tyre sociale, psikologjike, ekonomike.
- Synojmë garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara si dhe të çdo individ që paraqet nevojë të veçantë mbrojtjeje.

### iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Organizimi i tryezave periodike konsultative për funksionimin e sistemit të referimit.
- Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në marrëveshje nga të gjithë institucionet përgjegjëse.
- Koordinimi i referimit e trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe aktiviteteve të organizuara nga institucionet dhe organizatat mbi këtë fenomen.
- Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve sensibilizuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Mbështetja e aktivitetit të strehëzës, me pagesat utilitare (ujë, drita).
- Përditësimi i të dhënave për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në sistemin [www.revalb.org](http://www.revalb.org) i cili përbën edhe regjistrin elektronik për mbajtjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje.
- Hartimi i raporteve mujore, tremujore dhe vjetore bazuar në të dhënat e sistemit REVALB dhe paraqitja e tyre përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.
- Monitorimi i respektimit të urdhrave të mbrojtjes nga palët dhe përgatitja çdo 60 ditë e një raporti, për të cilin, në çdo rast, vihet në dijeni Policia e Shtetit.

### b) Rezultatet që prisni

- Fuqizimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në familje, në territorin e Bashkisë Shkodër.
- Përmirësimi i ndërhyrjes së koordinuar në identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Përmirësimi i shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë Shkodër për viktimat e dhunës në familje.
- Ndërgjegjësim dhe sensibilizim i viktimave të dhunës në familje për denoncimin e dhunës të ushtruar ndaj tyre.
- Parandalim i fenomenit të dhunës në familje.
- Fuqizimi i shërbimit emergjent.
- Zhvillim i aktiviteteve gjatë ditëve të aktivizmit me pjesëmarrje aktive të komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave.
- Ndërgjegjësim i komunitetit.

### c) Aktorët e mundshëm

Familjet, viktimat e dhunës  
Komuniteti  
Institucionet publike  
OJF-të

### d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia, Policia, Gjykata, Përmbartimi, Prokuroria, Spitali Rajonal, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Rajonal, Mjekësia ligjore, Organizatat.

### e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	150			150		
	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	150			150		
	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale Promocionale	150			150		



	<b>Shuma</b>	<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				



<b>Nr. 37</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A7.</b> Zbatimimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t'u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të vepohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë.</p> <p>Në zbatim të kartës dhe planit të veprimit gjinor janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka "Marin Barleti", Muzeu "Oso Kuka", Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të adresojë çështje të pabarazive dhe diskriminimit.</li> <li>• Të luftojmë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive.</li> <li>• Të promovojmë një shoqëri me të vërtetë të barabartë.</li> <li>• Të ndërmarrim veprime konkrete në favor të barazisë së grave dhe burrave.</li> <li>• Të marrim parasysh plotësisht përmasën gjinore në politikat, organizimin, dhe në praktikat e tyre të punës.</li> <li>• Mbajtjen parasysh të këndvështrimit gjinor në hartimin e politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullatave vendore.</li> <li>• Të hartojmë plane dhe programe veprimi për barazinë, së bashku me mjetet dhe burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbatimimi i kartës evropiane për barazi gjinore e nënshkruar në Mars të vitit 2017.</li> <li>▪ Bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe organizatat në territorin e bashkisë, me synimin për të nxitur arritjen e një barazie të vërtetë në praktikë.</li> <li>▪ Buxhetimi gjinor.</li> <li>▪ Mbledhja dhe administrimi i të dhënave statistikore me fokus në çështjet gjinore.</li> <li>▪ Takime informuese me gra dhe burra, si dhe të reja e të rinj të NJA-ve mbi çështjet e stereotipeve gjinore dhe diskriminimit të shumëfishtë.</li> <li>▪ Takime sensibilizuese me gratë dhe të reja e zonave rurale, si dhe gratë e të reja me aftësi të kufizuara, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në procesin evotimit (individual e të lirë), në zgjedhjet vendore.</li> <li>▪ Aplikimi i qasjes së balancuar gjinore në dëgjesat për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (BPGJ).</li> <li>▪ Takime informuese me administrator/ et shoqëror/e, si dhe punonjës/et social/e të Qendrave Komunitare, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesat publike të grave të grupeve e moshave të ndryshme.</li> <li>▪ Takime informuese me gra dhe burra, si dhe të reja e të rinj të NJA-ve mbi çështjet e stereotipeve gjinore dhe diskriminimit të shumëfishtë.</li> <li>▪ Tryeza me OJF dhe grupe të interesit për raportimin mbi ecurinë e zbatimit të Kartës.</li> <li>▪ Përgatitja dhe prodhimi i materialeve informuese mbi shërbimet ekzistuese dhe të reja të përkujdesit shoqëror.</li> <li>▪ Aktivitete informuese me gratë dhe burrat nga grupet vulnerabël lidhur me shërbimet ekzistuese dhe të reja të përkujdesit shoqëror.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Plane dhe programe veprimi, të mbështetura me burimet e duhura, si instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë së burrave dhe grave.</li> <li>○ Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të qeverisjes vendore.</li> <li>○ Planifikimi i buxhetit të Bashkisë duke u mbështetur gjithashtu në këndvështrimin gjinor.</li> <li>○ Të dhëna statistikore mbi çështjet e pa/barazisë gjinore.</li> <li>○ Planifikimi i ndërhyrjeve në koordinim të nevojave dhe mundësive në territor.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	

Komuniteti Bashkia Organizatat Institucionet publike			Komuniteti Bashkia Organizatat Institucionet publike				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>100</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Organizatrat partnere <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër					

Nr. 38	<b>P.AG141.Q4.O2.A8.</b> TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
--------	--	--

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

**Projekti: “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)”**, me partner lider organizatën “Të Ndryshëm të Barabartë”, është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime: EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian me fonde të programit IPA. Ky projekt parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën e qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç, fshati Shirq, si dhe fuqizimin e kësaj qendre duke ofruar shërbime në ndihmë të grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës.

Në mbështetje të vizionit: **“Shërbime sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”**, pjesë e misionit dhe objektivave ka qënë ndër të tjera edhe ndërtimi, ngritja dhe fuqizimi i shërbimeve me bazë komunitare në zonën e Nën-Shkodrës me qendër në Nj. A. Dajç.

Anëtarët e konsorciumit të projektit, Të Ndryshëm Të Barabartë, Bashkia Shkodër dhe KMOP kanë përvojë afatgjatë në projekte të ngjashme, të zbatuara në Shqipëri dhe Evropë. Anëtarët e konceptuan këtë projekt në mënyrë specifike bazuar në komunikimet dhe ndërhyrjet e përbashkëta për zbatimin e Projektit të BE-së “Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”.

Grupet kryesore të interesit: Viktimat e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë trafikimin, Gratë vulnerabël ndaj dhunës me bazë gjinore dhe familjet/komunitetet e tyre, Ofruesit e Mbështetjes së Viktimave në Shkodër dhe Tiranë duke përfshirë Bashkinë e Shkodrës, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), grupe dhe aktivistë (formale dhe joformale) të udhëhequra nga gratë, media dhe profesionistë të medias, autoritetet kombëtare/BE. Zhvillimi i infrastrukturës në mbështetje të viktimave në veri të Shqipërisë është një nga veprimet kryesore të parashikuara në Planin e Veprimit të këtij projekti. Plani i Veprimit parashikon ngritjen e një qendre multifunkionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshtetërorë për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, në rrezik trafikimi, përfshirë viktimat e trafikimit. Qendra do të ofrojë asistencë dhe shërbime shëndetësore, ekonomike, profesionale trajnimi dhe rritje të kapaciteteve për këto grupe vulnerabël.

Kuadri ligjor:

- Ligji 139/2015, “Për Vetëqeversjen Vendore”;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Kontrata e grantit me nr. reference: IPA 2022/432-378 ndërmjet Autoritetit Kontraktor i përfaqësuar nga Komisioni Evropian dhe organizatës “Të Ndryshëm Të Barabartë” si partner lider i projektit, Bashkisë Shkodër dhe organizatës “Ketro Merimnas Oikogeneias Kai Paidiu” si bashkë-aplikantë në projekt;
- Marrëveshja e partneritetit me Nr. 9913 Prot., datë 17.06.2022 ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe organizatës “Të ndryshëm Të barabartë”

Buxheti i Projektit:

Buxheti total i projektit është 39,651,431.8 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 35,686,290.3 Lekë. Buxheti I dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim I Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).

Shpenzimet e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Fondi me vlerë 447,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve, planifikohet të merret nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 9240 “Arsimi i mesëm profesional”, artikull 231, me kod projekti 1410562 me emërtim “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinarë”, kontrata me Nr. 18397/12 Prot., datë 20.12.2021 me vlerë 10,056,694 lekë. Ky fond kalon tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, kod 231, me emërtim “Mbulim i vlerës TVSH dhe 5% garanci”.

Sipas pikës 5.3.3 të Marrëveshjes së Partneritetit buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër do të disbursohet në këste si vijon:

- 32,472.36 Euro, kësti fillestar i parafinancimit në momentin e çeljes së llogarisë në bankën e nivelit të dyte;
- 20,877.84 Euro, i parashikuar në korrik 2023 pas raportimeve periodike;
- 6,088.09 Euro në korrik 2025 pas raportimeve periodike;
- 6,604.25 Euro, gjendja (balanca) e shumës përfundimtare të grantit në nëntor 2026 pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Bashkia Shkodër merr angazhimin që vlerën e kështit të katërt ta parashikojë me kërkesat buxhetore në PBA 2023-2026 dhe ta vendosë në dispozicion të zbatimit të projektit. Në momentin e miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të balancohet me kështin e katërt sipas pikës 5.3.3 të Marrëveshjes së Partneritetit.

Stafi i projektit është shtuar në vitin 2022 me 1 figurë nën tabelën “Punonjës me kontratë që paguhet nga donatori” në programin 10430 në funksionin e menaxherit lokal të projektit. Menaxheri i projektit ka punuar sipas grafikut: 4 muaj në vitin 2022, 12 muaj në vitin 2023, 8 muaj në vitin 2024. Ndërkohë vlera 10% e bashkëfinancimit me staf ekzistues është

<p>duke u realizuar gjatë 12 mujorit të fundit të projektit. Menaxhimi i qendrës së ngritur i ka kaluar stafit të bashkisë. Përgjatë viteve të implementimit të projektit 2023-2026 stafi është shtuar edhe me dy figura të tjera për 20 muaj të paguar nga donatori në funksionin e mësuesit kryesor (Kategoria IV-a, pozicioni 26,000) dhe mësuesit ndihmës (Kategoria IV-a, pozicioni 25,000) për përfituesit e zones. Të dy mësuesit do të punojnë sipas grafikut: 7 muaj në vitin 2023, 12 muaj në vitin 2024, 1 muaj në vitin 2025.</p> <p>Projekti është miratuar me VKB nr. 49, datë 27.09.2022 "Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër". Gjatë kësaj periudhe janë kryer procedurat e hapjes së llogarisë në bankën e nivelit të dytë. Me shkresën nr. 17778/1 Prot. Datë 24.10.2022 "Transferim fondi për shpenzime kapitale", është transferuar nga SASPAC fond i parashkuar për bashkëfinansim në vlerën 882,205 lekë.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Objektivi i përgjithshëm i projektit është rishikimi dhe avancimi i Sistemit të Mbrojtjes së Viktimave të Bashkisë Shkodër. Projekti aspiron të vazhdojë punën ekzistuese në Tiranë dhe ta zgjerojë më tej atë në Shkodër. Më konkretisht, projekti synon t'u ofrojë viktimave shërbime të integruara të kujdesit social përmes një qasjeje të ndjeshme nga ana gjinore dhe miqësore ndaj fëmijëve, në promovimin e fuqizimit të viktimave dhe në rritjen e aftësive të tyre nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme arsimore dhe punësimit. Projekti do të rrisë qëndrueshmërinë afatmesme dhe afatgjatë të shërbimeve nëpërmjet ndërhyrjeve për ndërtimin e kapaciteteve dhe planifikimit e buxhetimit.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<p>Logjika e ndërhyrjes nëpërmjet aktiviteteve: Në vijim të vlerësimit të çështjeve dhe kontekstit të ndërhyrjes, projekti do të zbatohet nëpërmjet 6 Linjave të Punës (LP) të ndërlidhura me logjikën e mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe logjikën e ndërtimit dhe dorëzimit të programeve cilësore të fuqizimit. Linjat e Punës janë</p> <p><b>LP1:</b> Vlerësimi i nevojave dhe analiza e mangësive në lidhje me shërbimet, burimet dhe infrastrukturën.</p> <p><b>LP2:</b> Ngritja e Përbashkët e Kapaciteteve – Mësimi i ndërsjellë ndërmjet OSHC-ve dhe Bashkisë së Shkodrës.</p> <p><b>LP3:</b> Ngritja e strukturave sociale dhe ofrimi i shërbimeve.</p> <p><b>LP4:</b> Rritja e punësimit dhe mundësive të investimeve për të mbështetur iniciativat e projektit dhe riintegrimin e individëve në afat të gjatë.</p> <p><b>LP5:</b> Monitorimi i procesit të dorëzimit dhe planifikimi e buxhetimi për të siguruar qëndrueshmëri.</p> <p><b>LP6:</b> Përhapja, Rritja e Ndërgjegjësimit dhe rrjetëzimi me Sektorin e Biznesit.</p>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<p>Rezultatet e aktiviteteve pritet të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Një klub për çështje sociale – "Klubi i kauzave sociale" i krijuar në Shkodër, Nj. A. Dajç;</li> <li>Krijimi i bizneseve në pronësi të tre viktimave të dhunës me bazë gjinore në Shkodër, Nj. A. Dajç;</li> <li>Asistimi i viktimave dhe familjeve të tyre;</li> <li>Asistimi i grave vulnerabël dhe familjeve të tyre.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Autoritetet vendore;</li> <li>Qendat Komunitare "Për Familjen",</li> <li>Organizatata e shoqërisë civile,</li> <li>Gratë, Të rinjtë e fëmijët,</li> <li>Media lokale,</li> <li>Komuniteti në përgjithësi.</li> </ul>			<p><u>Partnerë ne projekt:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Bashkia SHKODËR (Shqipëri)</li> <li>Organizata "Të Ndryshem Të Barabartë"</li> <li>KMOP</li> </ol>			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Punonjës menaxhimi i Klubit Social NJ.A. Dajç	113	100	13		
A.2	Shpenzime për transportin	7			7	
A.3	Materiale për zyrë	10			10	
A.4	Aktiviteti përmbyllës i projektit					
A.4.1	Katering për pjesëmarrësit	238			238	
A.4.2	Materiale promocionale	238			238	
A.5	Ekspert i jashtëm – Supervisor	143			143	
A.6	Të tjera (Shpenzime indirekte sipas marrëveshjes)	21			21	
A.7	Mbulim i vlerës TVSH per shpenzimet operative (fondet e bashkise)	96			96	

A.8	Mbulim i vlerës për shumën e balancës së projektit me fondet e Bashkisë Shkodër	<b>787</b>			787		
	<b>SHUMA</b>	<b>1,653</b>	<b>100</b>	<b>13</b>	<b>1,540</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër				

<b>Nr. 39</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A9.</b> Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash.</p> <p>Gjatë vitit 2024, në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas, si një ditë e veçantë për të folur mbi të drejtat e gruas, si të drejta themelore të njeriut, për arritjen e barazisë gjinore u realizua një fushatë ndërgjegjësuese e shtrirë përgjatë të gjithë javës. Gjatë të gjithë javës janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin, me shoqërinë civile, me institucionet rajonale. Aktivitetet janë zhvilluar në institucionet kulturore, si Muzeu Historik "Oso Kuka", Biblioteka "Marin Barleti", Galeria e Arteve, Teatri Migjeni, qendrat komunitare "Për Familjen" dhe qendrën rinore "Atelie". Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë të ndërgjegjësojmë komunitetin e Shkodrës, në ditën ndërkombëtare të gruas, si një ditë proteste dhe jo festë.</li> <li>• Synojmë të ndikojmë në traditën e krijuar në qytet, mbi 8 marsin, nuk është një ditë feste, por është një ditë ndërkombëtare ku llobohet fuqishëm për të drejtat e gruas dhe jo vetëm.</li> <li>• Synojmë pjesëmarrje të barabartë gjinore në aktivitetet e kësaj dite.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mbledhja e tryezës konsultative për të diskutuar mbi organizimin e aktiviteteve në ditën ndërkombëtare të gruas.</li> <li>▪ Organizim takimesh ndërgjegjësuese. Në këto aktivitete kushtohet vëmendje pjesëmarrjes së barabartë gjinore, për të diskutuar mbi të drejtat njerëzore, barazinë, situatën sociale në Bashkinë e Shkodrës, çfarë mund të bëjmë më tej, etj.</li> <li>▪ Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promociionale për ndërgjegjësimin e mbarë komunitetit, në ditën ndërkombëtare të gruas.</li> <li>▪ Bashkëpunim i ngushtë me median, institucionet publike, organizatat, biznesin privat dhe komunitetin.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Sensibilizimi i komunitetit për të drejtat e gruas.</li> <li>○ Pjesëmarrje aktive e komunitetit (meshkuj dhe femra) në aktivitete ndërgjegjësuese.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti Institucionet Organizatrat			Bashkia Organizatrat Institucionet Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime      Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100	
<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime      Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100	
<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime      Kapitale
A.1	Shërbim Katering	100			100	
<b>Shuma</b>		<b>100</b>			<b>100</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik  <b>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</b>			

<b>Nr. 40</b>	<b>P.AG141.Q4.O2.A1</b> <b>0. Kujdesi social</b> ndaj moshës së tretë	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>					
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t'u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare "Për Familjen"Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambientet e qendrës dhe jashtë saj. Ndërkohë është arritur shtrirja e këtij shërbimi edhe në një qendër tjetër komunitare. Tashmë në Qendrën Multifunksionale Xixëllonjat është në dispozicion 1 hapësirë, e cila ofron shërbime ditore për të moshuarit e lagjes nr.1.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synojmë organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sensibilizuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> <li>• Synojmë rritjen e numrit të vullnetarëve dhe kontributit nga ana e tyre në përmirësimin e cilësisë së jetës të shtresës së tretë.</li> <li>• Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit për krijimin e mundësirave dhe hapësirave të nevojshme për moshën e tretë.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave.</li> <li>▪ Organizim i aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese, por jo vetëm.</li> <li>▪ Propozimi i mënyrave për përfshirje aktive të të moshuarve në shoqëri.</li> <li>▪ Përfshirja e vullnetarëve në ndihmë të moshës së tretë.</li> <li>▪ Kujdesi social ndaj moshës së tretë.</li> <li>▪ Diskutimi i mundësive për ofrimin e shërbimeve në shtëpi, për të moshuarit që jetojnë vetëm.</li> <li>▪ Bashkëpunimi me institucionet publike, organizatat, biznesin privat dhe komunitetin për krijimin e mundësive në përbushje të nevojave tyre.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Aktivitete gjithëpërfshirëse për nga diversiteti i institucioneve, organizatave pjesëmarrëse dhe komunitetit.</li> <li>○ Sensibilizim i komunitetit dhe institucioneve.</li> <li>○ Përmirësim i cilësisë së jetës për të moshuarit e bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Komuniteti Institucionet publike NJVKSH OJF-të			Bashkia Institucionet publike NJVKSH OJF-të Bizneset private Komuniteti				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali(mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbim Katering	50			50		
<b>Shuma</b>		<b>50</b>			<b>50</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale

A.1	Shërbim Katering	50			50		
	<b>Shuma</b>	<b>50</b>			<b>50</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbim Katering	50			50		
	<b>Shuma</b>	<b>50</b>			<b>50</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni Likujdues:</b> Bashkia Shkodër				



Nr. 41	P.AG141.Q4.O2.A11. "Kafe me gjysherit" në Qendrën Komunitare "Për Familjen" Nr.4	Programi AG141: Përkujdesi Social				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<b>Kuadri i përgjithshëm:</b>						
Pranë qendrës komunitare "Për Familjen"Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj. Në kuadër të iniciativave për përmirësimin e shërbimeve sociale për të moshuarit, Bashkia Shkodër, nëpërmjet Qendrës Komunitare për Familjen Nr. 4, planifikon të fuqizojë shërbimet aktuale një anë të nismës të quajtur "Kafe me Gjysherit". Ky shërbim ka për qëllim të shërbejë si një shtysë për krijimin e një hapësirë edhe më sociale dhe mbështetje për të moshuarit, ku ata mund të mblidhen, të ndajnë eksperiencat e jetës, dhe të përfitojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sociale. "Kafe me Gjysherit" ofron mundësi për krijimin e lidhjeve miqësore, zhvillimin e aftësisë dhe ofron mbështetje psikologjike për ata që mund të kenë nevojë. Kjo nismë synon të përmirësojë cilësinë e jetës për të moshuarit, duke i inkurajuar ata të jenë aktivë dhe të angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në mirëqenien e tyre fizike dhe mendore.						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
Synimi i nismës "Kafe me Gjysherit" është të krijojë një hapësirë të sigurt dhe mbështetëse për të moshuarit e Bashkisë Shkodër, ku ata mund të ndihen të vlerësuar, të lidhur dhe të aktivizuar. Kjo iniciativë ka për qëllim të ofrojë mundësi për ndërveprim social, zhvillim personal dhe mbështetje psikologjike. Ajo synon gjithashtu të përmirësojë cilësinë e jetës për të moshuarit, duke i mundësuar atyre të përfshihen në aktivitete kulturore, edukative dhe shëndetësore, duke u ndihmuar në ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik dhe duke i inkurajuar ata të mbajnë një stil jete aktiv dhe të angazhuar.						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave.</li> <li>▪ Organizim i aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese, por jo vetëm.</li> <li>▪ Propozimi i mënyrave për përfshirje aktive të të moshuarve në shoqëri.</li> <li>▪ Përfshirja e vullnetarëve në ndihmë të moshës së tretë.</li> <li>▪ Kujdesi social ndaj moshës së tretë.</li> <li>▪ Bashkëpunimi me institucionet publike, organizatat, biznesin privat dhe komunitetin për krijimin e mundësive në përbushje të nevojave tyre.</li> <li>▪ Takime sociale dhe diskutime.</li> <li>▪ Aktivitete kulturore dhe artistike.</li> <li>▪ Aktivitete shëndetësore.</li> <li>▪ Organizimi i aktiviteteve të jashtme.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Përmirësim i cilësisë së jetës për të moshuarit e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>•Rritje të angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive.</li> <li>•Rritje e vetëvlerësimit dhe përfshirjes sociale.</li> <li>•Të moshuar më aktivë dhe të përfshirë në aktivitete sociale.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti Institucionet publike NJVKSH OJF-të ▪			Bashkia Institucionet publike NJVKSH OJF-të Bizneset private Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali ( 000 lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1						
<b>Shuma</b>						

<p><b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025</p>	<p><b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër</p>
---	--

Nr. 42	P.AG141.Q4.O2.A12. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale	Programi AG141: Përkujdesi Social
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Skemës së Granteve “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”, ku Autoriteti Financues përfaqësohet nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, më 14.07.2023 me projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale”. Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813 është përzgjedhur fitues për lidhjen e kontratës së grantit. e cila u nënshkrua më 28.09.2023 Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 60,000 Euro (6,404,700 Lekë), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.</p> <p>Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.</p> <p>Gjithashtu kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% dhe kosto të tjera në vlerën 300,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit.</p> <p>Bashkëfinancimi me fondet e bashkisë për vlerën 300,000 lekë është për vitin 2024.</p> <p>Financimi do të bëhet në dy faza/këste: Kësti i parë me vlerë 30,000 Euro (3,202,350 lekë) do të jetë paradhënie dhe ndërsa kësti i dytë me vlerë 30,000 Euro (3,202,350 lekë) do të disbursohet nga donatori sipas nenit 4.1.c, pas dorëzimit dhe njohjes së shpenzimeve nga autoriteti financues të këstit të parë.</p> <p>Ky fond është i detajuar në ffishen totale të buxhetit të projektit në tabelën më poshtë.</p> <p>Për kohëzgjatjen e projektit është planifikuar me fondet e projektit punësimi i kordinatorit të projektit për vitet 2023, 2024 dhe 2025.</p> <p>Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.</p> <p>Koordinatori i Projektit do të punojë sipas angazhimit: 1.5 muaj në vitin 2023, 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025.</p> <p><b>Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.</b></p> <p>Nëpërmjet projektit “Puno dhe Mëso për Përfshirjen Sociale” synojmë të reduktojmë hendekun socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian për të rritur pjesëmarrjen e tyre në komunitetin e Shkodrës.</p> <p><b>Objektivi i përgjithshëm i projektit është:</b></p> <p>Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritimit konkret në shoqërinë e qytetit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim;</li> <li>2. Rritja e numrit dhe performancës së fëmijëve të regjistruar në shkollë.</li> </ol> <p><b>Aktivitetet Kryesore:</b></p> <p><b>I: Puna në komunitet</b></p> <p>Përmes këtij projekti duam të mundësojmë që kapacitetet e tyre të integrohen në programet e punës në komunitet në mbështetje të punëve që duhen bërë në qytet dhe nuk mbulohen nga buxheti i Bashkisë. Do të krijohet një “brigadë” prej 14 punonjësish komunitar me detyrën specifike për të ndërhyrë në zonat e interesit të Bashkisë për të rritur cilësinë dhe performancën e shërbimeve publike veçanërisht në zonat turistike.</p> <p>Skema e punës në komunitet do të hartohet në përputhje me VKM nr. 535 datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”, të ndryshuar. Gjatë zbatimit të projektit do të bëhet edhe blerja e pajisjeve për punët komunitare, prerëse bari, karafil, fshesa, lopata, thasë mbeturinash etj, për të lehtësuar punën e tyre dhe për të krijuar kushtet që brigada të ketë një profesion të qëndrueshëm. edhe pas përfundimit të projektit.</p> <p><b>II : Bursat</b></p> <p>Ndihma dhe mbështetja me bursë për fëmijët dhe familjet e komunitetit rom dhe egjiptian do ta ndihmojë këtë grup të synuar në përfshirjen sociale nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm.</p> <p>Nëpërmjet projektit propozohet që të ndihmohen edhe në materiale shkollore për nxënësit dhe familjet e mbështetura, me blerjen e çantave, librave dhe aksesoreve shkollore për të lehtësuar dhe ulur shpenzimet e frekuentimit në shkollë. Për të marrë rezultate konkrete është planifikuar që të ketë një ekspert të jashtëm që do t'i ndjekë nxënësit në Qendrën Multifunkionale për 60 seanca për të kontrolluar dhe ndihmuar fëmijët në rritjen e performancës së tyre në shkollë.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritimit konkret në shoqërinë e qytetit.		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
I: Puna në komunitet;		
II: Bursat.		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
1. Fuqizimi social dhe ekonomik i 14 familjeve romë dhe egjiptiane.		
2. Rritja e frekuentimit të shkollave të 30 fëmijëve të komunitetit.		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti Bashkia Shoqëria Civile	Bashkia Komuniteti Projekti “Skema e Granteve “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin	

		punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>				
			<b>Paga</b>	<b>Siguri me</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferi me</b>	<b>Kapitale</b>
A. 1	Paga për 1 punonjës (60% e kohës)(donatori)	<b>53</b>	45	8			
	<b>Shuma</b>	<b>53</b>	45	8			
<b>f) Periudha e zbatimit 2025</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike <b>Institucioni Likujdues: Bashkia Shkodër</b>					

Nr. 43	<b>P.G141.Q4.O2.A13.</b> HOLD ON - Nxitje e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë financiar në kuadër të programit Erasmus+	Programi AG141: Përkujdesi Social
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p><b><u>Kuadri i përgjithshëm:</u></b>          Bashkia Shkodër është shpallur fituese në projektin “Projektin HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” në kuadër të thirrjes për projekte të programit Erasmus+, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze. Nëpërmjet këtij projekti synohet aksesi i të rinjve në shërbimet joformale të shëndetit mendor të bashkëmoshatarëve në pika shërbimi që nuk ofrohet shërbimi mjekësor, siç janë institucionet arsimore, organizatat rinore, qendrat e punës, qendrat sportive dhe qendrat kulturore, duke siguruar që të arrihen të rinjtë më vulnerabël.          Projekti do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për mirëqenien mendore të të rinjve. Projekti synon që perfituesit të jenë rinjtë e moshës 14-29 vjeç, si dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë.</p> <p><b><u>Kuadri ligjor:</u></b>          Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:          - Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”          - Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.          - Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.          - Marrëveshja standarte mes Programit Erasmus+ dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, me Nr. 20713 Prot, datë 29.12.2023.</p> <p>Projekti Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, financuar në kuadër të programit “Erasmus+”, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze për të mbështetur projekte në fushën e rinisë dhe sporteve, në programin Erasmus+ 2021-2027, shuma është 2,869,000 LEK.          Gjatë vitit 2024 janë realizuar një pjesë e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të projektit.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Përmirësimi i aksesit të të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhim proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<b>Aktiviteti 1:</b> Dizajnimi dhe zhvillimi i kursit e-learning. <b>Aktiviteti 2:</b> Pilotimi dhe finalizimi i kursit e-learning. <b>Aktiviteti 3:</b> Programi i mentorimit. <b>Aktiviteti 4:</b> Organizimi i konferencës ndërkombëtare.		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<p><b><u>Rezultati 1:</u></b>          • Kurs gjithëpërfshirës e-learning për advokuesit e shëndetit mendor të të rinjve - të rinjtë me përvojë në fushën mendore dhe sfidat shëndetësore dhe/ose me interes për shëndetin mendor dhe promovimin e mirëqenies.          • Programi i mentorimit të avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve të interesuar në krijimin e Grupeve Mbështetëse të Shëndetit Mendor bashkëmoshatar.          • Konferenca ndërkombëtare e avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve.</p> <p><b><u>Rezultati 2:</u></b>          • Raporti i njohurive mbi faktorët kryesorë që ndikojnë në përfshirjen e profesionistëve në mbështetjen e shërbimeve të shëndetit mendor të të rinjve          • Doracak për profesionistët për mbështetjen e të rinjve në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për shëndetin mendor          • Ditët Kombëtare të “Matchmaking” që stimulojnë bashkëpunimin mes të rinjve dhe profesionistëve.</p> <p><b><u>Rezultati 3:</u></b>          • Platformë shkëmbimi ku të rinjtë dhe profesionistët mund të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira në shëndetin mendor të të rinjve          • Politikat dhe dokumenti i rekomandimeve, duke përfshirë hartimin e palëve të interesuara dhe rekomandimet për forcimin reagimi për shëndetin mendor të të rinjve.          • Aktivitetet kombëtare të advokimit duke përfshirë të rinjtë, profesionistët dhe politikëbërësit</p> <p><b><u>Rezultati 4:</u></b>          • Strategjia dhe plani i gjerë i shpërndarjes dhe shfrytëzimit duke detajuar aktivitetet për të siguruar ndikimin maksimal të projektit aktivitetet dhe dukshmëria dhe shpërndarja efektive e rezultateve të projektit          • Materialet dhe aktivitetet e ngritjes së ndërgjegjësimit dhe shpërndarjes (logoja e projektit, identiteti vizual, uebsajti i projektit, llogari në rrjetet sociale, njoftime për shtyp, fletëpalosje dixhitale, infografikë, ngjarje shumëzuese)</p>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Autoritetet vendore &amp; lokale;</li> <li>▪ Nëpunësit e qeverisjes lokale,</li> <li>▪ Organizatat e shoqërisë civile,</li> <li>▪ Media lokale,</li> <li>▪ Komuniteti në përgjithësi.</li> </ul>	Agjencia Kombëtare Franceze, Komisioni Bashkimit Evropian	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali ( 000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për projektin (1 punonjës)	115.3	98.8	16.5		
<b>Shuma</b>		<b>115.3</b>	98.8	16.5		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar - Dhjetor 2025			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër			

Nr. 44	P.AG141.Q4.O2.A14. "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen"	Programi AG141: Përkujdesi Social			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
<b>i. Situata</b>					
<p><b>Kuadri i përgjithshëm:</b>  Projekt "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).</p> <p><b>Kuadri ligjor:</b>  Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:  - Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"  - Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.  - Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.  - Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016.  - Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara 'Askush të mos mbetet pas' ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", me Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024.  Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 4,052,492 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin: Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,997,500 Lekë (73.97%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.  Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 1,054,992 lekë. 26.03%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë projektin me burimet e veta, sipas zërave: Paga dhe sigurime (staf ekzistues që ndjek projektin) për projektin dhe bashkëfinancimi do të mbulohet nga burimet ekzistuese dhe nuk kërkon kosto shtesë për financim.  Projektin ka parashikuar të punësojë dy punonjës në rolin e mësuesve mbështetës (part-time) 50% sipas angazhimit i cili do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025.</p>					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Qëllimi i përgjithshëm i propozimit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të fëmijëve dhe familjeve, që synojnë rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
A.1: Ofrimi i shërbimeve edukative passhkollore pranë hapësirave të Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1 dhe Qendrës Multifunkionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5. A.2: Zhvillimi i një kampi veror për fëmijët përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunkionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5. A.3: Zhvillimi i një aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunkionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rezultati nr.1 : Dy (2) qendra të ngritura dhe funksionale që ofrojnë shërbime ditore cilësore për fëmijët dhe familjen.</li> <li>▪ Rezultati nr.2: Një (1) kamp veror i organizuar me fëmijët përfitues të shërbimeve.</li> <li>▪ Rezultati nr.3: Një (1) aktivitet final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve i organizuar.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Autoritetet vendore &amp; lokale;</li> <li>▪ Nëpunësit e qeverisjes lokale,</li> <li>▪ Organizatat e shoqërisë civile,</li> <li>▪ Media lokale,</li> <li>▪ Komuniteti në përgjithësi.</li> </ul>			Agjencia Kombëtare Franceze, Komisioni Bashkimit Evropian		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali ( 000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative
A.1	Paga për 2 punonjës Mësues Staf mbështetës (50 % të kohës)	360	306	54	

A.2	Zhvillim aktiviteti përmbyllës i projektit (transport, dreka etj)	260			260	
<b>Shuma</b>		<b>620</b>	<b>306</b>	<b>54</b>	<b>260</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Qershor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				



<b>Nr. 45</b>	<b>P.AG141.Q5.O1.A1</b> Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të stafit të strehimit social në funksion të përmbushjes së misionit qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësi për ofrimin e programeve të strehimit ndaj qytetarëve.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p><b>Paga dhe shtesat mbipaga.</b> Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", i ndryshuar.</p> <p><b>Kontributi për sigurime shoqërore dheshëndetësore.</b> Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor" dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore"</p> <p><b>Kompensim për kryefamiljarë të mungarës së memëshumës të personanë ngarkim në familje</b> Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç. Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit. Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës. Në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, për vitin 2025 do të vijojë realizimi në vazhdimësi i menaxhimit efektiv dhe shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeverisje e mirë vendore, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të stafit të punonjësve të strehimit social.</li> <li>• Shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore të stafit të punonjësve.</li> <li>• Analizë e punës, me qëllim specifikimin dhe llogaritjen e saktë të ngarkesës dhe punës për secilin punonjës, normimin e punës dhe detajimin më specifik të procedurave administrative.</li> <li>• Ndërtimi i një sistemi vlerësimi të performancës, bazuar në rezultate dhe produkt për punën e stafit të punonjësve të strehimit social.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për stafin e punonjësve të strehimit social.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore të stafit të strehimit social, në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Strehimit dhe Shëndetit Publik</li> <li>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore</li> <li>• Drejtoria e Financës</li> </ul>				Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>3,890</b>	3,356	534		

	<b>Shuma</b>	<b>3,890</b>	<b>3,356</b>	<b>534</b>			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>3,890</b>	3,356	534			
	<b>Shuma</b>	<b>3,890</b>	<b>3,356</b>	<b>534</b>			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për punonjësit	<b>3,890</b>	3,356	534			
	<b>Shuma</b>	<b>3,890</b>	<b>3,356</b>	<b>534</b>			
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> - Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik - Drejtoria e Burimeve Njerëzore - Drejtoria e Financës <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër					

<p><b>Nr. 46</b></p>	<p><b>P.AG141.Q5.O1.A2</b> Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë"</p>	<p><b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b></p>
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b></p>		
<p><b>i. Situata</b></p>		
<p>Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.</p> <p><b>"Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë"</b> si një instrument financiar i programit social të strehimit "Banesa sociale me qira", mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencionimi i qirasë realizohet nga Bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.</p> <p>Bashkia Shkodër do të vlerësojë në vazhdimësi nivelin e të ardhurave të përfituesve në raport me vlerën e qirasë për të siguruar që qiraja është e përballeshme për përfituesit. Në rastet kur vlera e qirasë zë një përqindje më të madhe se ajo e përcaktuar në ligj në raport me nivelin e të ardhurave e individit/familjes, do të raportojmë pranë Këshillit Bashkiak me synim <u>përijashtimin e mundshëm nga pagesa e qirasë</u> të individëve/familjeve që kanë të ardhura të pamjaftueshme.</p> <p>Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", shtojca "A", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB.</p> <p>Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës "A" të VKM-së 362, datë 20.05.2019.</p> <p>Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave "<i>Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit.</i>"</p> <p>Për këtë instrument financiar, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë, për vitin 2024", është miratuar lista me 47 individë/familje përfituese</p> <p>Lista e aplikuesve në këtë program social të strehimit i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2024, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar dhe sipas Shtojca A "Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV".</p> <p>Me shkresën me nr 4474/3 prot datë 22.04.2024 me lëndë "Për transferim fondi nga buxheti i shtetit për programin e subvencionimit të qirasë" administruar nga Bashkia Shkodër me nr. 8620 prot datë 24.04.2024 jemi njoftuar për transferimin e fondit për këtë program.</p> <p>Me transferimin e fondit është bërë e mundur dhe ka filluar procedura e likuidimit për programin e subvencionimit të qirasë.</p> <p>Gjatë procedurës së likuidimit të qirasë u evidentua nga struktura përgjegjëse, gabimi material (për llogaritjet) e vlerës për përfituesen V. L me nr.rendor 17, në tabelën bashkëlidhur VKB –së nr.7 datë 31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë" për vitin 2024."</p> <p>Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 22.05.2024, u relatua nga struktura përgjegjëse e strehimit gabimi i evidentuar, u shqyrtua nga Komisioni dhe u miratua, sipas procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, me nr. 11004/3 prot, datë 22.05.2024.</p> <p>Me datë 31.05.2024 Këshilli Bashkiak miratoi me vendim nr.35 "Për një ndryshim në VKB-në nr.7, datë 31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë" për vitin 2024".</p> <p>Ndërkohë për këtë instrument financiar, për vitin 2025, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura sipas shpalljes së bërë në faqen e zyrtare të Bashkisë.</p> <p>Në funksion të këtij instrumenti është miratuar nga Këshilli Bashkiak vendimi nr.61 datë 30.9.2024 "Miratimi i vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2024".</p> <p>Jemi në fazën e dytë të këtij programi ku cdo aplikant do të njoftohet për plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p>Lista e aplikuesve për këtë program social të strehimit do t'i përcillet Ministrisë së Ekonomisë, me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2025, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, dhe sipas Shtojca A "Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV".</p>		

<p>Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", I ndryshuar, përfituesit dorëzojnë kontratën e qirasë brenda afateve kohore ligjore pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë. Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", shtojca "A", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB. Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës "A" të VKM-së 362, datë 20.05.2019. Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave "Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit."</p> <p>Sa më sipër, Bashkia Shkodër bashkëfinancon për këtë instrument financiar të strehimit jo më pak se 30% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Orientimi dhe përfshirja e të gjithë grupeve prioritare për strehim social më të përshtatshëm, bazuar në profilin social-ekonomik të tyre.</li> <li>• Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballeshëm për familjet në kushte të vështira social-ekonomike.</li> <li>• Rritje e numrit të familjeve përfituese me subvencionim të qirasë.</li> <li>• Orientimi drejt programeve të tjera të strehimit në momentin që përfituesit arrijnë një fuqizim social-ekonomik të konsiderueshëm.</li> <li>• Konsolidim i shërbimit të strehimit social pranë bashkisë.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvillimi i takimeve informuese, në mënyrë që përfituesit të kenë informacion të plotë mbi programet që ata mund të përfitojnë dhe që i përshtaten dhe që mund të aplikojnë në momentin që Bashkia shpall thirrjet.</li> <li>▪ Subvencionimi i qirasë për individë/familje pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta.</li> <li>▪ Fuqizimi social-ekonomik i përfituesve.</li> <li>▪ Bashkëpunime dhe marrëveshje me OJF, institucione publike, biznes privat, në mbështetje të përmirësimit dhe integritimit social të përfituesve.</li> <li>▪ Bashkërendimi, koordinimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me donatorë dhe me Qeverinë Shqiptare për të mundësuar shtimin e përfitimit të fondeve për strehim social, sipas nevojave të komunitetit.</li> <li>▪ Forcimi i kapaciteteve në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave e strehimit social.</li> <li>▪ Përmirësim i qasjes në strehim të individëve/familjeve vulnerabël.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv.</li> <li>○ Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve sociale të strehimit që zbatohen.</li> <li>○ Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë Shkodër.</li> <li>○ Kushte të banimit të përmirësuara për individët/familjet në pozita të pafavorizuara që banojnë në territorin e Bashkisë Shkodër</li> <li>○ Cilësi e jetës dhe shëndet i përmirësuar i komunitetit.</li> <li>○ Fuqizim social-ekonomik i individëve/familjeve në pozita të pafavorizuara.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
<p>Individë dhe familje në pozita të pafavorizuara, në vështirësi social-ekonomike që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm.</p> <p>Jetimët</p> <p>PAK</p> <p>Të moshuarit</p> <p>Familjet njëprindërore, gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike, viktime të dhunës apo trafikimit.</p> <p>Familje të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian.</p> <p>Familje që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike, jashtë standardeve të kërkuara e të miratuara.</p>			<p>Bashkia Shkodër</p> <p>Donatorë</p> <p>OJF</p> <p>Qeveria Shqiptare</p> <p>Ministria e Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit</p> <p>Institucionet publike dhe bizneset në territor</p>				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (me burimet e veta)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	<b>5,468</b>				5,468	
	<b>Shuma</b>	<b>5,468</b>				<b>5,468</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 (me burimet e veta)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale



A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	5,973				5,973	
	<b>Shuma</b>	<b>5,973</b>				<b>5,973</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 (me burimet e veta)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	6,477				6,477	
	<b>Shuma</b>	<b>6,477</b>				<b>6,477</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (me transfertë të kushtëzuar)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	12,758				12,758	
	<b>Shuma</b>	<b>12,758</b>				<b>12,758</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 (me transfertë të kushtëzuar)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	13,936				13,936	
	<b>Shuma</b>	<b>13,936</b>				<b>13,936</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 (me transfertë të kushtëzuar)</b>		<b>Totali ( mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	15,114				15,114	
	<b>Shuma</b>	<b>15,114</b>				<b>15,114</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>					
Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		-Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik - Ministria e Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit <b>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</b>					

<p style="text-align: center;"><b>Nr. 47</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>P.AG141.Q5.O1.A3</b> Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti"</p>	<p style="text-align: center;"><b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b></p>
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b></p>		
<p><b>i. Situata</b></p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.</p> <p>- <b>"Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti"</b>, është një instrument financiar në zbatim e mbështetje të programit social të strehimit "Banesa me kosto të ulët".</p> <p>Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtë të përfitojnë kredi me kushte lehtësuese që jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë të ofruara nga institucionet financiare për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit të përcaktuara.</p> <p>Në zbatim të VKM nr. 384, datë 12.6.2019 ndiqen procedurat e parashikuara për zbatimin e programeve sociale të strehimit. Informacioni në lidhje me programet sociale të strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, ku çdo ditë pranë Zyrës me Një Ndalesë, janë bërë aplikime nga qytetarët. Kuotat e vëna në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë instrument financiar për vitin 2020, janë 100. Gjatë kater viteve të zbatimit të këtij instrumenti financiar, janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak pesë lista përfituesish. Listat e përfituesve, sipas marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Shkodër dhe tre institucioneve financiare/bankave (BKT, Intesa Sanpaolo dhe Raiffeisen Bank), në zbatim të procedurave ligjore u janë dërguar për zbatim institucioneve financiare dhe Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Shkodër.</p> <p>Deri tani ka disa përfitues të kredituar nga bankat dhe disa përfitues në proces të kreditimit.</p> <p>Meqënëse Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota të miratuara, dhe këto kuota nuk janë plotësuar akoma edhe pse janë miratuar katër lista përfituesish nga Bashkia Shkodër, në lidhje me kuotat në dispozicion për vitin aktual, <b>Bashkia ka shpallur përsëri Thirrje.</b></p> <p>Bashkia Shkodër ka shpallur në faqen zyrtare ëeb të internetit njoftimin me listën e aplikuesve për instrumentin financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti" dhe ka vijuar me procedurën e njoftimit shkresor për të gjithë aplikuesit, për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë. Pas plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga qytetarët/aplikuesit, vijon procedura e shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe miratimit të dokumentacionit me listën e përfituesve, e cila dërgohet për miratim pranë Komisionit të Strehimit dhe me vendim të Këshillit Bashkiak, shpallet lista e përfituesve.</p> <p>Drejtoria e Shërbimeve Sociale, në zbatim të detyrave të saj, i është drejtuar me shkresën nr.11294 prot, dt.23.05.2024, bankave që kanë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse, me shkresën 11409 prot, datë 24.05.2024 EKB-së, për familjet përfituese të cilat kanë bërë shtyrjen e afatit të procedurave të kreditimit si dhe email Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me datë 31.05.2024.</p> <p>Nga informacionet e përditësuara, të marra nga bankat dhe nga Enti Kombëtar i Banesave, rezulton që nga 100 kuotat të cilat kanë qënë të parashikuara, janë ezauruar përkatësisht me BKT-në 36 kuota, me Raiffeisen 5 kuota dhe me Intesa SanPaolo 15 kuota.</p> <p>Ndërsa nga Enti Kombëtar i Banesave ka ardhur përgjigja se 23 përfitues kanë bërë kërkesë për shtyrjen e afatit për vazhdimin e procedurave të kreditimit.</p> <p>Në kthimin e përgjigjes, Ministria përgjegjëse konfirmoi vlefshmërinë e kuotave dhe vazhdimin e procedurës deri në ezaurimin e kuotave të paezauruara.</p> <p>Sa më sipër, mbas konfirmimeve zyrtare të ardhura nga institucionet përgjegjëse, rezultoi në total nga 100 kuota të vëna në dispozicion, 21 kuota ishin të paezauruara.</p> <p>Në vijim struktura përgjegjëse, në zbatim të pikës 18 të VKM nr.384 datë 12.06.2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", e dërgon për miratim listën shtesë të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak që duhet ta marrë në shqyrtim në mbledhjen e parë të rradhës.</p>		

<p>Me datë 28.06.2024 Këshilli Bashkiak miratoi vendimin nr.39 " Për miratimin e listës shtesë së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti".</p> <p>Pas miratimit në Këshill Bashkiak, struktura përgjegjëse pranë Bashkisë Shkodër ka përcjellur listën e përfituesve Entit Kombëtar të Banesave, insitucioneve financiare që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e linjës për zbatimin e këtij programi.</p> <p>Me shkresën me nr.20479 prot., datë 15.10.2024 me lëndë " Kërkesë", i jemi drejtuar Ministrisë së linjës, për të na mbështetur me kuota të tjera për këtë instrument financiar, në përputhje me crmimet aktuale të banesave në treg.</p> <p><b>"Grant i menjëhershëm"</b> është një instrument financiar në zbatim e mbështetje të programit social të strehimit "Banesa me kosto të ulët".</p> <p>Ky instrument financiar që përfiton individi, është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.</p> <p>Pranë Bashkisë Shkodër depozitohen kërkesa për të përfituar nga Granti i menjëhershëm, të cilat pas plotësimit të dokumentacionit dhe vlerësimit rezultojnë që përmbushin kriteret e përcaktuara, duke vërtetuar statusin përkatës, në zbatim të pikës 11 të VKM-së nr. 555, datë 15.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit", të cilët miratohen si përfitues të këtij fondi me vendim të Këshillit Bashkiak. Ndiqen procedurat për lëvrimin e këtij fondi pas miratimit nga Minsitria e Ekonomisë.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të mesme që nuk mund të përballojnë blerjen e banesave në treg.</li> <li>• Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e programeve sociale të strehimit</li> <li>• Ofrimi i alternativave për një strehim të përballueshëm e të përshtatshëm.</li> <li>• Administrimi i të dhënave aktuale e të sakta me qëllim hartimin e politikave efikase.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Subvencionimi i interesave të kredisë për individë/familje me të ardhura mesatare të qëndrueshme.</li> <li>▪ Shpallja e thirrjes për aplikim për programet që do të zbatohen dhe janë financuar.</li> <li>▪ Plotësim i formularëve të aplikimit sipas programeve të strehimit.</li> <li>▪ Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas sistemit të pikëzimit.</li> <li>▪ Njoftim i aplikuesve që nuk kualifikohen për plotësim të të metave.</li> <li>▪ Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit.</li> <li>▪ Shqyrtim dhe verikim të aplikimeve nga Komisioni i Strehimit.</li> <li>▪ Dërgim për miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv.</li> <li>○ Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve sociale të strehimit që zbatohen.</li> <li>○ Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë Shkodër.</li> <li>○ Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve me të ardhura të mesme</li> <li>○ Lista e përfituesve të programeve të strehimit të zbatuar në bashki të miratuar në Këshillin Bashkiak</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Individë/familje (çifte) të reja; Familjet njëprinderore Individe me aftesi të kufizuara Individët/familjet të mbetura të pastreha për shkak të liritimit të banesës ish-pronarëve; Individët punonjës të reparteve të FNSH, RENEA dhe të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri; Individëtimit nga zjarri; Individë/familje me të ardhura të mesme të qëndrueshme.				Bashkia Shkodër Qeveria Shqiptare Ministria e Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit Enti Kombëtar i Banesave Institucione publike dhe bizneset në territor Donatorë vendas e të huaj OJF.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti					
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti					
	<b>Shuma</b>					



Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti						
	<b>Shuma</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> -Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik -Ministria e Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër					



<b>Nr. 48</b>	<b>P.AG141.Q6.O1.A1</b> Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë.	<b>Programi AG141: Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i.Situata</b>		
<p>Që nga viti 2016, Bashkia Shkodër ka krijuar fondin publik të banesave sociale me qira, përmes zbatimit të projekteve të ndryshme të bashkëfinancuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kryesisht përmes përshtatjes së objekteve të dala jashtë funksionit, adaptim i objekteve ekzistuese, por edhe me ndërtim të ri, duke aplikuar sipas Thirrjeve për projekte të shpalluara nga Ministria çdo vit.</p> <p>Bashkia Shkodër administron tre Banesa Sociale me Qira, pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë, të cilat, kanë 79 njësi banimi në total, ku momentalisht përfitojnë rreth 69 familje të sistemuara pranë këtyre banesave sociale. Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 2691 prot., datë 07.03.2016 që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban është realizuar rikonstruksioni i ish-konviktit të shkollës Pyjore, me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konvikte të qytetit, si dhe familjeve njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë dhe ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.05.2022 "Për disa shtesa në VKB-në nr. 49, datë 30.10.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr. 6" (pranë ish-konviktit të shkollës Pyjore) janë miratuar listat e përfituesve që kanë nënshkruar kontrata qiraje 1-vjeçare. Sa i përket vitit 2024 lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabël që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 "Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër", është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese. Përfituesit pranë këtyre banesave përfitojnë edhe shërbime integrale dhe zhvilluese, me qëllim fuqizimin social-ekonomik, shërbime që ofrohen nga Qendra Komunitare "Për Familjen" nr. 6. Janë rreth 24 njësi banimi me qira ku përfitojnë rreth 20 familje, mes të cilave një familje në kushtet e nevojës emergjente për strehim, miratuar me VKB nr. 60, datë 07.11.2022.</p> <p>Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.47, datë 31.07.2024 është miratuar edhe vendimi "Për strehimin emergjent të zj. Xh. B dhe të miturve të saj në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen" nr. 6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore)".</p> <p>Gjithashtu me vendim të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 30.09.2024 është miratuar edhe vendimi "Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për Familjen" nr.6 (Ish konvikti i shkollës Pyjore).</p> <p>Në administrimin e Bashkisë Shkodër janë edhe 27 kontenier (godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1), që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të minoritetit kombëtar Rom për 27 familje të këtij minoriteti në Bashkinë Shkodër. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 03.06.2021 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe për miratimin e "Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom", është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar. Sa i përket vitit 2024 lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabël që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 "Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër", është miratuar lista shtesë me 3 (tre) familje përfituese. Aktualisht, janë sistemuar pranë këtyre godinave sociale 24 familje përfituese.</p> <p>Sa i përket ish-konviktit të shkollës Veterinare si banesa sociale nën administrimin e Bashkisë Shkodër me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 24, datë 10.05.2022 "Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish-konvikti i shkollës Veterinare dhe të "Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër", është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar përveç dy familjeve. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 "Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër", është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese. Aktualisht, janë sistemuar 26 familje pranë këtyre banesave sociale.</p> <p>Me vendime të Këshillit Bashkiak janë miratuar Rregulloret përkatëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër, për zbatimin dhe funksionimin e këtyre programeve sociale të strehimit, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesve dhe strukturës përgjegjëse administruese.</p> <p>Është miratuar në Këshillin Bashkiak Shkodër vendimi nr.21 date 29.04.2024 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për Banesat Sociale me Qira, në administrimin e Bashkisë Shkodër".</p> <p>Niveli i qirasë për BSQ miratohet çdo vit dhe është i vlefshëm deri më 31 janar të vitit pasardhës.</p> <p>Referuar nenit 19 të ligjit nr.22/20218 "Për strehimin social", i ndryshuar, VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia</p>		

Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• largohen nga institucionet e përkujdesit shoqëror rezidencial.</li> <li>• Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familje njëprindërore në kushte të vështira social- ekonomike.</li> <li>• Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familje të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian.</li> <li>• Përmirësimi i kushteve të banimit për individë dhe famije që banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi.</li> <li>• Mbështetja e përfituesvetë banesave sociale me qira në përmirësimin e jetesës dhe socializimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të Qendrës Komunitare «Për Familjen» ose përmes punonjësit social.</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të familjeve të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian që banojnë në territorin e Bashkisë Shkodër.</li> <li>• Orientimi drejt programeve të tjera sociale të strehimit, në momentin që përfituesit arrijnë një fuqizim ekonomik dhe social të konsiderueshëm.</li> <li>• Ofrimi i strehimitpër raste në kushtet e nevojës emergjente për strehim, sipas parashikimeve ligjore.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ngritja e strukturës përgjegjëse administruese për 3 projektet e banesave sociale me qira, sipas rregulloreve të miratuara.</li> <li>▪ Ofrimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për individët/familjet përfituese.</li> <li>▪ Fuqizimi social-ekonomik i individëve/familjeve përfituese, me synim arrijten e autonomisë përmes funksionit të Qendrës Komunitare «Për Familjen» nr. 6 dhe figurës profesionale të punonjësit social.</li> <li>▪ Bashkëpunime dhe marrëveshje me OJF, institucione publike, biznes privat, në mbështetje të përmirësimit dhe integritimit social të përfituesve të këtij projekti.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kushte të banimit të përmirësuar për individët/familjet në pozita të pafavorizuara që banojnë në territorin e Bashkisë Shkodër.</li> <li>▪ Cilësi e jetës dhe shëndet i përmirësuar i komunitetit.</li> <li>▪ Fuqizim social-ekonomik i grupeve të familjeve në pozita të pafavorizuara.</li> <li>▪ Infrastrukturë e përmirësuar dhe rikualifikim i zonës ku shtrihet projekti.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
<p>Jetimët që jetojnë në konvikte;          Jetimët që pas moshës 18-vjeçare dalin nga institucionet e përkujdesit shoqëror rezidencial;          Familjet njëprindërore, gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike, që janë viktima dhune ose trafikimi;          Të moshuarit;          Familje të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian          Familje që jetojnë në kushte të vështira jashtë standardeve në fuqi;          Individë/familje në pozita të pafavorizuara.</p>				<p>Bashkia Shkodër          OJF          Ministria e Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit          Institucionet publike dhe bizneset private në territor</p>			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	50			50		
A.2	Energji elektrike	150			150		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	650			650		
A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
A.7	Shërbim D.D.D	300			300		
<b>Shuma</b>		<b>1,450</b>			<b>1,450</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	50			50		
A.2	Energji elektrike	150			150		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	650			650		

A.4	Blerje materiale elektrike.	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
A.7	Shërbim D.D.D	300			300		
	<b>Shuma</b>	<b>1,450</b>			<b>1,450</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	50			50		
A.2	Energji elektrike	150			150		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	650			650		
A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
A.7	Shërbim D.D.D	300			300		
	<b>Shuma</b>	<b>1,450</b>			<b>1,450</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> -Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike <b>Institucioni likuidues:</b> Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike					

<b>Nr. 49</b>	<b>P.AG141.Q6.O1.A2</b> Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II)	<b>Programi AG141 Përkujdesi Social</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.</p> <p>Referuar nenit 19 të ligjit nr. 22/20218 "Për strehimin social", i ndryshuar", VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.</p> <p>Bazuar në vlerësimin e bere nga Drejtoria e Kontrollit të zhvillimit të territorit, bashkia Shkodër, mbi ndertimet që parashikohen të behen në territorin e bashkisë, nga të ardhurat që do të mblidhen, të perdoren për rikonstruksionin e kesaj ndertese.</p> <p>Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë të Bashkisë Shkodër, si në ish-konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish- konviktin e shkollës Veterinare.</p> <p>Projekti parashikohet të realizohet në një godinë ekzistuese, e cila është rikonstruktuar dhe përshtatur në banesë sociale si rezultat i financimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pas aplikimit e në bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër në vitin 2020. Aktualisht janë ndërtuar 28 njësi banimi, pjesë e fondit publik të banesave sociale në pronësi të Bashkisë.</p> <p>Projekti "Shtesë kati I dyte banesa sociale të "ish Konviktit të shkollës veterinare)" shtesë i një kati, në një godinë publike dhe funksionale, do të rrishte më tej efektivitetin e godinës, duke rritur numrin e njësisve të banimit dhe numrin e individëve dhe familjeve përfituese që nuk mund të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm.</p> <p>Nga vlerësimet e specialistëve, rezultojnë se në këtë objekt është e mundur të realizohet një shtesë kati dhe të përfitohen edhe 14 njësi banimi të tjera, duke e kthyer këtë godinë në një pallat me 42 apartamente, e duke shtuar me tej kontigjentin e banesave sociale me qira në Bashkinë Shkodër.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kushteve të strehimit për familjet e pastreha.</li> <li>• Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e projekteve të strehimit social, me qëllim zbutjen e kësaj plage sociale.</li> <li>• Vlerësimi i inventarit të aseteve e pronave të paluajtshme të Bashkisë Shkodër me objektiv kthimin e këtyre aseteve në banesa sociale.</li> <li>• Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të përballojnë blerjen e banesave në treg të lirë, duke përfshirë kryesisht familjet në vështirësi të theksuara social-ekonomike.</li> <li>• Ofrimi i alternativave për një strehim të përballeshëm e të përshtatshëm.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpallja e thirrjes për aplikim për programet që do të zbatohen dhe janë financuar.</li> <li>▪ Aplikim online sipas programeve të strehimit.</li> <li>▪ Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas sistemit të pikëzimit.</li> <li>▪ Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit.</li> <li>▪ Shqyrtim dhe verifikim të aplikimeve nga Komisioni i Strehimit.</li> <li>▪ Dërgim për miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësim i qasjes në strehim të individëve/familjeve në pozita të pafavorizuara.</li> <li>• Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv.</li> <li>• Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve të strehimit social që zbatohen.</li> <li>• Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë e Shkodrës.</li> <li>• Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve në vështirësi social-ekonomike.</li> <li>• Lista e përfituesve të programeve sociale të strehimit të zbatuar në bashki të miratuar në Këshillin Bashkiak.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	

Individë dhe familje në pozita të pafavorizuara, në vështirësi social-ekonomike që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm.		Bashkia Shkodër Kontribut i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave, (nga 3% i ndertimeve mbi 2000 m <sup>2</sup> ) Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës Donatorë vendas e të huaj,				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II	<b>30,000</b>				<b>30,000</b>
	<b>Shuma</b>	<b>30,000</b>				<b>30,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II					
	<b>Shuma</b>	<b>0</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	<b>Shuma</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>				
Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027		-Drejtoriae Shërbimeve Sociale, Rinise, Strehimit dhe Shëndetit Publik -Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës - Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike <b>Institucioni likuidues:</b> Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				

<b>Nr. 50</b>	<b>P.AG141.Q6.O1.A3</b> Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit. (Nderim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.	<b>Programi AG141 Përkujdesi Social</b>					
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.</p> <p>Referuar nenit 19 të ligjit nr.22/20218 “Për strehimin social”, i ndryshuar”, VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.</p> <p>Projekte për ndertim i banesave për strehim social/ blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.</p> <p>Fondi i parashikuar ne kete fise bazohet ne vleresimin e bere nga Drejtoria e Kontrollit te zhvillimit te territorit, bashkia Shkoder, mbi ndertimet qe parashikohen te behen ne territorin e bashkise ne vitet 2026-2027 dhe shuma nga diferencat e mbartura.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kushteve të strehimit për familjet e pastreha.</li> <li>• Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e projekteve të strehimit social, me qëllim zbutjen e kësaj plaje sociale.</li> <li>• Vlerësimi i inventarit të aseteve e pronave të paluajtshme të Bashkisë Shkodër me objektiv kthimin e këtyre aseteve në banesa sociale.</li> <li>• Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të përballojnë blerjen e banesave në treg të lirë, duke përfshirë kryesisht familjet në vështirësi të theksuara social-ekonomike.</li> <li>• Ofrimi i alternativave për një strehim të përbalueshëm e të përshtatshëm.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpallja e thirrjes për aplikim për programet që do të zbatohen dhe janë financuar.</li> <li>▪ Aplikim online sipas programeve të strehimit.</li> <li>▪ Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas sistemit të pikëzimit.</li> <li>▪ Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit.</li> <li>▪ Shqyrtim dhe verikim të aplikimeve nga Komisioni i Strehimit.</li> <li>▪ Dërgim per miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësim i qasjes në strehim të individëve/familjeve në pozita të pafavorizuara.</li> <li>• Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv.</li> <li>• Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve të strehimit social që zbatohen.</li> <li>• Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë e Shkodrës.</li> <li>• Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve në vështirësi social-ekonomike.</li> <li>• Lista e përfituesve të programeve sociale të strehimit të zbatuar në bashki të miratuar në Këshillin Bashkiak.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Individë dhe familje në pozita të pafavorizuara, në vështirësi social-ekonomike që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm.				Bashkia Shkodër Kontribut i sektorit privat ne krijimin e fondit publik te banesave, (nga 3% i ndertimeve mbi 2000 m2) Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës Donatorë vendas e të huaj,			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Pa ga	Sigurime	Operative	Transf erime	Kapitale
A.1	<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2026</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Pa ga	Sigurime	Operative	Transferim e	Kapitale
A.1	Nderim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje	3 0,000					30,000

	e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.						
	<b>Shuma</b>	<b>30,000</b>					<b>30,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</b>		<b>Totali (mijë lekë)</b>	Nga kjo:				
			Pa ga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ndertim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.	30,000					30,000
	<b>Shuma</b>	<b>30,000</b>					<b>30,000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2025, 2026, 2027			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> -Drejtoriae Shërbimeve Sociale, Rinise, Strehimit dhe Shëndetit Publik -Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër				